



Vellimir Dellovski

## **Mesazhet e Strasburgut për Shkupin –**

udhërrëfyes për masat e përgjithshme lidhur me ekzekutimin e aktgjykimeve të gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut sa u përket lëndëve të Maqedonisë së Veriut



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Misioni në Shkup



**Mesazhet e Strasburgut për Shkupin –**  
Udhërrëfyes për masat e përgjithshme lidhur  
me ekzekutimin e aktgjyqimeve të gjykatës  
evropiane të të drejtave të njeriut sa u përket  
lëndëve të Maqedonisë së Veriut

**Botues:**  
Misioni i OSBE në Shkup

**Publisher:**  
OSCE Mission to Skopje

**Autor:**  
Velimir Dellovski

**Author:**  
Velimir Delovski

**Redaktorë:**  
Darko Pavlovski  
Artan Murati

**Editors:**  
Darko Pavlovski  
Artan Murati

**Përktheu:**  
Blerina Zlatku

**Translated by:**  
Blerina Zlatku

**Lekturoi:**  
Valon Abdiu

**Proofread by:**  
Valon Abdiu

**Dizajni grafik:**  
Poliesterdej, Shkup

**Graphic design:**  
Polyesterday, Skopje

Mesazhet e Strasburgut për Shkupin – Udhërrëfyes për masat e përgjithshme lidhur me ekzekutimin e aktgjyqimeve të gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut sa u përket lëndëve të Maqedonisë së Veriut – **978-92-9271-042-2**



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Materialët në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në zhvillimin e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

Shteti zyrtarisht ndryshoi emrin kushtetues në vitin 2019 në përpuethshmëri me Marrëveshjen e Prespës. Shumica e akteve ligjore të krijuara para ndryshimit të emrit akoma janë në fuqi dhe përmbajnë emrin e mëparshëm të shtetit në titujt e tyre zyrtare. Përdorimi i emrit të mëparshëm të shtetit në këtë dokument bëhet vetëm për shkak të saktësisë ligjore.

## Përmbajtja

Parathënie	4
LISTA E AKRONIMEVE TË PËRDORURA	5
I. HYRJE	6
1.1. Qëllimi dhe struktura e Analizës	6
1.2. Diapazoni i Analizës	8
1.3. Metodologjia	9
II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE	10
11.1. Lëndë në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 3 të Konventës (ndalimi i torturës)	10
11.2. Lëndë në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 5 të Konventës (e drejta e lirisë dhe sigurisë)	28
11.3. Lëndë në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 6 të Konventës (e drejta e gjykimit të drejtë)	33
11.4. Lëndët në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 8 të Konventës (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare)	43
11.5. Lëndët në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 11 (liria e tubimit dhe bashkimit) në kontekst të nenit 9 të Konventës (e drejta e lirisë së mendimit, vetëdijes dhe fesë)	58
11.6. Lëndët në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 1 të Protokollit nr. 1 ndaj Konventës (mbrojtja e pronësisë)	63
III. PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE	75

## Parathënie

Publikimi “Mesazhet e Strasburgut për Shkupin – Udhërrëfyes për masat e përgjithshme lidhur me ekzekutimin e aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut sa u përket lëndëve të Maqedonisë së Veriut”, është pjesa e dytë e edicionit i cili përbëhet nga tre publikime të veçanta, por ngushtë të lidhura midis tyre, hartimi i të cilit u mbështet dhe është nën patronazhin e Misionit të OSBE-së në Shkup, me qëllim që të aktualizohet tematika e ekzekutimit të aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të begatohen resurset profesionale dhe përmbajtjet në fushën konkrete por, nga ana tjetër, edhe të ngrihet vetëdija për rëndësinë e kësaj problematike që ka të bëjë me reformën juridike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ky publikim i dyti me radhë, fokusohet mbi masat e përgjithshme të cilat duhet t’i ndërmarrë shteti për ekzekutimin konsekuent dhe të plotë të aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lëndët nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Masat e përgjithshme nënkuptojnë ndryshime sistematike, implementimi i të cilave duhet të kontribuojë në përmirësimin e rendit juridik dhe respektimin e të drejtave të njeriut, përkatësisht përmes tyre në të ardhmen duhet të parandalohen shkeljet e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe aktgjyqimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Së këtejmi, edhe pse aktgjyqimet në aspektin nominal zhvillohen “kundër” shtetit, në të vërtetë ato duhet të lexohen dhe të kuptohen si aktgjyqime “për” shtetin, meqë mesazhet që i përmbajnë dhe që dërgohen nga Strasburgu janë në funksion të interesit të përgjithshëm, përkatësisht janë në dobi edhe të shtetit edhe të qytetarëve, por edhe në dobi të kauzës së të drejtave të njeriut.

Me të drejtë mund të pritet se ky publikim, ashtu si edhe trilogjia në tërësi, do t’u vijë në ndihmë institucioneve kombëtare të përfshira në ekzekutimin e aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilat njëherësh janë më të thirrura për realizimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e së drejtës në shtet. Për më tepër, ky publikim në nivel të konsiderueshëm duhet ta stimulojë bashkëpunimin ndërinstitucional, qasjen multidisiplinore dhe punën e përkushtuar gjatë implementimit të masave të përgjithshme, duke e pasur parasysh rëndësinë e tyre sa i përket avancimit të sundimit të së drejtës dhe rendit juridik në përgjithësi. Në të vërtetë, ekzekutimi i aktgjyqimeve, dhe në atë kontekst, para së gjithash zbatimi i masave të përgjithshme si burim i ndryshimeve sistematike, kohë më parë u identifikua dhe inkorporua në Raportin e Pribes të Bashkimit Evropian, i cili ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe në procesin euro-integruar si njëri nga përcaktimet dhe interesat jetike të shtetit.

Hartimi i trilogjisë është pjesë e aktiviteteve programore/të projekteve të cilat Misioni i OSBE-së në Shkup i ndërmerr në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve të autoriteteve kombëtare për realizimin dhe shpërndarjen e përpjekjeve të OSBE-së në fushën e sundimit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut të cilat janë mishëruar në të ashtuquajturin dimensionin njerëzor i OSBE-së, i cili është një aspekt thelbësor i mandatit, përkatësisht i fushëveprimit të Misionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për redaktorin  
Misioni i OSBE-së në Shkup  
Darko Pavlovski, Zyrtar juridik kombëtar  
Artan Murati, Zyrtar për sundimin e të drejtës

## LISTA E AKRONIMEVE TË PËRDORURA

<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>KM</b>	Komiteti i Ministrave
<b>KPT</b>	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin apo Dënimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar pranë Këshillit të Evropës
<b>UNKAT</b>	Komiteti i Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës
<b>AGJPP</b>	Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë
<b>KNI</b>	Komisioni Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MPPS</b>	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
<b>QPS</b>	Qendra / Qendrat për Punë Sociale
<b>DULA</b>	Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë
<b>KP</b>	Kodi Penal
<b>LPP</b>	Ligji për Procedurën Penale
<b>LPPA</b>	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
<b>LMDHP</b>	Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
<b>RMV</b>	Republika e Maqedonisë së Veriut
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

## I. HYRJE

### 1.1. Qëllimi dhe struktura e Analizës

Qëllimi i kësaj Analize konsiston në prezantimin dhe vlerësimin e gjendjes aktuale lidhur me ekzekutimin e aktgjyqimeve përfundimtare të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim: “Gjykata”, “GJEDNJ”) të miratuara sa u përket aplikacioneve të paraqitura kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin në vijim: RMV), kështu që do të identifikohen ndryshimet që janë bërë ose duhet të bëhen si pjesë e ekzekutimit të këtyre aktgjyqimeve si dhe do të detektohen problemet dhe sfidat kryesore të ekzekutimit. Së këtejmi, theksi është vënë pikërisht mbi masat e përgjithshme për ekzekutimin e aktgjyqimeve. Sipas rregullit, masat e përgjithshme kanë të bëjnë me parandalimin e shkeljeve të ardhshme të ngjashme të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin në vijim: “Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut”, “Konventa”, “KEDNJ”) ose me vënien fund të shkeljeve të vazhdueshme të Konventës. Këto shkelje më së shpeshti rezultojnë nga lëshimet dhe mospërputhshmëritë e legjislacionit i cili nuk është harmonizuar me standardet evropiane të të drejtave të njeriut të cilat i promovon Konventa dhe me praktikën e GJEDNJ-së, ose nga defektet e veçanta gjatë procedimit/veprimit gjyqësor apo administrativ.

Përmes Analizës do të mundësohet një pasqyrë koncize e gjetjeve të përfshira në aktgjykimet e GJEDNJ-së, ekzekutimi i të cilave është në rrjedhë e sipër, do të prezantohen mesazhet kryesore që burojnë nga të njëjtat të cilat i adresohen shtetit dhe së këtejmi do të nxirret konkluzioni nëse ai në mënyrë të drejtë i ka kuptuar këto mesazhe, ndërkaq përmes masave dhe aktiviteteve konkrete a manifeston qasje serioze sa i përket zbatimit të tyre ose nevojiten hapa të mëtutjeshëm drejt finalizimit të procesit të ekzekutimit të aktgjyqimeve të caktuara.

Gjatë hartimit të Analizës, vëmendje e veçantë i është kushtuar identifikimit të problemit, përkatësisht burimit të shkeljes së Konventës, duke e ndjekur terminologjinë e cila përdoret në analizën e Gjykatës dhe që është përfshirë në aktgjykimet e veçanta.

Pastaj, në të bëhet vlerësimi (evaluimi) i kompatibilitetit të masave të përgjithshme të parashikuara ose tanimë të ndërmarra nga ana e shtetit të cilave u referohet Plani i Veprimit i cili miratohet për një lëndë të caktuar ose për një grup të lëndëve.

Për më tepër, kjo do të mundësojë të nxirret konkluzioni ose të vihet në dukje nevoja e shqyrtimit ose ndërmarrjes serioze edhe të masave të tjera të llojit të përgjithshëm, të cilat janë të rëndësishme dhe relevante për adresimin e shkeljes dhe të domosdoshme në kuptimin e asaj se pa të njëjtat nuk mund të imagjinohet mbyllja e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e ndonjë lëndë të caktuar ose grupit të lëndëve para Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (në tekstin në vijim: “Komiteti”, “KM”).

Në fund, ekzekutimi i lëndëve të caktuara, përkatësisht i grupeve të lëndëve shpeshherë ndërldhet me një sërë sfidash, qofshin ato të natyrës objektive apo subjektive, të cilat në

njëfarë mënyre e ngadalësojnë dhe e vështirësojnë implementimin e masave për ekzekutimin e aktgjyqimeve. Pikërisht për këto shkaqe, duke e pasur parasysh nevojën për tejkalimin e tyre me qëllim të përfundimit të plotë të aktgjykimit, analiza synon ta ndihmojë dhe inkurajojë ndërmarrjen e hapave të ardhshëm, ndonjëherë këto hapa janë më se të nevojshëm dhe duhet të çojnë në mbylljen e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin. Së këtejmi, përmes pasqyrës konstruktive të gjendjes aktuale me ekzekutimin e lëndëve konkrete dhe grupeve të lëndëve, kjo Analizë duhet t'i stimulojë faktorët relevantë që t'i ndërmarrin mekanizmat e nevojshëm për ekzekutim të cilët kanë karakter dhe efekt të përgjithshëm për parandalimin e shkeljeve të ardhshme të përsëritura. Kuptohet, një gjë e këtillë duhet të bëhet përmes adresimit sistematik të problemeve, lëshimeve dhe mangësive të konstatuara sa i përket strukturës institucionale të çështjeve dhe mënyrës së zbatimit të procedurave për të cilat në njëfarë mënyre ekziston rreziku nga shkeljet e reja të lirive dhe të drejtave themelore të cilat i mbron KEDNJ-ja.

Analiza i dedikohet një rrethi mjaft të gjerë të përdoruesve, duke i përfshirë: bartësit e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, në krye të hierarkisë së të cilit është Gjykata Supreme, si dhe gjykatat e apelit dhe gjykatat e rregullta më të ulëta, Gjykata Kushtetuese duke e pasur parasysh rolin e saj të rojtarit dhe mbrojtësit të lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (në tekstin në vijim: “AGJPP”), organet e administratës të cilat në punën e tyre të përditshme kanë autorizime me të cilat mund të ndërmarrin veprime në lidhje me të drejtat e njeriut, avokatët, organizatat joqeveritare dhe ekspertët juridikë të cilët e trajtojnë problematikën që ka të bëjë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Duhet të theksohet se pas shqyrtimit të procesit të ekzekutimit të lëndëve aktuale, përkatësisht grupeve të lëndëve nga RMV-ja, të cilat janë në mbikëqyrje të Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës, në fund bëhet përmbledhje e stadi të cilin gjendet implementimi i ndonjë lëndë të caktuar ose grupi të lëndëve, masave të cilat presin të realizohen, si dhe i masave për ekzekutim të cilat edhe pse nuk janë theksuar në Planin e Veprimit ose në Raportin e Veprimit të cilin shteti ia dërgon Komitetit të Ministrave, megjithatë do të ishte e pëlqyeshme, madje edhe e nevojshme, që ato të merren parasysh seriozisht dhe të zbatohen në praktikë.

Nga fundi i kësaj Analize, janë prezantuar konkluzionet për tendencat e përgjithshme që kanë të bëjnë me ekzekutimin e aktgjyqimeve të këtyre lëndëve, vështirësitë dhe sfidat kryesore në procesin e përgjithshëm, mundësitë e avancimit të tyre dhe roli i faktorëve të ndryshëm të ekzekutimit në nivel kombëtar.

Në fund, Analiza përfundon me pasqyrimin e udhëzimeve të caktuara jo të detyrueshme që kanë të bëjnë me reformat e pritshme të legjislacionit dhe me ndërhyrjet institucionale në kuptimin e ndryshimit të praktikës së veprimit të gjykatave dhe strukturave administrative të shtetit të cilat duhet të ndërmerren në periudhën e ardhshme përmes specifikimit të institucioneve konkrete të cilat janë kompetente që t'i zbatojnë ato (shih: Aneksin).



## 1.2. Diapazoni i Analizë

Sa i përket gjendjes së ekzekutimit të aktgjykimeve maqedonase, do të ishte mirë të vihet në dukje se në fund të vitit 2020, para KM-së, në mbikëqyrje ka mbetur ekzekutimi i gjithsej 40 lëndëve, prej të cilave, sipas klasifikimit të KM-së, 15 lëndë janë “kryesore”, ndërsa 25 lëndë janë futur në grupin e lëndëve “të klonuara” (të përsëritura). Sipas të dhënave që janë në dispozicion në bazën e të dhënave HUDOC EXEC, me “mbikëqyrje të fuqizuar” të KM-së, në nëntor të vitit 2021, për 11 lëndë janë miratuar aktgjykime, prej të cilave 3 (tre) (lëndët: *Kitanovski, H dhe „Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Peshkopata Greke-Ortodokse e Ohrit pranë Patriarkanës së Pejës)”,* në tekstin në vijim: *Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit, KOO*), janë kategorizuar si “kryesore”.

Për 2 (dy) lëndë të cilat janë mbyllur me Rezolutë përfundimtare në vitin 2020, fundi i ekzekutimeve të aktgjykimeve është shënuar vetëm sa u përket masave individuale. Masat e përgjithshme, në këto dy raste, Komiteti i Ministrave vazhdon t’i monitorojë në kontekst të lëndëve tjera të ngjashme kundër shtetit, ekzekutimi i të cilave akoma është në mbikëqyrje të Komitetit të Ministrave.<sup>1</sup>

Nga gjithsej 42 aktgjykime sa janë në monitorimin e Komitetit të Ministrave në nëntor të vitit 2021, kjo Analizë do të fokusohet mbi gjithsej 36 lëndë, për mbylljen e të cilave duhet të realizohen ndërhyrje sistematike në legjislacion, në praktikën gjyqësore ose administrative në nivel kombëtar. Së këtejmi, do të trajtohen të gjitha ato lëndë ekzekutimi i të cilave, përmes masave të zbatuara të përgjithshme, mund të ketë ndikim të konsiderueshëm mbi sistemin e jurisprudencës kombëtare. Lëndët e analizuara do të ndahen në disa kategori, varësisht nga lloji i shkeljes kryesore i cili është konstatuar me aktgjykimin konkret, përkatësisht me grupin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjithsesi, një vend jashtëzakonisht të rëndësishëm u kushtohet grupeve të lëndëve, duke i përfshirë edhe ato tek të cilat ekzekutimi nuk ka përfunduar tanimë një periudhë të gjatë kohore, gjë që vetvetiu është një indikator se duhet t’u përkushtohet vëmendje e veçantë dhe të kenë trajtim prioritar në procesin e implementimit të lëndëve të Strasburgut.

Sa i përket llojit të masave të përgjithshme, varësisht nga natyra e shkeljes, disa aktgjykime mund të kenë nevojë për ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit ose për ndryshimin e politikave në praktikën administrative dhe/ose gjyqësore, të cilat synojnë t’i parandalojnë shkeljet e njëjta apo të ngjashme në të ardhmen.

Nga ana tjetër, të rëndësishme janë edhe masat të cilat synojnë ngritjen e vetëdijes, siç janë trajnimet dhe aktivitetet edukative, por edhe publikimi i aktgjykimeve të GJEDNJ-së në gjuhën zyrtare të shtetit të paditur dhe dërgimin (shpërndarjen) e tyre deri te autoritetet (organet) e interesuara të cilat janë përfshirë në miratimin e vendimeve të kontestuara vendore ose të cilët duhet të marrin pjesë në procesin e ekzekutimit të tyre.

<sup>1</sup> Fq. 10 nga Raporti Vjetor për punën e Komisionit Ndërinstitucional për vitin 2020

Megjithatë, duhet të nënvizohet se krahas rëndësisë dhe kontributit të këtyre masave në drejtim të ekzekutimit të suksesshëm të aktgjykimeve të GJEDNJ-së, megjithatë të njëjtat dalin jashtë fokusit të kësaj Analize dhe nuk do të analizohen hollësisht për shkak se ajo më shumë fokusohet mbi pasqyrimin e masave të cilat çojnë në ndryshime dhe plotësime të legjislacionit në praktikën gjyqësore dhe administrative.

## 1.3. Metodologjia

Kur bëhet fjalë për qasjen metodologjike gjatë hartimit të kësaj Analize, pika e referimit për shqyrtimin e të gjitha aspekteve të mëtutjeshme relevante në lidhje me ekzekutimin, ishte përzgjedhja dhe shqyrtimi i vëmendshëm i aktgjykimeve të GJEDNJ-së të miratuara në lëndët kundër Maqedonisë së Veriut për të cilat u konstatua se, për shkak të ndikimit sistematik të cilin do të duhej ta nxisin, duhet të përfshihen në tekstin e kësaj Analize.

Njëkohësisht, vlen të theksohet se ajo mbështetet mbi të gjitha dokumentet që janë në dispozicion në formë elektronike, të cilat ofrojnë mundësi në mënyrë konsekuente të monitorohet dhe mbikëqyret rrjedha e procesit të ekzekutimit, duke i përfshirë informacionet dhe të dhënat që janë në dispozicion në ueb-faqet zyrtare të Byrosë së Përfaqësimit të Shtetit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, siç janë edhe: raportet vjetore dhe procesverbalet nga mbledhjet e Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim: “Komisioni Ndërinstitucional”, “KNI”); informacionet dhe të dhënat për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ, që janë në dispozicion në ueb-faqet zyrtare të Komitetit të Ministrave dhe në bazën e të dhënave HUDOC-EXEC, duke përfshirë këtu edhe planet e veprimit dhe/ose raportet e veprimit dhe shkresat e tjera të paraqitura në KM nga ana e shteteve, aplikantëve ose subjekteve të tjera, si dhe raportet vjetore dhe dokumentet e tjera relevante të Komitetit të Ministrave; dokumentet relevante ligjore dhe dokumentet e tjera juridike të cilat janë hartuar ose miratuar si masë për ekzekutimin e lëndëve konkrete, etj.

Në fund, me rëndësi jashtëzakonisht të madhe gjatë hartimit të këtij dokumenti ishin edhe konsultat e realizuara me znj. Danica Xhonova, Agjente Qeveritare dhe u.d. Drejtoreshë e Byrosë së Përfaqësimit të Shtetit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila dha një kontribut të çmuar për aspektet e caktuara me rëndësi vendimtare për ekzekutimin e secilit aktgjykim të analizuar, përkatësisht për ekzekutimin e grupeve të aktgjykimeve.

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

### II.1. Lëndë në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 3 të Konventës (ndalimi i torturës)

#### GRUPI I LËNDËVE KĪTANOVSKI<sup>2</sup> DHE HAJRULLAHU<sup>3</sup>

##### Gjetjet e GJEDNJ-së

Lëndët e grupit *Kitanovski* kanë të bëjnë me trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruar nga ana e policisë, ndërsa aktgjykimet kanë të bëjnë me rastet në periudhën kohore ndërmjet vitit 2003 dhe vitit 2014. Përveç në lëndët *Trendafilovski*, *X dhe Y* dhe *Memedov*, në të gjitha pesë lëndët e tjera të grupit janë konstatuar shkelje të aspektit material të nenit 3. Në të gjitha këto lëndë, përveç në lëndën *Ilievska*<sup>4</sup>, ka shkelje të aspektit procedural për shkak të mungesës së hetimit efektiv për pretendimet e veprimt, në kundërshtim me nenin 2 dhe 3. Nga ana tjetër, në lëndën *Memedov* për herë të parë në një lëndë kundër RMV-së është konstatuar shkelja e nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 3 të Konventës për shkak të lëshimit të autoriteteve që t'i hetojnë pretendimet e aplikantit për motive racore të brutalitetit policor ndaj të cilit ai është ekspozuar, si person me përkatësi etnike rome.

Në lëndën kryesore nga ky grup, *Kitanovski*, bëhet fjalë për trajtim poshtëruar gjatë arrestimit të aplikantit që ka ndodhur gjatë kryerjes së kontrollit rutinor të policisë nga ana e pjesëtarëve të njësisë speciale “ALFA”, me ç’rast i është rrezikuar jeta, ndërsa atë që e ka përjetuar në rastin konkret, ka qenë rezultat i rastësisë/fatit (paragrafët 56 dhe 57 të

<sup>2</sup> Ky grup përbëhet nga gjithsej gjashtë lëndë: *Kitanovski*, nr. 15191/12, aktgjykimi nga 22 janari i vitit 2015; *Ilievska*, nr. 20136/11, aktgjykimi nga 7 maji i vitit 2015; *Andonovski*, 24312/10, aktgjykimi nga 23 korriku i vitit 2015; *Asllani*, nr. 24058/13, aktgjykimi nga 10 dhjetori i vitit 2015; *X dhe Y*, nr. 173/17, aktgjykimi nga 5 nëntori i vitit 2020 dhe *Trandafilovski*, nr.59119/15, aktgjykimi nga 17 dhjetori i vitit 2020. Këto lëndë u shqyrtuan veçmas nga lënda *Hajrullahu*, por me vendimin e Komitetit të Ministrave nga muaji qershor i vitit 2021, grupi i lëndëve *Kitanovski* u bart nga procedura e mbikëqyrjes standarde në procedurën e mbikëqyrjes së fuqizuar, me ç’rast këtij grupi iu bashkëngjitet edhe lënda *Hajrullahu* që ka të bëjë me shkelje të ngjashme, ndërsa shqyrtimi i këtyre lëndëve do të vazhdojë nën indikatorin për ekzistimin e problemit strukturor ([https://search.coe.int/cm/pages/result\\_details.aspx?objectId=0900001680a2b161](https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectId=0900001680a2b161)). Pastaj, edhe lënda *Memedov*, nr. 31016/17, aktgjykimi nga data 24 korriku i vitit 2021, do t'i bashkëngjitet këtij grupi, me ç’rast numri i lëndëve që bëjnë pjesë në këtë grup rritet në tetë.

<sup>3</sup> *Hajrullahu*, nr. 7537/07, aktgjykimi nga 29 tetori i vitit 2015.

<sup>4</sup> Në këtë lëndë lidhja me pranga dhe aplikimi i forcës fizike ndaj aplikantes, e cila është një person me çrregullime shpirtërore, gjatë transportimit të saj deri në spitalin psikiatrik, është karakterizuar si trajtim degradues duke e pasur parasysh gjendjen e saj shëndetësore, si dhe faktin se nuk është dëshmuar se në këtë rast nuk ka pasur në dispozicion masa të tjera më pak të rrepta të kujdesit, të cilat ka pasur mundësi të zbatohen në mënyrë që të zvogëlohet mundësia nga vetëlëndimi i aplikantes, pa u rrezikuar autonomia e saj personale (paragrafi 62).

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

tekstit të aktgjykimit).<sup>5</sup>

Shkelja e detyrimit procedural të shtetit sipas nenit 2 dhe 3 të KEDNJ-së që të realizojë hetim efikas në lidhje me trajtimin joadekuat policor (dhe rrezikimin e jetës së tij) ka të bëjë me mosveprimin e prokurorisë publike, e cila krahas seriozitetit të pretendimeve, identitetit të theksuar të nëpunësve të përfshirë policorë, si dhe me provat e prezantuara nga aplikanti, nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimesh të tjera, përveç që ka kërkuar informacione plotësuese nga MPB-ja (paragrafi 88). Fakti se prokurori i njëjtë i cili e ka proceduar kallëzimin penal të aplikantit, ka paraqitur akuzë kundër tij, me kërkesë të MPB-së për sulm mbi personin zyrtar gjatë kryerjes së punëve të sigurisë, e ka bërë të dyshimtë paanshmërinë e tij (paragrafi 89). Përfundimisht, vendimin formal se nuk ekzistojnë baza për ndjekje penale, Prokuroria e miratoi pas më shumë se tre vjet e gjysmë nga paraqitja e kallëzimit penal edhe atë pas komunikimit të lëndës me Qeverinë, përkatësisht pas komunikimit të tij nga ana e Gjykatës me Agjentin e Qeverisë, për përgjigje ndaj pretendimeve të aplikantit (paragrafi 90).

Edhe në lëndën *Andonovski*, aplikanti i është ekspozuar brutalitetit policor, me ç’rast i janë shkaktuar lëndime të rënda fizike, për të cilat nuk ka ekzistuar shpjegim bindës (paragrafi 96). Shkelja e procesit ka të bëjë me atë që Prokuroria nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimesh që ta hetojë rastin, përveç që ka kërkuar informacione nga institucioni shëndetësor në të cilin është mjekuar, ndërsa aktvendimin për hedhjen poshtë të kallëzimit penal, të paraqitur nga aplikanti për shkak të mospasjes së provave, kryesisht e ka mbështetur mbi provat e siguruara nga MPB-ja (paragrafi 89). Përveç kësaj, gjatë kohës së procedurës trupi gjykues, tre herë i është drejtuar prokurorit publik që sipas detyrës zyrtare të ndërmarrë hetime ndaj akuzës për lëndim të rëndë trupor, ndërsa prokurori në mënyrë eksplicite e ka refuzuar (paragrafi 90). Nga ana tjetër, procedura e filluar penale, u ndërpre në bazë të deklaramit të aplikantit të dhënë në seancën gjyqësore, me të cilin ai kinse e ka tërhequr akuzën edhe pse ai në mënyrë eksplicite ka sugjeruar për interpretim të gabueshëm të deklaramit të tij dhe ka kërkuar që procedura të vazhdojë (paragrafi 92).

Edhe në lëndën *Asllani*, në të cilën aplikanti është fyer në baza etnike, është rrahur dhe është keqtrajtuar gjatë marrjes në pyetje në stacionin policor, vërehet pasiviteti i prokurorit publik (paragrafi 62), si dhe zvarritja në zbatimin e procedurës penale, e cila ka pasur pasiguri që aplikanti paraqiti aktakuzë subsidiare, me ç’rast lënda katër herë është kthyer për shqyrtim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë, dhe e gjithë kjo ka kontribuar për një joefikasitet të përgjithshëm të hetimit, kështu që përgjegjësia nuk është përcaktuar plotë shtatë vjet e gjysmë pas lëndimeve që i janë shkaktuar aplikantit (paragrafi 67).

<sup>5</sup> *Kitanovski* bën pjesë në një kategori specifike të lëndëve në praktikën e GJEDNJ-së, ku edhe pse përdorimi i armës së zjarrit nuk ka qenë vdekjeprurës, përveç sipas nenit 3, aplikacioni është shqyrtuar edhe sipas nenit 2 të Konventës (e drejta e jetës), i cili sipas Gjykatës, nuk ka të bëjë vetëm me vrasjen me dashje, por edhe me situatat ku përdorimi i forcës mund të rezultojë, si epilog pa dashje, me privim nga jeta (paragrafi 53 i aktgjykimit). Një lëndë e ngjashme në këtë kuptim është edhe lënda *Sasho Gjorgjiev* nr. 49382/06, aktgjykimi nga 19 prilli i vitit 2012, paragrafi 38. Së këtejmi, është gjetur edhe shkelja e aspektit material nga neni 2 i KEDNJ-së.

Në të tre aktgjykimet e analizuara paraprakisht<sup>6</sup>, Gjykata ka potencuar se nga personat viktimë të shkeljes së nenit 2 dhe 3 të Konventës, nuk duhet të pritet që ata vet dhe me iniciativë të tyre ta ndërmarrin ndjekjen e personave të autorizuar zyrtarë, por një gjë e këtillë mbetet në përgjegjësi të prokurorit publik.

*Hajrullahu* është njëra nga lëndët e rralla maqedonase para GJEDNJ-së, krahas lëndës *El-Masri*<sup>7</sup> dhe *Selami dhe të tjerët*<sup>8</sup>, në të cilën është konstatuar se aplikanti u është ekspozuar veprimeve të cilat e kanë prekur pragun e mizorisë të cilën e parasheh GJEDNJ-ja që të mund të konsiderohen si torturë, ndërkaq në këtë lëndë bëhet fjalë për mbajtjen e tij të fshehtë (*incommunicado*) në lokacion të panjohur. Këtu, problematike është se aplikanti është grabitur dhe është mbajtur nëpunësit e MPB-së tre ditë në muajin gusht të vitit 2005 në një shtëpi, në një vend të jashtëligjshëm për privim nga liria, me ç'rast është frikësuar, që i ka shkaktuar dhembje të konsiderueshme fizike, frikë, shqetësime dhe vuajtje mendore. E gjithë kjo, është organizuar dhe zbatuar në fshehtësi nga ana e forcave të sigurisë së shtetit, me qëllim që nga aplikanti të sigurohet pranimi nga ana e tij në lidhje me pretendimin për përfshirjen e tij në një sulm paraprak me bombë më 15 korrik të vitit 2005 (paragrafi 101 i aktgjykimit).

Gjykata, përveç shkeljes së aspektit procedural, konstatoi shkelje edhe të aspektit material të nenit 3, duke i pasur parasysh pretendimet dhe provat e mbështetura se aplikanti i është ekspozuar brutalitetit policor (paragrafi 48 dhe 49). Në këtë kuptim, Gjykata e vë në dukje mosveprimin e prokurorisë kompetente pas seancës dëgjimore të aplikantit (paragrafi 75 i aktgjykimit), e cila nuk e ka kontaktuar MPB-në për të siguruar të dhëna plotësuese (paragrafi 78 i aktgjykimit), dhe krahas pretendimeve për privim jashtëligjor nga liria të personave të dyshuar dhe paraburgimit të tyre nga ana e policisë në lokacione të fshehta, të cilat ishin objekt i debateve publike qysh në vitin 2001, e që nuk ka pasur mundësi të mbetet e panjohur për organet shtetërore (paragrafi 77 i aktgjykimit).

Përveç shkeljeve të nenit 3, në lëndën *Hajrullahu* Gjykata ka gjetur shkelje edhe të së drejtës së gjykimit të drejtë nga neni 6 paragrafi 1 për shkak të përdorimit, nga ana e gjykatave vendase, të pranimit të fajit nga aplikanti si të besueshëm, mirëpo i cili është siguruar me detyrim gjatë kohës së seancës dëgjimore nga ana e gjyqtarit hetues, edhe krahas faktit se para gjykatave aplikanti ka pohuar se pranimi i fajit është siguruar në mënyrë të paligjshme (paragrafi 109).

Në lëndën *Trendafilovski*, mangësitë e procesit gjatë veprimit të prokurorit publik kanë të bëjnë me atë se pretendimet e aplikantit për keqtrajtje nga ana e policisë gjatë arrestimit të tij në shtëpinë e tij, si dhe në stacionin e policisë, nuk janë hetuar përmes marrjes së veprimeve përkatëse dhe përmes sigurimit të provave të tjera, duke i përfshirë edhe ato që i ka propozuar aplikanti (paragrafi 27), ndërsa “rezoluta” me të cilën është vendosur që të

<sup>6</sup> *Kitanovski*, nr. 15191/12, aktgjykimi nga 22 janari i vitit 2015, paragrafi 90; *Andonovski*, nr. 24312/10, aktgjykimi nga 23 korriku i vitit 2015, paragrafi 90; *Asllani*, nr. 24058/13, aktgjykimi nga 10 dhjetori i vitit 2015, paragrafi, 62

<sup>7</sup> *El-Masri*, nr. 39630/09, aktgjykimi i Dhomës së Madhe nga 13 dhjetori i vitit 2012.

<sup>8</sup> *Selami*, nr. 78241/13, aktgjykimi nga 1 marsi i vitit 2018.

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

hidhet poshtë kallëzimi penal, nuk i është dërguar aplikantit, kështu që në asnjë mënyrë nuk mund të përgënjeshtrohet me ankesë (paragrafi 28).

Në lëndën X dhe Y si aplikantë paraqiten dy persona të përkatësisë etnike rome, persona të mitur të cilët janë ndaluar nga disa nëpunës policorë për shkak të pretendimit për përfshirjen e tyre në vjedhje në rrugë. Motivet racore të pretendimit për brutalitetin policor gjatë arrestimit të tyre, si dhe gjatë marrjes në pyetje në stacionin policor, mbetën të pandriçuara dhe të padëshmuara për shkak të mungesës së hetimit efektiv, i cili ka zgjatur më shumë se gjashtë vjet pas ngjarjes kritike (paragrafi 54 i aktgjykimit).

Edhe në këtë rast, Gjykata e ka vënë në dukje joaktivitetin e plotë të prokurorit themelor publik, i cili më shumë se dy vjet pasi që aplikantët e kanë paraqitur kallëzimin penal, nuk ka ndërmarrë kurrfarë masash hetuese, edhe pse ata tre herë i janë drejtuar prokurorit të lartë publik, duke kërkuar nga ai të bëjë mbikëqyrje mbi punën e prokurorit publik themelor ose ta marrë përsipër hetimin. Veç tjerash, janë specifikuar edhe më shumë prolongime, për të cilat nuk ka pasur kurrfarë sqarime, të cilat thjeshtë mund t'i përshkruhen prokurorit publik<sup>9</sup>.

Në të vërtetë, lënda X dhe Y, në masë të madhe ngjan me lëndët *Jashar*, *Xheladinov* dhe *Sulejmanov*, të cilat bashkë e formojnë grupin e lëndëve *Jashar*<sup>10</sup>, me atë se edhe këto kishin të bëjnë me shkeljen e aspektit të procesit të nenit 3, në lidhje me pretendimet për brutalitet policor ndaj personave të përkatësisë etnike rome, edhe pse as këtu (për dallim nga lënda *Memedov*) në mënyrë eksplicite nuk u konstatua motivi racor.

### Ekzekutimi i aktgjykimeve

Në të gjitha lëndët e grupit *Kitanovski*, aplikantët janë liruar dhe më nuk kanë qenë “në duart e policisë”, ndërsa shteti e ka pasur për detyrim të demonstrojë se janë ndërmarrë veprime të përcaktuara hetuese, si masa individuale, në drejtim të përmbushjes së standardeve të larta të aspektit të procesit të nenit 3 nga Konventa, përkatësisht të nenit 2 (në lëndën *Kitanovski*).

Megjithatë, qëllimet e ekzekutimit të këtyre lëndëve në asnjë rast nuk mund të përmbushen vetëm përmes masave të veçanta, por imponohet nevoja e ndërmarrjes së masave të përgjithshme gjithëpërfshirëse, të cilat do të rezultojnë në parandalimin e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen.

<sup>9</sup> Për shembull, madje më shumë se tre vjet pas kallëzimit penal nga ana e aplikantëve, prokurori publik e ka marrë në pyetje Y dhe nëpunësit e prekur policorë, ndërsa X akoma nuk ishte marrë në pyetje dhe nuk ka pasur indikacione se prokurori e ka marrë në pyetje ndonjë dëshmitar (të propozuar nga aplikantët) apo se ka ndërmarrë veprime të tjera për zbulimin e provave në lidhje me incidentin.

<sup>10</sup> *Jashar*, nr. 69908/01, aktgjykimi nga 15 shkurti i vitit 2007; *Sulejmanov*, nr. 69875/01, aktgjykimi nga 24 prilli i vitit 2008; *Xheladinov*, nr. 13252/02, aktgjykimi nga 10 prilli i vitit 2008; *Trajkoski*, nr. 13191/02, aktgjykimi nga 7 shkurti i vitit 2008. Këto lëndë janë mbyllur me Rezolutën e KM-së. Shih: Resolution CM/ResDH(2018)72 Execution of the judgments of the European Court of Human Rights Four cases against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 21 February 2018 at the 1308th meeting of the Ministers' Deputies)



Konstatimet e Gjykatës në lidhje me mënyrën e veprimit të prokurorisë, dhe veçanërisht fakti se lloji i njëjtë i shkeljeve nuk është ndërprerë me mbylljen e lëndëve të grupit *Jashar*, por përkundrazi të njëjtat vazhdimisht përsëriten, flasin për nevojën e ndërmarrjes së masave të përgjithshme serioze në drejtim të parandalimit të shkeljeve të këtilla. Bashkimi i lëndëve në fazën e ekzekutimit dhe shqyrtimi i tyre i përbashkët para KM-së, duke e pasur parasysh ngjashmërinë e shkeljeve, e imponon, si tërësi të shqyrtohen edhe masat e përgjithshme të parashikuara ose të ndërmarra deri më tani, të theksuara në dy planet e veprimit të hartuara nga ana e shtetit në kontekst të lëndës *Hajrullahu* në vitin 2017 dhe 2019,<sup>11</sup> si dhe në Planin e Veprimit e vetëm deri më tani për grupin *Kitanovski*,<sup>12</sup> veçanërisht meqë masat për të cilat shteti informon në detaje në Planin e Veprimit për rastin *Hajrullahu*, gjithsesi se kanë të bëjnë edhe me lëndët e grupit *Kitanovski*.

Masat e përgjithshme për të cilat shteti është angazhuar që t'i ndërmarrë në lidhje me këto lëndë, mund të ndahen në dy kategori kryesore: masa të cilat synojnë parandalimin e trajtimit joadekuat nga ana e policisë, intenca e të cilave është eliminimi i mundësisë së shkeljeve të ardhshme të aspektit material nga neni 3, si dhe masa të cilat synojnë të sigurojnë hetim efektiv për pretendimet e trajtimit joadekuat në duart e policisë, të cilat më shumë janë fokusuar në adresimin e mangësive sistematike gjatë zhvillimit të hetimeve në raste të ngjashme të cilat rezultojnë me shkelje flagrante të komponentit të procesit të nenit 3.

Ndërhyrja kryesore, në këtë kuptim, konsiston me vendosjen e **mekanizmit të pavarur dhe efikas për kontroll të jashtëm mbi punën e policisë** dhe luftimin e pandëshkueshmërisë së personave zyrtarë të ngarkuar pikërisht për zbatimin e ligjeve. Bëhet fjalë për një ndërhyrje të kombinuar e cila njëkohësisht përfshin reforma të legjislacionit dhe reforma institucionale dhe së këtejmi kishte mbështetje teknike nga dy projekte të ndërlidhura midis tyre të Këshillit të Evropës,<sup>13</sup> në kuadër të të cilëve përmes procesit konsultativ, në të cilin janë përfshirë përfaqësues të të gjithë faktorëve relevantë (MPB-ja, Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Prokuroria Publike, si dhe ekspertë të tjerë nga mjedisi akademik dhe nga organizatat joqeveritare), është zgjedhur modeli i ashtuquajtur “Prokuroria plus”, i cili parashikon themelimin e seksionit të veçantë në Prokurorinë Themelore dhe inkorporimin e autoritetit/organit të ri për kontroll qytetar mbi pretendimin për veprim joadekuat të policisë.<sup>14</sup>

Në Planin e veprimit, shteti ka pritshmëri se organi/autoriteti i ri për kontroll të jashtëm do të mundësojë efektivitet më të madh në procesin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit mbi veprimin

<sup>11</sup> 1288th meeting (June 2017) (DH), Action plan (16/03/2017), Communication from “the former Yugoslav Republic of Macedonia” concerning the case of HAJRULLAHU v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Application No. 37537/07), DH-DD(2017)347 dhe 1362nd meeting (December 2019) (DH), Action plan (21/10/2019), Communication from North Macedonia concerning the case of HAJRULLAHU v. North Macedonia (Application No. 37537/07), DH-DD(2019)1231, 30/10/2019

<sup>12</sup> 1288th meeting (June 2017) (DH), Action plan (06/03/2017), Communication from “the former Yugoslav Republic of Macedonia” concerning the case of KITANOVSKI v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Application No. 15191/12), DH-DD(2017)308

<sup>13</sup> Për më shumë detaje lidhur me këto projekte shih paragrafët 38 – 45 të Planit të veprimit për grupin e lëndëve *Kitanovski*

<sup>14</sup> Paragrafi 40 i Planit të veprimit për grupin e lëndëve *Kitanovski*

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

policor përmes zbatimit të hetimeve të pavarura mbi pretendimin për torturë ose keqtrajtim nga ana e personave (agjentëve) zyrtarë të shtetit, duke e përfshirë edhe kompetencën që të iniciohet ndjekje penale kundër kryerësve, si dhe me inkorporimin e mekanizmit për kontroll/mbikëqyrje të jashtme do të përmirësohej efikasiteti dhe efektiviteti i hetimeve penale dhe do të reduktohej pandëshkueshmëria e personave zyrtarë për zbatimin e ligjit, me ç'rast do të mundësohet parandalimi i shkeljeve të ngjashme.<sup>15</sup>

Nëse ndiqet gjeneza e procesit të legjislacionit përmes të cilit vendoset ky mekanizëm kontrollues, mund të vërehet se duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2016 janë ndërmarrë aktivitete legjislative të fokusuar mbi hartimin e pakos së legjislacionit që duhet të paraqesë bazë solide për këtë mekanizëm, duke i përfshirë ligjet, si dhe aktet përkatëse nënligjore.<sup>16</sup> Së këtejmi, kemi një shmangie nga korniza fillimisht e përcaktuar kohore për vendosjen e tij,<sup>17</sup> duke e pasur parasysh atë se nga Plani i veprimit për lëndën *Hajrullahu*, rezultoi se ndryshimet ligjore më në fund janë realizuar gjatë vitit 2018. Një gjë e këtillë është e kuptueshme duke e pasur parasysh numrin e teksteve ligjore në të cilat është dashur të intervenohet, edhe atë: Ligji për Punë të Brendshme, Ligji për Policinë, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Ligji për Avokatin e Popullit, të cilët u miratuan nga Kuvendi në muajin janar dhe shkurt të vitit 2018, si dhe Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Prokurorinë Publike, të cilët u miratuan në tetor të vitit 2018.<sup>18</sup>

Një pjesë e këtyre ndryshimeve të legjislacionit kanë pasur për qëllim:

- (i) themelimin e **seksionit të veçantë në kuadër të Prokurorisë Publike**, kompetent për ndjekjen e rasteve të trajtimit joadekuat nga ana e autoriteteve/organeve për zbatimin e ligjit dhe agjencive të zbulimit;
- (ii) themelimin e **seksionit të veçantë në kuadër të Gjykatës Themelore Penale – Shkup** i cili do të veprojë ndaj atyre lëndëve dhe
- (iii) themelimin e **trupit kontrollues në kuadër të zyrës së Avokatit të Popullit** që përshin anëtarë të shoqërisë civile.

Me ndryshimet dhe plotësimet e **Ligjit për Punë të Brendshme**<sup>19</sup> parashikohet “pas pranimit të kallëzimit penal ose informacionit të pranuar se... nëpunësi policor ose personi i autorizuar zyrtar... me autorizime policore ka kryer vepër penale gjatë kryerjes së veprimit zyrtar ose ka kryer vepër penale jashtë detyrës përmes përdorimit të kërcënimit serioz, forcës ose mjeteve të shtrëngimit e që për pasojë e ka vdeqjen, lëndimin e rëndë trupor, lëndimin trupor, privimin e kundërligjshëm nga liria, torturën, si dhe trajtimin apo dënimin

<sup>15</sup> Paragrafi 47 i Planit të veprimit për grupin e lëndëve *Kitanovski*

<sup>16</sup> Paragrafi 42 i Planit të veprimit për grupin e lëndëve *Kitanovski*

<sup>17</sup> Paragrafi 46 i Planit të veprimit për grupin e lëndëve *Kitanovski*

<sup>18</sup> Elementet kryesorë të ndryshimeve ligjore janë përcaktuar në paragrafët 66 – 80 të Planit të veprimit për lëndën *Hajrullahu nga viti 2019*

<sup>19</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pPnë të Brendshme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 21 nga data 2.2.2018)

mizor, çnjerëzor ose poshtëruar, nëse me ligj është parashikuar ndjekje penale sipas detyrës zyrtare, *Ministria (e Punëve të Brendshme) pa prolongim e njofton Seksionin e hulumtimit dhe të ndjekjes së veprave penale të kryera nga persona me autorizime policore dhe nga pjesëtarë të policisë së burgjeve në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit*<sup>20</sup>, të cilës “bashkë me njoftimin ia dërgon... të gjitha burimet e informacioneve për veprën e kryer penale, kryerësin dhe viktimën dhe burime të tjera të informacionit që i ka në dispozicion.” (neni 64-a).<sup>21</sup>

Ndryshimet dhe plotësimet e **Ligjit për Avokatin e Popullit**<sup>22</sup> janë kryesore për vendosjen e mekanizmit për kontroll qytetar mbi punën e policisë përmes formimit të seksionit të veçantë në kuadër të Zyrës së Ombudsmanit. Neni i ri 11-v, parashikon se Avokati i Popullit bashkë me përfaqësuesit e organizatave (shoqatave) joqeveritare ndërmerr veprime për sigurimin e mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të veprave të këtitilla penale, të kryera nga persona me autorizime policore dhe nga persona pjesëtarë të policisë së burgjeve, si dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave të tyre në të gjitha procedurat që zhvillohen nga autoritetet/organet e administratës shtetërore, para prokurorisë dhe gjykatave, me ç'rast, kur një gjë e këtitillë është e nevojshme, në përputhje me ligjin mund të propozojë zbatim të serishëm të ndonjë procedure të caktuar (për shembull para prokurorisë kompetente publike).<sup>23</sup>

Në funksion të realizimit të kompetencave të tij të parashikuara me ligj, Avokati i Popullit, ndërmerr një varg veprimesh të cilat janë përmendur në nenin 11-g të këtij Ligji.<sup>24</sup> Veçanërisht e rëndësishme është ajo që ai ka në dispozicion edhe autorizime për kryerjen e vizitave të paparalajmëruara tek organet, institucionet dhe autoritetet, qasje deri te informacionet e klasifikuara dhe provat, pavarësisht shkallës së konfidencialitetit, ndërsa organet, organizatat

<sup>20</sup> Dispozitë identike është përcaktuar edhe në nenin 81-a të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Policinë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 21 nga data 2.2.2018), me plotësimin se për një gjë të këtitillë, Ministria harton raport me mendim dhe ia paraqet ministrit.

<sup>21</sup> Një dispozitë shumë e ngjashme është përcaktuar edhe në nenin 54-u të Ligjit për plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 21 nga data 2.2.2018) që ka të bëjë me detyrimin për veprimin emergjent të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve sipas informacionit të pranuar për ekzistimin e bazave të dyshimit se një vepër të këtitillë e ka kryer pjesëtar i policisë së burgut.” (paragrafi 70 i Planit të veprimit nga viti 2019)

<sup>22</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 35 nga data 23.2.2018)

<sup>23</sup> Jashtëzakonisht e rëndësishme është mundësia që ky mekanizëm të iniciojë procedurë sipas kërkesës së palës-viktimë ose të anëtarit të familjes së saj, sipas iniciativës së përfaqësuesve të sektorit joqeveritar, si edhe me iniciativë personale sipas informacioneve të pranuar (dyshim i bazuar) për shkelje të mundshme të së drejtës së jetës dhe ndalimin e torturës nga KEDNJ-ja (neni 11-gj). Me sa duket, pikërisht operacionalizimi i kësaj dispozite në praktikë mund të ndikojë në sanksionimin më të madh dhe në ndërprerjen e praktikës së mosndëshkimit në raste të këtitilla.

<sup>24</sup> Mes tjerash, këtu bënë pjesë: ndjekja dhe monitorimi i mënyrës së veprimit të të gjitha organeve, organizatave dhe institucioneve të përfshira; shqyrtimi i të gjitha shkresave të hetimeve të brendshme policore dhe të hetimeve tjera të brendshme të zbatuara nga autoriteti/organi kompetent; qasja dhe këqyrja e të gjitha dokumenteve (dokumentacioni mjekësor, deklaratimet e viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe të kryerësve dhe ngjashëm); sigurimi i provave materiale dhe verbale; realizimi i intervistave personale me viktimat, dëshmitarët dhe kryerësit; vizita në organet, organizatat, institucionet e përfshira të rasteve; paralajmërimi i hershëm i personave me autorizime policore dhe të pjesëtarëve të policisë së burgjeve; monitorimi i zbatimit të akteve normative, identifikimi i lëshimeve dhe paraqitja e iniciativave për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore dhe harmonizimi i tyre me traktatet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën, etj.

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

dhe autoritetet e kanë për detyrë të bashkëpunojnë me këtë mekanizëm dhe me kërkesë të tij t’ia sigurojnë të gjitha provat, të dhënat dhe informacionet, pavarësisht shkallës së konfidencialitetit, dhe t’i mundësojnë zbatim papengesa të procedurës (neni 31-v).

Për më tepër, me ndryshimet ligjore përcaktohet edhe përbërja e **mekanizmit për kontroll qytetar**, i cili përbëhet nga tre anëtarë të jashtëm nga shoqatat, të zgjedhur në konkurs publik, me mandat prej një viti, si persona të cilët në mesin e kushteve të tjera, të cilat duhet t’i plotësojnë, duhet të kenë pesë vjet përvojë pune në organizatat (shoqatat) joqeveritare në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtën e policisë dhe në jurisprudencë (neni 11-d). Në praktikë, u tregua se është i nevojshëm roli proaktiv i Kuvendit në drejtim të seleksionimit në kohë të duhur të anëtarëve të këtij mekanizmi.<sup>25</sup>

Me ndryshimet e **Ligjit për Prokurorinë Publike** të vitit 2018<sup>26</sup> parashikohet se “në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit themelohet Seksioni i specializuar për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të kryera nga persona me autorizime policore dhe nga persona pjesëtarë të policisë së burgjeve “(neni 15 paragrafi 3). Ndryshimet parashikojnë se ky Seksion është kompetent të veprojë, mes tjerash, edhe ndaj “veprave penale të kryera nga persona me autorizime policore dhe nga pjesëtarët e policisë së burgjeve” (neni 31 alineja 3), ku përfshihen veprat penale të kryera gjatë kryerjes së veprimit zyrtar, si dhe veprat e kryera jashtë shërbimit zyrtar me përdorimin e kërcënimit serioz, forcës ose mjeteve të shtrëngimit e që për pasojë e ka: vdekjen, lëndimin e rëndë trupor, lëndimin trupor, privimin e kundërligjshëm nga liria, torturën dhe trajtimin apo dënimin mizor, çnjerëzor ose poshtëruar, nëse me ligj është parashikuar ndjekje penale sipas detyrës zyrtare (neni 31-a, paragrafi 1).<sup>27</sup>

Edhe pse shteti vë në dukje probleme të caktuara sa i përket ekipimit kadrovik të këtij seksioni të veçantë,<sup>28</sup> kjo gjoja nuk është pasqyruar mbi punën e tij, meqë shteti i ka vënë në dukje edhe të dhënat konkrete për numrin e kallëzimeve penale që janë paraqitur, numrin e lëndëve të cilat janë në fazë hetimi, si dhe numrin e personave zyrtarë të policisë të cilët janë dënuar.<sup>29</sup> Megjithatë, vërehet mungesa e të dhënave të plota për këtë në raportet vjetore

<sup>25</sup> Konkursi i parë publik në bazë të të cilit duhej të bëhej zgjedhja nga ana e Kuvendit e organizatave joqeveritare të cilat do ta bëjnë mbikëqyrjen qytetare përfundoi pa sukses, dhe pastaj është publikuar thirrja e dytë publike (paragrafi 72 i Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019). Pas skadimit të mandatit të përfaqësuesve të zgjedhur në mekanizmin për kontroll qytetar pas thirrjes së dytë, në rrjedhë e sipër është procedura për përzgjedhjen e përfaqësuesve pas thirrjes së publikuar të tretë. Vendimi për shpalljen e këtij konkursi publik u publikua në datën 7.5.2021, megjithatë, kjo përzgjedhje akoma nuk është kryer nga ana e Kuvendit. Këto informacione i kemi siguruar nga përgjigjja e Kuvendit pas rekomandimit të Komisionit Ndërinstitucional që të bëhet përzgjedhja sipas konkursit të publikuar nga data 7.5.2021, të adresuar deri te Kuvendi. Pas përgjigjes së pranuar, e duke i pasur parasysh rrethanat, Byroja më datë 6.9.2021, Kryetari të Komisionit për Çështjet e Zgjedhjeve dhe Emërimeve pranë Kuvendit të RMV-së i dërgoi propozim për përzgjedhje në afat sa më të shkurtër.

<sup>26</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 198/2018 nga data 30.10.2018)

<sup>27</sup> Ndryshimet dhe plotësimet e theksuara u inkorporuan më vonë gjatë miratimit të Ligjit të ri për Prokurorinë Publike, veçanërisht në nenin 14 dhe 33. Shih: Ligji për Prokurorinë Publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 42 nga data 16.2.2020)

<sup>28</sup> Pas caktimit të prokurorëve, si dhe të dy hetuesve të veçantë të cilët do të veprojnë në këtë seksion, pas thirrjes së publikuar nga 24 gushti i vitit 2019, për përzgjedhjen e hetuesve plotësues, nuk ka pasur asnjë kandidat të paraqitur (paragrafi 77 i Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019)

<sup>29</sup> Paragrafi 78 i Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019

të këtij seksioni, të cilët janë të rëndësishme që të ndiqen tendencat aktuale, por edhe për shkak të këqyrjes nga opinioni i gjerë publik (duke e përfshirë edhe publikun profesional) në këto të dhëna të cilat duhet të grumbullohen në mënyrë të sistematizuar, me ç'rast do të sigurohet saktësia e tyre, ndërsa nga ana tjetër do të publikohen dhe do të jenë në dispozicion të publikut.

Gjithashtu, janë bërë ndërhyrje edhe në **Ligjin për Gjykatat** në drejtim të fuqizimit të rolit të gjykatave penale gjatë ndjekjes së veprimit joadekuat nga ana e nëpunësve policorë (agjentëve) për zbatimin e ligjit.<sup>30</sup> Me fjalë të tjera, u plotësua neni 32 paragrafi 1 i këtij ligji, kështu që gjatë renditjes së kategorive të veprave penale për të cilat kompetent është Seksioni i Specializuar Gjyqësor për Ndjekjen e Veprave nga Fusha e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në gjithë territorin e shtetit, i themeluar pranë Gjykatës Themelore Penale – Shkup, janë përfshirë edhe veprat e lartpërmendura penale të kryera nga nëpunësit policorë dhe nga personat zyrtarë me autorizime policore.

Në mesin e masave me karakter të përgjithshëm, me rëndësi jashtëzakonisht të madhe për parandalimin e shkeljeve të ardhshme materiale të nenit 3 mund të përcaktohen ndërhyrje që kanë të bëjnë me fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve të cilat duhet të luajnë një rol të caktuar në parandalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës.

Një shembull i këtyllë është vendosja e **Mekanizmit Parandalues Kombëtar (MPK)** në kuadër të zyrës së Avokatit të Popullit në përputhje me Protokollin e ratifikuar Fakultativ ndaj Konventës së KB-së kundër Torturës, Trajtitimit apo Dënimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës (OPKAT) si dhe **zgjerimi i kompetencave të Avokatit të Popullit** me ndryshimet ligjore nga data 29 shtator i vitit 2016 që duhet pozitivisht të pasqyrohen mbi pozitën e MPK.<sup>31</sup> Nga ana tjetër edhe **procedurat e reja operative standarde të MPB-së për trajtimin e personave të privuar nga liria**,<sup>32</sup> përfshirja e inspektorëve në strukturat e MPB-së për parandalimin e keqtrajtimit dhe torturës në duart e nëpunësve zyrtarë (agjentëve) të shtetit,<sup>33</sup> si dhe përforcimi kadrovik i Sektorit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale mund të ndikojnë pozitivisht në fuqizimin e efektivitetit të mekanizmit të brendshëm për kontroll mbi veprimet e ndërmarra nga ana e tyre.<sup>34</sup>

Sa u përket masave të cilat synojnë të sigurojnë efektivitet të hetimeve, ato kryesisht kanë të bëjnë me punën dhe **veprimin e organeve të prokurorisë**, edhe pse një pjesë e vogël e tyre janë fokusuar mbi **gjyqtarët penalë**.

Në drejtim të reduktimit të njëanshmërisë eventuale gjatë vendimmarrjes së prokurorit publik dhe intensifikimit të veprimeve prokuroriale në procedurat rrjedhëse penale, në LPP-në nga viti 2010, janë parashikuar, **afate të sakta instruktive**, të cilat prokuroria doemos

<sup>30</sup> Ligji për plotësimin e Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 21 nga data 2.2.2018)

<sup>31</sup> Për informacione të detajuara shih: paragrafët 25 – 27 të Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2017 dhe paragrafët 28 – 31 të Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019.

<sup>32</sup> Paragrafi 30 i Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019

<sup>33</sup> Paragrafi 33 i Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019

<sup>34</sup> Paragrafi 34 i Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

duhet t'i respektojë, si gjatë zbatimit të hetimeve ashtu edhe gjatë shqyrtimit të kallëzimeve penale.<sup>35</sup> Si e drejtë e posaçme është përfshirë edhe e drejta e palës së dëmtuar që të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për hedhjen poshtë të kallëzimit penal pranë prokurorit më të lartë publik, i cili ka për detyrë në afat prej 30 ditësh pas pranimit të vendosë ndaj ankesës së palës së dëmtuar, me ç'rast ai mundet me aktvendim ta konfirmojë aktvendimin për hedhjen poshtë të kallëzimit penal ose ankesën ta marrë në konsideratë dhe ta ngarkojë prokurorin më të ulët publik ta vazhdojë procedurën (neni 288, paragrafët 2, 4 dhe 5).<sup>36</sup>

Me rëndësi të madhe janë edhe dispozitat ligjore të përfshira në LPP-në nga viti 2010, me të cilat përfshihet hetimi nga ana e prokurorisë, në vend të gjyqtarëve hetues, me ç'rast vendosen autorizime dukshëm më të gjera për prokurorin publik gjatë zbatimit të hetimeve kundër pjesëtarëve të panjohur të forcave policore, me atë që formohet polici e veçantë gjyqësore, e cila është në varësi dhe në mbikëqyrje dhe kontroll të drejtpërdrejtë të prokurorit publik, para të cilit përgjigjet.<sup>37</sup> Me to garantohet qasja proaktive, si dhe paanshmëria e prokurorëve publikë.<sup>38</sup>

Për më tepër, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) pranë Këshillit të Evropës në Raportin e tij të vitit 2016<sup>39</sup> u është drejtuar autoriteteve vendore t'u dërgojnë mesazh të qartë prokurorëve, përmes të cilit do t'i përkujtojnë për detyrimet e tyre që të ndërmarrin veprime përkatëse çdoherë kur pranojnë informacione të cilat kanë të bëjnë me trajtim joadekuat. Në të vërtetë, edhe para, por edhe pas publikimit të këtij Raporti, Prokurori Publik Shtetëror rregullisht dërgon **instruksione të këtyllë deri te prokurorët më të ulët** që të veprojnë me kujdes të veçantë në të gjitha rastet që kanë të bëjnë me pretendimin për

<sup>35</sup> Për shembull, me nenin 275 të LPP-së përcaktohet afat prej tre muajsh për marrjen e vendimit për kallëzimin penal nga dita e pranimit të tij, me ç'rast nëse prokurori publik nuk e respekton këtë afat, ai ka për detyrë ta njoftojë menjëherë me shkrim paraqitësin e kallëzimit penal dhe prokurorin më të lartë publikë, para të cilit do t'i prezantojë edhe shkaqet për mos-marrjen e vendimit. Nga ana tjetër, neni 301 parashikon afat të qartë kohor për përfundimin e procedurës hetuese, i cili është gjashtë muaj nga dita e miratimit të urdhrin për zbatimin e procedurës hetuese, ndërsa nëse i njëjti nuk respektohet, prokurori publik e ka për detyrë ta njoftojë prokurorin e lartë publik, e që në lëndë më komplekse ky afat mund të vazhdohet edhe për gjashtë muaj. Me përjashtim, ky afat mund të vazhdohet edhe për tre muaj nga ana e prokurorit publik shtetëror. Shih paragrafët 49 – 51 të Planit të veprimit për grupin e lëndëve *Kitanovski*.

<sup>36</sup> Nga ana tjetër, në drejtim të përshejtimit dhe efikasitetit gjatë procedimit të gjyqtarëve penalë në rastet që kanë të bëjnë me pretendimin për veprim joadekuat policor, nga aspekti i legjislacionit, një peshë të konsiderueshme kanë edhe masat e përgjithshme të cilat synojnë ta parandalojnë prolongimin e procedurave penale, të cilat janë ndërmarrë pas shfaqjes së fakteve në rastet në fjalë të grupit *Kitanovski*, ndërkaq në kontekstin e grupit të lëndëve *Atanasoviq dhe të tjerët*, që kishte të bëjë me ekzistimin e mjetit efikas juridik në lidhje me zvarritjen e procedurave, e cila tanimë është mbyllur me Rezolutë përfundimtare të Komitetit të Ministrave. Shih: Resolution CM/ResDH(2016)35, Execution of the judgments of the European Court of Human Rights *Atanasovic and others and 55 cases against "the former Yugoslav Republic of Macedonia"* (Adopted by the Committee of Ministers on 8 March 2016 at the 1250th meeting of the Ministers' Deputies)

<sup>37</sup> Shih paragrafin 52 të Plan të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019 dhe paragrafin 52 të Planit të veprimit për grupin e lëndëve *Kitanovski*

<sup>38</sup> Për shembull, paanshmëria është vënë në pikëpyetje kur është nevojitur kohë jashtëzakonisht e gjatë joracionale për t'i hetuar pretendimet për veprimin brutal të nëpunësve policorë, për dallim nga veprimi i prokurorisë në lëndët e ngritura kundër aplikantëve (paragrafi 54 i aktgjykimit *X dhe Y*, paragrafi 91 i aktgjykimit në lëndën *Andonovski*).

<sup>39</sup> Report to the Government of "the former Yugoslav Republic of Macedonia" on the visit to "the former Yugoslav Republic of Macedonia" carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 7 to 17 October 2014 (CPT/Info(2016)8), став 13



brutalitet policor ndërsa për veprimet e ndërmarra të procesit t'i njoftojnë prokurorët më të lartë sipas hierarkisë, vartës të të cilëve janë.<sup>40</sup>

Në përputhje me këtë rekomandim të KPT-së, si dhe me vendimin e Komitetit të Ministrave të miratuar në dhjetor të vitit 2017, autoritetet kompetente përmes bartësve të funksioneve më të larta në pushtetin ekzekutiv, disa herë kanë dërguar **mesazh të qartë për zero tolerancë** për arrestime arbitrare, trajtim joadekuat dhe torturë, i cili mes tjerash, është i detyrueshëm për strukturat e MPB-së të cilat kanë vepruar në lëndën *Hajrullahu*.<sup>41</sup>

Në lidhje me shkeljen e konstatuar të nenit 6 të GJEDNJ-së në lëndën *Hajrullahu* është me rëndësi të theksohet se ajo nuk është bërë për shkak të ekzistimit të vakumit ligjor, përkatësisht për shkak të mangësive në kornizën aktuale ligjore, por është rezultat i zbatimit të gabueshëm të nenit 15 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Penale nga viti 1997, i cili ka qenë në fuqi në kohën e ngjarjeve të përfshira me lëndën *Hajrullahu*. Me fjalë të tjera, ky nen, ngjashëm si edhe LPP-ja aktuale, ka parashikuar se “*provat e siguruar në mënyrë të paligjshme ose përmes shkeljes së lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, si dhe provat që burojnë nga të njëjtat, nuk mund të përdoren dhe mbi të njëjtat nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor*”, ashtu siç në të vërtetë, theksohet edhe në paragrafin 52 të aktgjykimit në fjalë. Në këtë kuptim, edhe neni 215 i LPP-së nga viti 2010, ka përcaktuar “*nëse deklarimi i dëshmitarit është marr me forcë, me kërcënim ose me ndonjë mjet tjetër të ngjashëm të ndaluar, vendimi gjyqësor nuk mund të bazohet mbi këtë deklaratë të dëshmitarit*.”<sup>42</sup>

Si përgjigje ndaj nevojës që të parandalohen shkeljet e ngjashme të nenit 6 paragrafi 1, shteti para Komitetit të Ministrave ka demonstruar **ndryshime të caktuara të praktikës nga ana e gjyqtarëve të cilët e trajtojnë materien penale** përmes artikullimit të një sërë shembujve pozitivë nga praktika gjyqësore të cilët duhet të dëshmojnë se ajo është miratuar në përputhje me standardet e Konventës dhe se aktgjykimi dënues kundër ndonjë personi më nuk mund të bazohet mbi provat e siguruar në mënyrë të paligjshme.<sup>43</sup> Kjo tendencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, në të vërtetë është përshëndetur nga ana e KM-së, i cili ka apeluar deri te gjykatat të vazhdojnë me implementimin konsekuent të legjislacionit vendor në përputhje me kërkesat e Konventës.<sup>44</sup>

<sup>40</sup> Paragrafi 45 i Planit të veprimit për *Hajrullahu* nga viti 2017 dhe pjesërisht paragrafi 87 i Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019. Për më tepër, edhe në Planin e veprimit nga viti 2019 (Paragrafët 54 – 57) theksohet ndryshimi i metodave të punës së prokurorisë, me qëllim të parandalimit të pandëshkueshmërisë për trajtimin joadekuat dhe torturën nga ana e personave të autorizuar zyrtarë (agjentë) të shtetit.

<sup>41</sup> Paragrafët 44 – 50 të Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019

<sup>42</sup> Është potencuar edhe në paragrafët 93 dhe 94 të Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019

<sup>43</sup> Shih paragrafët 95 – 98 të Planit të veprimit për rastin *Hajrullahu* nga viti 2019

<sup>44</sup> 1288th meeting, 6 – 7 June 2017 (DH) H46-30 Hajrullahu v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Application No. 37537/07), Supervision of the execution of the European Court’s judgments, Reference document: CM/Notes/1288/H46-30, CM/Del/Dec(2017)1288/H46-30, 7 qershor, viti 2017, paragrafi 8

## Përmbledhje

Nevoja për masa të përgjithshme në lidhje me këtë grup të lëndëve, bëhet akoma më relevante nëse e marrim parasysh se ato për momentin janë nën mbikëqyrje të fuqizuar të Komitetit të Ministrave. Nga ana tjetër, duhet të shihet konteksti i gjerë dhe të merret parasysh fakti se nga miratimi i aktgjykimit të parë sipas nenit 3 në rastin kundër Maqedonisë së Veriut, deri më tani kundër shtetit janë shqiptuar gjithsej 17 aktgjykime në të cilat është konstatuar shkelja e ndalimit të torturës, trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.<sup>45</sup> Në këtë drejtim është edhe fakti se nga ana e GJEDNJ-së deri te Agjenti Qeveritar edhe më tutje dërgohen për prononcim aplikacione në të cilat problematizohet veprimi i policisë gjatë zbatimit të aksioneve të tyre, të cilat, mes tjerash, përmbajnë edhe pretendime për mangësi gjatë zbatimit të hetimit për abuzimet policore.<sup>46</sup>

Ndryshimet e theksuara ligjore të cilat janë risi sa i përket gjendjes së legjislacionit penal-të procesit i cili ka ekzistuar në kohën e miratimit të aktgjykimeve në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 3, në kohën kur ka qenë në fuqi LPP-ja e vjetër nga viti 1997, mesa duket janë relevante meqë i adresojnë shkeljet e përfshira në aktgjykimet, kështu që padyshim duhet të kontribuojnë në drejtim të ndërmarrjes në kohë të duhur të veprimeve nga ana e prokurorëve publikë gjatë fazave iniciuese të procedurës penale. Me to, do të duhej të anulohen mangësitë gjatë veprimit të deritanishëm të prokurorëve, të cilët, siç mund të shihet nga përshkrimet e lartpërmendura të gjendjes faktike në këto lëndë, në masë të madhe kanë kontribuar në drejtim të asaj që të konstatohen shkelje të Konventës.

Shteti ka shprehur bindje se ndryshimet e miratuara ligjore që kanë të bëjnë me mekanizmin e kontrollit të jashtëm në të ardhmen do të mund t'i parandalojnë shkeljet dhe në mënyrë efikase do t'i luftojnë shkeljet e ndryshme të kryera nga ana e personave zyrtarë të tij (agjentëve), duke përfshirë këtu edhe ndjekjen e tyre efikase në rast të veprimit joadekuat dhe torturës.<sup>47</sup> Megjithatë, është e nevojshme të tejkalohej vështirësitë të cilat paraqiten në praktikë, veçanërisht gjatë seleksionimit dhe angazhimit të organizatave joqeveritare, të cilat do ta përbënin mekanizmin mbikëqyrës qytetar pranë Avokatit të Popullit, me ç'rast duhet të shqyrtohet mundësia për zgjerimin e mandatit të tyre prej një viti, i cili mesa duket është tepër i shkurtër, dhe duhet të zhvillohen metoda të qarta bashkëpunimi midis Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesve të sektorit joqeveritar.

<sup>45</sup> Të gjitha këto lëndë kanë të bëjnë me keqtrajtimin nga ana e policisë (duke e përfshirë edhe lëndën *El-Masri*, katër lëndët e grupit *Jashar*, gjashtë lëndët e grupit *Kitanovski*, lëndët *Hajrullahu*, *Selami dhe të tjerët*, nr. 78241/13, aktgjykim nga 1 marsi i vitit 2018 dhe aktgjykimi i fundit për lëndën *Memedov*), përveç lëndës *Gjorgjiev*, nr. 26984/05, aktgjykim nga 19 prilli i vitit 2012, i cili ka të bëjë me trajtimin joadekuat të personit të dënuar në burg ku e vuan dënimin me burgim, si dhe L. R., nr. 38067/15, aktgjykim nga 23 janari i vitit 2020, gjendja specifike faktike e të cilit në detaje është prezantuar në vazhdim të kësaj analize.

<sup>46</sup> Për shembull, pretendimet e këtylla janë artikuluar edhe në rastin *Gorjan Atanasov kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, aplikacioni nr. 11331/18, i paraqitur më 28 shkurt të vitit 2018, ndërsa Qeverisë i është dërguar më 21 dhjetor të vitit 2020, për të cilën është marrë vendimi për ujdë miqësore më 20 maj të vitit 2021, ndërsa pretendimet për shkelje të procesit të nenit 3 në mënyrë eksplicite nuk janë përfshirë në lëndën *D. H. dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, aplikacioni nr. 44033/17, i paraqitur më 17 qershor të vitit 2017, ndërsa Qeverisë i është dërguar më 19 mars të vitit 2020.

<sup>47</sup> Shih paragrafin 80 të Planit të veprimit nga viti 2019

Njëkohësisht, është më se i nevojshëm kompletimi i mëtutjeshëm kadrovik i Seksionit të veçantë pranë Prokurorisë Publike, veçanërisht me hetues të pavarur, me qëllim që të ruhet progresi pozitiv.<sup>48</sup> Përveç kësaj, mund të shfaqet shqetësimi se gjatë krijimit të Seksionit të specializuar, në kompetencë të tij nuk kanë kaluar disa lëndë të caktuara rrjedhëse nga Prokuroria Publike me pretendime për torturë ose keqtrajtim nga ana e personave zyrtarë policorë, gjë e cila mund të krijojë problem nga aspekti i asaj se procedimi i tyre a është në përputhje me standardet dhe kërkesat e GJEDNJ-së. Prandaj, shteti është i thirrur që të gjejë zgjidhje për këtë problem. Nga ana e tij, Komiteti i Ministrave ka shprehur kënaqësi nga deklaratat e prezantuara formale në nivelin më të lartë politik përmes të cilave është dërguar mesazh i qartë për zero tolerancë ndaj torturës,<sup>49</sup> si dhe nga fuqizimi i kapacitetit për hetim efektiv të trajtimit joadekuat përmes mekanizmit “Prokuroria plus”, të zhvilluar në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe krijimi i trupit për kontroll qytetar pranë Avokatit të Popullit, për të cilin ka kërkuar t’i dërgohen informacione dhe statistika për funksionimin e tij praktik.

Po ashtu, duhet të theksohet se **zgjdhjet e reja ligjore në Kodin Penal**, të cilat nga muaji mars i vitit 2021 janë në dispozicion publik në formë të propozim-ligjit, akoma nuk janë miratuar.<sup>50</sup> Me to, mes tjerash, bëhet ripërkufizimi i inkrimacioneve ekzistuese në nenin 142 (“Tortura, trajtimi apo dënimi mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”) dhe neni 143 (“Keqtrajtimi gjatë kryerjes së detyrës”) në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, me ç’rast parashikohen edhe dënime më të larta nga dënimet aktuale.

Përfundimisht, ndryshimet parashikojnë **shmangie të institutit parashkrim** kur bëhet fjalë për këto dy vepra penale, që korrespondojnë me kërkesën eksplicite të Komitetit të Ministrave gjatë mbikëqyrjes të cilën e bën mbi ekzekutimin.<sup>51</sup> Kjo bëhet përmes ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në nenin 112 të KP-së, ku zgjerohet shtrirja e veprave për të cilat vlen mosparashkrimi përmes inkorporimit të veprës penale “Tortura” nga neni 142 paragrafët 1, 3 dhe 4 ndaj kategorisë së

<sup>48</sup> Përveç që është në rrjedhë e sipër procedura e seleksionimit të përfaqësuesve në mekanizmin e mbikëqyrjes qytetare, sipas informacioneve të fundit në seksionin e specializuar të veçantë, punojnë tre prokurorë publikë dhe tre bashkëpunëtorë profesionistë, si dhe dy hetues, të zgjedhur në dhjetor të vitit 2020, ndërsa përdoren edhe kapacitetet e Qendrës Hetuese.

<sup>49</sup> Ministers’ Deputies Decision, 1362nd meeting, 3-5 December 2019 (DH), H46-16 El-Masri and Hajrulahu v. North Macedonia (Applications Nos. 39630/09 and 37537/07), Supervision of the execution of the European Court’s judgments, Reference document: CM/Notes/1362/H46-16, CM/Del/Dec(2019)1362/H46-16, 5 December 2019, pika 6

<sup>50</sup> Për më tepër, shih Propozim-Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal nga 2 marsi i vitit 2021, në dispozicion në: [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=61439](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=61439) dhe Draft-Raportin për vlerësimin e ndikimit të legjislacionit – Propozim-Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal nga 2 marsi i vitit 2021, në dispozicion: [https://ener.gov.mk/files/propisi\\_files/plan/1\\_129921631302032021%201.pdf](https://ener.gov.mk/files/propisi_files/plan/1_129921631302032021%201.pdf)

<sup>51</sup> Me këtë hap shteti do të hyjë në grupin prej pesë shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, të cilat e kanë eliminuar parashkrimin e torturës dhe formave të tjera të trajtimit joadekuat të nenit 3, bashkë me: Turqinë, Rumaninë, Moldavinë dhe Armeninë. Deri më tani, të gjitha këto shtete, përmes ndryshimeve të legjislacionit vendor i kanë vënë fund parashkrimit ose planifikojnë këtë ta bëjnë brenda vitit 2022, që është iniciuar me qëllim të ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së me të cilat është konstatuar shkelja e nenit 3 të KEDNJ-së ([https://www.coe.int/en/web/execution/news/-/asset\\_publisher/j0QMuy0LrTts/content/member-states-end-prescription-for-torture?\\_101\\_INSTANCE\\_j0QMuy0LrTts\\_viewMode=view](https://www.coe.int/en/web/execution/news/-/asset_publisher/j0QMuy0LrTts/content/member-states-end-prescription-for-torture?_101_INSTANCE_j0QMuy0LrTts_viewMode=view)).

veprave penale në të cilat bën pjesë gjenocidi dhe krimet e luftës.<sup>52</sup>

Nevoja e veprimeve ligjore për eliminimin e parashkrimit, është evidente kur KM-ja ka shprehur “keqardhje se për shkak të përmbushjes së afatit të parashkrimit nuk ka mundësi të rihapet hetimi për aktet e torturës të cilat i ka pësuar aplikanti” dhe “ka pranuar se nuk është e mundshme masa individuale në këtë kuptim”.<sup>53</sup> Pastaj, ai e ka përshëndetur synimin e autoriteteve që ta përjashtojnë torturën nga afatet e parashkrimit dhe i ka inkurajuar të sigurojnë miratim të shpejtë të ndryshimeve të nevojshme të legjislacionit në këtë drejtim,<sup>54</sup> duke apeluar të prononcohen për mundësinë e shfuqizimit të afateve të parashkrimit për torturën, si element kyç për parandalimin e mosndëshkimit, veçanërisht duke e pasur parasysh se një gjë e këtillë ka qenë në përputhje me Orientimin XIV nga Udhëzimet e KM-së për luftimin e shkeljeve të pabazuara serioze të të drejtave të njeriut nga viti 2011, si dhe me standardet dhe rekomandimet e Komitetit Kundër Torturës të Kombeve të Bashkuara (UNKAT).<sup>55</sup>

Marrë në përgjithësi, mund të konsiderohet se me zgjidhjet e propozuara ligjore do të bëhet harmonizimi i legjislacionit tonë penal – material me standardet e pranuar ndërkombëtare dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, me ç’rast janë inkorporuar një pjesë e rekomandimeve të misionit të ekspertëve të Këshillit të Evropës, që u realizua nga fundi i vitit 2018 dhe fillimi i vitit 2019, me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë.<sup>56</sup> Duhet sa më shpejtë të miratohen ndryshimet ligjore të KP-së me ç’rast do të ndërmerret një hap esencial drejt mbylljes së plotë të kësaj lënde para Komitetit të Ministrave.

Për më tepër, pavarësisht asaj se nuk bëhet fjalë për mekanizëm efikas gjyqësor, përmes të cilit mund të konstatohet përgjegjësia penale e dikujt, por bëhet fjalë për organ/autoritet për shqyrtimin administrativ të parashtrësive kundër punës së nëpunësve policorë e që eventualisht mund të rezultojë me përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore, shteti do të duhet

<sup>52</sup> Në të vërtetë, duke pasur parasysh torturën e konstatuar, si dhe mungesën e hetimit efikas në të dyja lëndët në një periudhë të caktuar kohore, lëndën *Hajrullahu* e ka shqyrtuar KM-ja bashkë me lëndën *El Masri*, me ç’rast të dyja lëndët janë vënë në procedurën e mbikëqyrjes së fuqizuar, e që bëri presion të konsiderueshëm ndaj autoriteteve që t’i intensifikojnë përpjekjet e tyre në drejtim të ekzekutimit të këtyre lëndëve. Megjithatë, ekzekutimi i lëndës *El Masri* u mbyll me Rezolutë përfundimtare në të cilën është konstatuar se masat të cilat synojnë shmangien e parashkrimit të torturës, mbetet të shqyrtohen në kontekstin e lëndës *Hajrullahu*. Shih Resolution CM/ResDH(2019)369, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights *El-Masri against North Macedonia* (Adopted by the Committee of Ministers on 5 December 2019 at the 1362nd meeting of the Ministers’ Deputies)

<sup>53</sup> Ministers’ Deputies Decision, CM/Del/Dec(2017)1288/H46-30, 7 June 2017, 1288th meeting, 6-7 June 2017 (DH), H46-30 Hajrulahu v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Application No. 37537/07), Supervision of the execution of the European Court’s judgments, Reference document: CM/Notes/1288/H46-30, pika 2

<sup>54</sup> Ministers’ Deputies, Decision, CM/Del/Dec(2019)1362/H46-16, 5 December 2019, 1362nd meeting, 3-5 December 2019 (DH), H46-16 El-Masri and Hajrulahu v. North Macedonia (Applications Nos. 39630/09 and 37537/07), Supervision of the execution of the European Court’s judgments, Reference document CM/Notes/1362/H46-16, pika 9

<sup>55</sup> Ministers’ Deputies, 1362nd meeting, 3-5 December 2019 (DH) Human rights, H46-16 El-Masri and Hajrulahu v. North Macedonia (Applications Nos. 39630/09 and 37537/07), Supervision of the execution of the European Court’s judgments, Reference documents: DH-DD(2019)1232, DH-DD(2019)1231, CM/Del/Dec(2018)1318/H46-23, CM/Del/Dec(2017)1288/H46-30, CM/Notes/1362/H46-16, 5 December 2019, fq. 4

<sup>56</sup> Paragrafët 89 – 92 të Planit të veprimit nga viti 2019



të angazhohet edhe për ndryshime në funksionimin institucional të Sektorit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale pranë MPB-së. Në të vërtetë, vërejtje për mënyrën e veprimit të tij janë vënë në dukje edhe në aktgjykimet në fjalë të GJEDNJ-së, si dhe në raportet e Komitetit Evropian për parandalimin e torturës (KPT), ku shpeshherë theksohet nevoja për reformimin e tij.<sup>57</sup>

Në këtë drejtim, duhet të përhëndeten dispozitat e lartpërmendura të nenit 64-a nga Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Punë të Brendshme dhe nenit 81-a nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Policinë, me të cilat është përcaktuar detyrimi për raportimin e detyrueshëm, pa prolongim, nga ana e MPB-së për Seksionin e Specializuar pranë Prokurorisë Themelore Publike për çdo rast të veprimit në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së nga ana e nëpunësit policor ose nga personi i autorizuar zyrtar me autorizime policore. Kjo gjithsesi se do të kontribuojë në veprimin më efikas edhe të vet MPB-së në rastet e këtilla dhe në reduktimin e hapësirës për joprofesionalizëm.

Nga ana tjetër, në Raportin e fundit të KPT-së veçanërisht alarmohet edhe për përkeqësimin e gjendjes me trajtimin joadekuat që, mes tjerash, mund të shihen edhe në numrin e rritur të pretendimeve për keqtrajtim fizik nga ana e policisë në krahasim me periudhën e kaluar,<sup>58</sup> ndërsa kjo duhet të jetë një stimulim plotësues për shtetin për zbatimin më të shpejtë të të gjitha aktgjykimeve në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 3 të KEDNJ-së.

Edhe krahas asaj se një pjesë bukur e mirë e masave të cilat i ka ndërmarr apo parashikuar shteti janë adekuate, të cilat sigurisht se do të japin rezultate të caktuara në afat të mesëm dhe të gjatë, duke i pasur parasysh edhe disa prej aplikacioneve të reja para Gjykatës në bazë të nenit 3 të KEDNJ-së, është më se e evidente se nevojitet kohë që në të ardhmen të shihen efektet e tyre, që duhet të shihet edhe përmes reduktimit të konsiderueshëm, përkatësisht ndërprerjes së tendencës së dukurisë së lëndëve të reja në Strasburg, në mënyrë që të bëhet mbyllja e plotë e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e lëndëve të grupit *Kitanovski*.<sup>59</sup>

Përfundimisht, sfida kryesore për shtetin konsiston me gjetjen e mënyrave që të sigurojë zbatim efektiv dhe qëndrueshmëri të ndërhyrjeve të prezantuara legjislative dhe institucionale në afat më të gjatë me synimin final – parandalimin e pandëshkueshmërisë së torturës policore.

<sup>57</sup> Për shembull, shih: Report to the authorities of North Macedonia on the visit to North Macedonia carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 2 to 10 December 2019 CPT/Inf (2021) 8, fq. 23

<sup>58</sup> Shih: fq. 5 të Raportit të KPT-së nga viti 2019

<sup>59</sup> Në mbylljen e këtyre lëndëve duhet të kontribuojë edhe sigurimi i të dhënave konkrete përmes të cilave mund të konstatohet lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet ndryshimeve ligjore dhe ndryshimeve në praktikën gjyqësore dhe të prokurorisë, me ç'rast, mes tjerash, do të mbështeten supozimet për reduktimin e periudhës kohore brenda të cilës ndërmerren veprimet e prokurorisë. Në këtë kuptim, nevojitet një përkushtim dhe investim më i madh, më shumë përpjekje në nivel të gjyqësorit dhe prokurorisë publike.

## LËNDA L. R.<sup>60</sup>

### Gjetjet e GJEDNJ-së

Lënda ka të bëjë me lëshimin e autoriteteve që ta sigurojnë dinjitetin dhe mirëqenien e aplikantit për shkak të akomodimit të tij joadekuat në Entin për rehabilitim B.B.S., nga viti 2012 deri në vitin 2014, institucion shtetëror për persona me aftësi të kufizuara fizike të cilët nuk mund të kujdesen për nevojat e tyre. Aplikanti është një fëmijë me pengesa në zhvillim, kështu që meqë nuk i është siguruar kujdes përkatës, veprimi ndaj tij ka rezultuar me trajtim degradues në këtë Ent dhe për këtë Gjykata ka konstatuar shkelje të aspektit material të nenit 3.

Gjykata ka nënvizuar se trajtimi joadekuat të cilin e ka pranuar aplikanti përderisa ka qenë i vendosur në Ent është përkeqësuar për shkak të faktit se ai si një djalë tetëvjeçar shpeshherë është lidhur në këmbë për krevatin e tij, ndërsa veçanërisht shqetëson fakti se “masa” e këtitillë e cila vetvetiu nuk korrespondon me dinjitetin njerëzor, është përdorur përafërsisht një vit e nëntë muaj. Kjo ka pasur mundësi të ketë efekt më të madh psikologjik mbi fëmijën si i mitur sesa si i moshës madhore (paragrafi 80 i aktgjykimit). Edhe pse aplikanti është lidhur me pretendimin për “shkaqe sigurie”, Gjykata nuk është bindur se lidhja e fëmijës ka qenë masa më e vogël invazive në dispozicion në kontekstin e sigurisë së tij, meqë nuk ka pasur tregues se opsionet e tjera janë shqyrtuar ose zbatuar para ose gjatë aplikimit të asaj “mase” (paragrafi 81).

Nga ana tjetër, lënda ka të bëjë edhe me mospasjen e hetimit efektiv duke e pasur parasysh përgjigjen e përgjithshme joadekuate të autoriteteve gjatë hetimit të pretendimeve për shkelje serioze të të drejtave të njeriut (shkelje procedurale e nenit 3).

Për më tepër, duke vepruar ndaj kallëzimit penal, të paraqitur nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut kundër disa personave, i cili ka të bëjë me veprat penale “Tortura, trajtimi apo dënimi mizor, çnjerëzor ose poshtëruës” dhe “Keqtrajtim gjatë kryerjes së detyrës”, të dënueshme sipas neneve 142 dhe 143 të KP-së, prokurori themelor publik nuk e ka hedhur poshtë atë duke gjetur se veprimet e lëndës në kallëzimin nuk kanë pasur kurrfarë elementesh të veprave të theksuara penale ose të ndonjë veprë tjetër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Sipas tij, akti i lidhjes së aplikantit, nuk mund të konsiderohet si akt i përdorimit të paligjshëm të forcës ose kërcënimit me qëllim të shtrëngimit për të pranuar fajin ose për të shkaktuar vuajtje, dhe tek të pandehurit nuk ka pasur dashje, paramendim si element i detyrueshëm subjektiv i veprave të paraqitura penale, që aplikantin ta trajtojnë në mënyrë çnjerëzore apo poshtëruese, por qëllimi ka qenë të parandalohet që ai të arratiset nga Enti dhe të mos e vë në rrezik ose të vetë-lëndohet (paragrafët 20 dhe 91 të aktgjykimit).<sup>61</sup>

Gjykata ka qenë mjaft eksplicite kur ka konstatuar se problemi i procedurave në fjalë nuk ka të bëjë me përgjegjësinë individuale penale, por me përgjegjësinë ndërkombëtare-juridike

<sup>60</sup> L. R. kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 38067/15, aktgjykim nga data 23 janar i vitit 2020

<sup>61</sup> Gjendja e këtitillë faktike dhe arsyetimi, të përcaktuara nga prokurori themelor publik, më vonë u konfirmuan nga ana e Prokurorit të Lartë Publik dhe Prokurorit Publik i Shtetit (paragrafët 22 dhe 23 të aktgjykimit).

të shtetit, përkatësisht me përmbushjen e detyrimit të tij për zbatimin e hetimit efikas, i cili duhet të sigurojë zbatim efikas të ligjeve vendore të cilat e mbrojnë të drejtën për të mos u trajtuar në mënyrë joadekuatë, dhe në ato raste në të cilat janë të përfshirë nëpunës publikë apo organe/autoritete, ta sigurojë përgjegjësinë e tyre, sespe pa këtë detyrim për zbatimin e hetimit efikas do ta humbte kuptimin (paragrafi 92 i aktgjykimit).

Pastaj, Gjykata thekson se konkluzionet deri te të cilat ka ardhur prokuroria në kontekstin e akuzave të ngritura kundër të punësuarve në Ent: se akomodimi i aplikantit në Ent ka qenë joadekuat; se Enti i ka njoftuar autoritetet kompetente për pamundësinë e tij të kujdeset për aplikantin dhe se në të vërtetë ka pasur mangësi sa i përket diagnozës mjekësore të aplikantit nga spitali, nuk kanë çuar drejt ndonjë tentative efikase që të kontrollohet dhe të konfirmohet nëse lëshimet sistematike kanë qenë rezultat i veprimeve të përfaqësuesve të autoriteteve ose të ndonjë nëpunësi publik, për çka ata do të mund të konsideroheshin si përgjegjës (paragrafi 93 i aktgjykimit).

Marrë në përgjithësi, krahas faktit se organet kompetente nuk janë ballafaquar me pretendime se personeli ka vepruar me dashje në mënyrë joadekuatë me aplikantin, megjithatë, mungesa e reagimit përkatës gjatë hetimit ndaj pretendimeve se janë bërë shkelje serioze të të drejtave të njeriut në rastin konkret, është konsideruar si inkompatibile me detyrimin procedural të shtetit nga neni 3 i Konventës (paragrafi 94 i aktgjykimit).

## Ekzekutimi i aktgjykimit

Siç theksohet edhe në Planin e veprimit<sup>62</sup> të dorëzuar te Komiteti i Ministrave, burimi i shkeljes së konstatuar konsiston në akomodimin joadekuat të aplikantit në Ent që ka të bëjë me diagnozën e tij të gabuar, e cila i ka paraprirë akomodimit, dhe me mungesën e kujdesit të nevojshëm, që ka rezultuar nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruar.<sup>63</sup> Për një gjë të këtillë, nevojiten masa, si për përmirësimin e gjendjes së tij individuale, ashtu edhe për parandalimin në të ardhmen të gjendjeve të ngjashme me persona të tjerë të mitur të cenueshëm dhe me persona me aftësi të kufizuara.

Në këtë kuptim, nga Plani i veprimit mund të shihet se masat e përgjithshme për ekzekutimin e këtij aktgjykimi kryesisht kanë qenë të fokusuar në vendosjen e **deinstitutionalizimit** të plotë të personave me aftësi të kufizuara, si proces i cili në afat të gjatë duhet t'i parandalojë shkeljet e ardhshme materiale të kësaj natyre të nenit 3. Rrjedhimisht me faktet e rastit, në vitin 2018, Qeveria e miratoi Strategjinë Kombëtare për Deinstitutionalizim për periudhën kohore nga viti 2018 deri në vitin 2027. Strategjia parashikon transformim të institucioneve për mbrojtje sociale dhe përkujdesje, zhvillim të shërbimeve brenda bashkësisë dhe transferim të rezidentëve (personave të mbrojtur) të tyre në banesa më të vogla, si dhe sigurim të sistemit të mbrojtjes sociale, të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut

<sup>62</sup> 1390th meeting (December 2020) (DH), Action Plan (23/11/2020), Communication from North Macedonia concerning the case of L.R. v. North Macedonia (Application No. 38067/15), DH-DD(2020)1096

<sup>63</sup> Paragrafi 5 i Planit të veprimit

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

dhe dinjitetit të përdoruesve, përmes të cilave atyre do t'u ofrohet kujdes dhe shërbime të individualizuara dhe do të mbështetet zhvillimi dhe inkluzioni i tyre. Ajo në mënyrë të veçantë është fokusuar edhe mbi mbrojtjen e drejtave dhe interesave të fëmijëve me aftësi të kufizuara të akomoduar në institucione për mbrojtje sociale, deinstitutionalizimin e tyre dhe përfshirja në jetën e bashkësisë dhe në jetën sociale.<sup>64</sup> Kjo Strategji është shoqëruar me dokumentin për analizën e politikave dhe rekomandimeve,<sup>65</sup> hartuar në muajin prill të vitit 2020, në bashkëpunim me BE-në, qëllimi i së cilës ka qenë të bëhet vlerësimi i implementimit të saj.<sup>66</sup>

Në Planin e veprimit prezantohen rezultatet pozitive të kësaj Strategjie, me ç'rast në mënyrë të veçantë theksohet se deri në fund të vitit 2019, ka përfunduar akomodimi institucional i fëmijëve, kështu që të gjithë fëmijët paraprakisht të akomoduar në institucionet për përkujdesje sociale (siç ka qenë edhe aplikanti<sup>67</sup>) janë transferuar në objekte të bashkësisë, kështu që nuk ka pasur fëmijë që kanë qenë nën kujdesin institucional.<sup>68</sup> Me fjalë të tjera, sukcesi i këtij procesi u përshëndet edhe nga autoritetet relevante ndërkombëtare, siç është UNICEF-i dhe Komisioni Evropian.<sup>69</sup>

Sipas informacioneve të cilat shteti ia ka komunikuar Komitetit të Ministrave, në funksion të zbatimit të suksesshëm të deinstitutionalizimit u miratua **Ligji i ri për Mbrojtje Sociale në vitin 2019**,<sup>70</sup> i cili e ka parashikuar mundësinë e të jetuarit me mbështetje në bashkësi të veçantë banimi si mekanizëm për mbrojtje jashtëfamiljare, i cili sigurohet në njësi të veçantë banimi në të cilën mund të akomodohen më së shumti deri në pesë persona, përkatësisht shtatë fëmijë pa prindër ose pa kujdes prindëror.<sup>71</sup> Operacionalizimi praktik i këtij mekanizmi u mundësua me miratimin e **Rregullores për mënyrën dhe vëllimin e shërbimeve sociale, normave dhe standardeve për dhënie të shërbimeve sociale të jetesës me mbështetje**,<sup>72</sup> dispozitat e të cilës duhet të sigurojnë se individëve në gjendje të njëjtë si aplikanti do t'u ofrohet kujdesi adekuat dhe i nevojshëm.<sup>73</sup>

Shteti në mënyrë të drejtë potencon se mekanizmi i të jetuarit me mbështetje, mes tjerash, u dedikohet edhe personave me aftësi të kufizuara dhe se përmes tij do të tejkalohen dobësitë

<sup>64</sup> Paragrafët 18 – 19 të Planit të veprimit

<sup>65</sup> Policy analysis and Recommendation paper - Initial achievements and gaps in the accomplishment of the National Strategy of Deinstitutionalisation "Timjanik" and recommendations for further action, April 2020, Policy analysis and Recommendation paper prepared by EPTISA1 for the EU Delegation in North Macedonia

<sup>66</sup> Paragrafi 22 i Planit të veprimit

<sup>67</sup> Sipas paragrafit 6 të Planit të veprimit si pjesë e procesit të deinstitutionalizimit, më 27 dhjetor të vitit 2019, aplikanti është akomoduar në banesë të vogël grupore, ku është përshtatur mirë meqë bëhet fjalë për vend adekuat për trajtimin e tij, me kuadër të mjaftueshëm të kualifikuar që t'ia sigurojë kujdesin dhe mbështetjen e nevojshme dhe të komunikojë me të njëjtin.

<sup>68</sup> Paragrafët 23 dhe 30 të Planit të veprimit

<sup>69</sup> Paragrafët 28 dhe 29 të Planit të veprimit

<sup>70</sup> Ligji për Mbrojtjen Sociale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 104 nga data 23.5.2019

<sup>71</sup> Neni 87 i Ligjit për Mbrojtje Sociale

<sup>72</sup> Rregullorja për mënyrën dhe vëllimin e shërbimeve sociale, normave dhe standardeve, për ofertën e shërbimeve sociale jetë me mbështetje, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 264 nga data 20.12.2019

<sup>73</sup> Paragrafi 21 i Planit të veprimit

e akomodimit të aplikantit në institucion joadekuat i cili nuk mund të kujdeset për nevojat e tij,<sup>74</sup> të cilat, në të vërtetë kanë çuar deri në shkeljen e Konventës.

## Përmbledhje

Fitohet përshtypja se përmes aktiviteteve të lartpërmendura që kanë të bëjnë me deinstitutionalizimin, shteti theksin e ka vënë mbi parandalimin e shkeljeve të ardhshme të aspektit material të nenit 3 të konstatuara në aktgjykimin L. R.

Kur bëhet fjalë për masat e fokusuar mbi parandalimin e shkeljeve të ngjashme të aspektit të procesit të nenit 3, shteti kryesisht është përqendruar mbi konstatimin se në procedurë para GJEDNJ-së nuk ka lëndë të tjera të cilat iniciojnë pretendime për shkelje të ngjashme dhe se shtrirja e gjerë e aktgjykimit, duke përfshirë këtu edhe prokuroritë publike, bashkë me analizën e gjetjeve të hartuar nga Byroja e Përfaqësimit, do të jetë e mjaftueshme për parandalimin e shkeljeve të ardhshme të kësaj natyre.<sup>75</sup>

Sidoqoftë, duhet të merret parasysh se bëhet fjalë për rast të izoluar në praktikën e GJEDNJ-së kundër shtetit dhe rrethanat e këtyra duhet të rezultojnë me mbylljen e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e tij para Komitetit të Ministrave.

## II.2. Lëndë në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 5 të Konventës (e drejta e lirisë dhe sigurisë)

### GRUPI I LËNDËVE VASILLKOSKI DHE TË TJERËT<sup>76</sup>

#### Gjetjet e GJEDNJ-së

Lëndët të cilat bëjnë pjesë në këtë grup, kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtës së aplikantëve për liri dhe siguri nga neni 5 paragrafi 3 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së bazave konkrete dhe të mjaftueshme (të arsyetuara në mënyrë përkatëse) për arrestimin e tyre.<sup>77</sup>

Sipas Gjykatës, në këto lëndë, gjykatat vendase nuk kanë gjetur ekzistencë të asnjë fakti konkret në mbështetje të konkluzioneve të tyre. Kështu që, jashtë referimit të gjendjes

<sup>74</sup> Paragrafi 20 i Planit të veprimit

<sup>75</sup> Paragrafi 32 i Planit të veprimit

<sup>76</sup> Ky grup përbëhet nga katër lëndë: *Vasillkoski* nr. 28169/08, aktgjykim nga 28 tetori i vitit 2010; *Milladinov* nr. 46398/09, aktgjykim nga 24 prilli i vitit 2014; *Ramkovski* nr. 33566/11, aktgjykim nga 8 shkurti i vitit 2018; *Sejdiji* nr. 8784/11, aktgjykim nga 7 qershori i vitit 2018.

<sup>77</sup> Për shembull, tek *Vasillkoski dhe të tjerët*, vazhdimi i paraburgimit të aplikantëve disa herë është bazuar në rrezikun nga arratisja, në peshën e veprës dhe dënimin e mundshëm (paragrafi 60 i aktgjykimit).

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

pronësore të aplikantëve, gjendjes së tyre familjare dhe karakteristikave personale në kohën fillestare të paraburgimit të tyre, ata nuk e kanë vënë në pah asnjë aspekt specifik të karakterit ose sjelljes së tyre që do të mund ta arsyetonte ekzistimin e rrezikut të vazhdueshëm nga arratisja tek çdo aplikant, madje nuk i kanë trajtuar as argumentet e tyre të cilat janë prezantuar me qëllim të reduktimit të rrezikut të këtillë. Për Gjykatën ka mbetur e pa qartë pse ato nuk e kanë konsideruar se ai rrezik është shmangur sa u përket aplikantëve, pasaportat e të cilëve tanimë u ishin marrë, apo të cilët prezantuan fakte që i kanë vënë në dukje lidhjet e afërta me shtetin e paditur, aq më shumë që në asnjë stad të procedurës, gjykatat në vendimet e tyre nuk kanë dhënë sqarime pse alternativat e privimit nga liria nuk kanë qenë të mjaftueshme që të sigurojnë që gjykimi të zhvillohet sipas rrjedhës përkatëse (paragrafi 62 në *Vasillkoski dhe të tjerët*, ndërsa ngjashëm edhe në *Ramkovski*, paragrafi 63).

Aq më shumë, gjykatat vendase e kanë vazhduar paraburgimin e aplikantëve përmes aktvendimeve kolektive në të cilat e kanë përsëritur formulimin e njëjtë të shkurtë duke përdorur fjalë identike, kështu që, me sa duket i kanë pasur pak parasysh, nëse fare i kanë pasur, rrethanat e veçanta të secilit aplikant (paragrafi 63 *Vasillkoski dhe të tjerët*, paragrafi 57 *Milladinov dhe të tjerët*, paragrafi 67 *Ramkovski* dhe paragrafi 44 *Sejdiji*).

Marrë në përgjithësi, Gjykata konkludoi se duke mos u fokusuar në faktet konkrete dhe duke iu referuar kryesisht rëndësisë së veprave penale të cilat u janë vënë në barrë aplikantëve dhe dënimin potencial, autoritetet e vazhdonin paraburgimin e tyre (përkatësisht arrestin shtëpiak për aplikantin e dytë në lëndën *Milladinov dhe të tjerët*) mbi bazat, të cilat edhe pse jorelevante, nuk kanë qenë të mjaftueshme (paragrafi 64 në lëndën *Vasillkoski dhe të tjerët*, paragrafi 58 në lëndën *Milladinov dhe të tjerët* (paragrafi 69 në *Ramkovski* dhe paragrafi 44 në *Sejdiji*).

Së këtejmi, në lëndën *Milladinov dhe të tjerët*, përveç shkeljes së nenit 5 paragrafi 3 të Konventës, GJEDNJ-ja ka konstatuar edhe shkelje të nenit 5 paragrafi 4 për shkak të mosmbajtjes së seancës verbale dhe për mosrespektimin e parimit të barazisë së armëve në procedurat para Gjykatës së Apelit për rishikimin e paraburgimit (paragrafi 68 i aktgjykimit).

Me fjalë të tjera, në aktgjykimin është potencuar mangësia e legjislacionit vendor, i cili nuk ka parashikuar seancë verbale para Kolegjit dhe para Gjykatës së Apelit në procedurën e mbikëqyrjes, përkatësisht rishikim të aktvendimeve për paraburgim, ndërsa në rastin konkret paraburgimi i aplikantëve u është vazhduar pa e pasur mundësinë gojarisht t'i prezantojnë argumentet e tyre në procedurën e rishikimit të aktvendimeve për paraburgim, as para Kolegjit të Trupit Gjykoes e as para Gjykatës së Apelit (paragrafi 66).

Sa i përket barazisë së armëve është vërejtur se edhe Gjykata e Apelit Shkup vendimet e veta i ka miratuar pas pranimit të përgjigjes nga prokurori me të cilën është kërkuar të refuzohen ankesat e aplikantëve, me ç'rast të njëjtat nuk u janë dërguar aplikantëve, me çka nuk u është dhënë mundësia ta lexojnë vendimin e prokurorit, kështu që është cenuar e drejta e tyre për procedurë kontradiktore (paragrafi 67).

## Ekzekutimi i aktgjykimeve

Duke pasur parasysh se për lëndët që bëjnë pjesë në këtë grup janë ndërmarrë masa përkatëse individuale për ekzekutimin e tyre, kështu që secili prej aplikantëve veç veç janë lëshuar në liri, përkatësisht atyre të cilëve u është përcaktuar kompensim i drejtë i njëjti u është paguar në kohë, sfida kryesore gjatë ekzekutimit të këtyre aktgjykimeve ishte dizajnimi dhe zbatimi i masave të përgjithshme.

Rëndësia e tyre gjithnjë e më shumë vjen në shprehje, duke e pasur parasysh konstatimin se shkeljet në fjalë kanë qenë si rezultat i praktikës joadekuate të gjykatave vendase.<sup>78</sup> Nga ana tjetër, shteti në Raportin e adresuar deri te Komiteti i Ministrave<sup>79</sup> është përqendruar në ndryshimet e bëra në praktikën e gjykatave dhe prokurorive, por është fokusuar edhe mbi zhvillimin e legjislacionit, gjë që ka ndodhur në ndërkohë, që nënkupton ndryshime të tekstit të Ligjit për Procedurën Penale, i cili është zbatuar në momentin kur janë bërë shkeljet e nenit 5, të përcaktuara nga Gjykata në aktgjykimet në fjalë.

Mund të konsiderohet se shteti me të drejtë ka potencuar se me LPP-në nga viti 2010, janë fuqizuar garancitë mbrojtëse të nenit 5 të KEDNJ-së, veçanërisht me **nenin 167 paragrafi 2 pika 3 të LPP-së**, i cili e përfshin detyrimin e gjyqtarit – kryetari i Kolegjit të sigurojë justifikime të mjaftueshme për aktvendimet e paraburgimit, si dhe detyrimin të theksojë pse alternativat e paraburgimit nuk janë të mjaftueshme që të sigurohet prezenca e të pandehurit në procesin gjyqësor.<sup>80</sup> Intenca e ligjit të atëhershëm të ri ka qenë të shmangte praktika që gjykatat të përdorin formulime me fjali të shkurtra dhe identike kur e vazhdojnë paraburgimin.<sup>81</sup> Me sa duket, shteti në njëfarë mënyre, ishte i vetëdijshëm për ekzistimin e dobësisë sistematike sa i përket përdorimit të shpeshtë të masës së paraburgimit dhe mungesës së justifikimit të aktvendimeve për paraburgim, kështu që në LPP-në e vitit 2010, u inkorporuan dispozita të cilat kanë përcaktuar standarde më të forta për justifikimin e tyre.

<sup>78</sup> Paragrafi 13 i Planit të veprimit nga viti 2017. Përndryshe, nevoja për ngritjen e vetëdijes së gjyqtarëve për mënyrën e ndryshimit të veprimit në lëndët e paraburgimit, vihet në dukje qysh në mbledhjet e para të Komisionit Ndërinstitucional nga viti 2012 dhe viti 2013. Shih: Konkluzionet e miratuara në mbledhjen e parë të Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, mbajtur më datë 26.11.2012 (<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/1-1.pdf>) dhe Konkluzionet e miratuara në mbledhjen e dytë të Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, mbajtur më datë 13.3.2013 (<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/2.pdf>)

<sup>79</sup> Во однос на оваа група предмети, државата до Комитетот на министри доставила еден акционен план (1294th meeting (September 2017) (DH), Action plan (23/06/2017), Communication from “the former Yugoslav Republic of Macedonia” concerning the case of VASILKOSKI AND OTHERS v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Application No. 28169/08), DH-DD(2018)477) и еден акционен извештај (1318th meeting (June 2018) (DH), Action report (14/05/2018), Communication from “the former Yugoslav Republic of Macedonia” concerning the case of VASILKOSKI AND OTHERS v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Application No. 28169/08), DH-DD(2018)477).

<sup>80</sup> Paragrafi 15 i Planit të veprimit nga viti 2017. Neni 167 paragrafi 2 si vijon: “Në arsyetimin e aktvendimit për paraburgim detyrimisht duhet të specifikohen: 1) të gjitha faktet dhe provat nga të cilat buron dyshimi i bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale; 2) shkaqet e justifikuar të cilat e arsyetojnë çdo bazë veç e veç sipas të cilës është përcaktuar paraburgimi dhe 3) motivet për të cilat gjykata konsideron se qëllimi i paraburgimit nuk mund të realizohet me ndonjë masë tjetër për sigurimin e prezencës,”

<sup>81</sup> Paragrafi 16 i Raportit të veprimit nga viti 2018

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

Ajo që është akoma më e rëndësishme, shteti ka raportuar edhe për **harmonizimin e praktikës vendase me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së** përmes sigurimit të shkaqeve/motiveve më konkrete për vazhdimin e paraburgimit, me ç’rast merren parasysh rrethanat individuale në çdo rast të veçantë. Kjo qasje, veçanërisht është zhvilluar në lëndët e krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit, të cilat përfshijnë një numër të madh të personave të pandehur, me ç’rast gjykatat vendase synojnë të sigurojnë shkaqe/motive adekuate dhe të mjaftueshme për vazhdimin e paraburgimit për çdo të pandehur veç e veç, ashtu siç në të vërtetë e kërkon edhe praktika gjyqësore e Gjykatës në Strasburg.<sup>82</sup>

Megjithatë, ndryshimet në praktikën gjyqësore më shumë kanë të bëjnë me konstatimin e përgjithshëm, i cili nuk është mbështetur me të dhëna të mjaftueshme dhe adekuate statistikore të cilat do ta konfirmonin. Nga ana tjetër **sa u përket ndryshimeve të praktikës tek prokuroritë** të cilat, sipas shtetit, seriozisht i marrin parasysh gjetjet e GJEDNJ-së, në këto aktgjykime gjatë përpilimit të kërkesave për paraburgim, në drejtim të reduktimit të paraburgimeve dhe rritjes së numrit të rasteve në të cilat kërkohet masë tjetër sigurie për prezencën e të pandehurit, në përputhje me standardet e GJEDNJ-së,<sup>83</sup> shteti ka në dispozicion të dhëna relevante statistikore, të cilat tregojnë tendencë pozitive gjatë veprimit të gjykatave dhe prokurorive.<sup>84</sup> Megjithatë, këto të dhëna kanë të bëjnë vetëm për periudhën kohore nga viti 2013 deri në vitin 2016, kështu që paraqitet nevoja për sigurimin e të dhënave më të përditësuara nga ana e shtetit, të cilat do ta pasqyrojnë gjendjen aktuale. Në të vërtetë, këtu lind çështja e transparencës dhe e qasjes në të dhënat nga gjykatat dhe prokuroritë në lidhje me këtë problematikë.

Nga ana e shtetit janë bërë përpjekje në kontekst të **shkeljes së nenit 5 paragrafi 4** që është gjetur në lëndën *Milladinov dhe të tjerët*, në kuptim të asaj se, në të gjitha lëndët ku prokurori kompetent publik paraqet kërkesë për vazhdimin e paraburgimit të personit kundër të cilit mund të shqiptohet dënim me burgim prej më së paku katër vjet, të sigurohet që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij të njoftohen për seancën e Gjykatës së Apelit dhe të sigurohet prezenca e tyre para gjykatës së shkallës së dytë.<sup>85</sup> Në mënyrë plotësuese, sa i përket këtij ndryshimi të praktikës gjyqësore, është miratuar edhe **konkluzioni në nivel të gjykatave të apelit** në tetor të vitit 2015, i cili ka synuar unifikimin e praktikës së tyre. Aty është theksuar se nevojitet që kërkesa për vazhdimin e paraburgimit, e paraqitur nga prokurori kompetent, detyrimisht t’i dërgohet edhe të pandehurit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, e që mundëson harmonizimin e praktikës së gjykatave vendase me parimin e barazisë së armëve në procedurat e rishikimit dhe/ose vazhdimin të paraburgimit.<sup>86</sup>

<sup>82</sup> Paragrafi 16 i Planit të veprimit nga viti 2017

<sup>83</sup> Paragrafi 17 i Planit të veprimit nga viti 2017

<sup>84</sup> Për shembull, për dallim nga viti 2013, kur paraburgimi është shqiptuar në 239 raste, në periudhën nga viti 2014 deri në fund të tetorit të vitit 2016, Prokuroria Publike ka kërkuar paraburgim vetëm për 74 persona, ndërsa Gjykata Penale në Shkup, ka përcaktuar paraburgim në 67 lëndë, prej të cilave në gjashtë lëndë, masa e paraburgimit më vonë është zëvendësuar me masë tjetër për sigurimin e prezencës, ndërsa në gjashtë raste të tjera ka përcaktuar masa të tjera më pak ndërhyrëse, ndërkaq në një lëndë, kërkesa për shqiptimin e masës së sigurimit të prezencës u refuzua plotësisht. Për më shumë detaje, shih paragrafët 18 dhe 19 të Planit të veprimit nga viti 2017.

<sup>85</sup> Paragrafi 20 i Planit të veprimit nga viti 2017

<sup>86</sup> Paragrafi 21 i Planit të veprimit nga viti 2017



Siç thekson edhe shteti, masat që kanë të bëjnë me adresimin e mungesës së seancës verbale dhe mosrespektimi i parimit të barazisë së armëve në procedurat e paraburgimit, tanimë janë shqyrtuar në kuadër të lëndës *Mitreski*<sup>87</sup>, në të cilën ka pasur shkelje të njëjtë.<sup>88</sup>

E gjithë kjo ka qenë e mjaftueshme për Komitetin e Ministrave të konkludojë se shteti i ka plotësuar detyrimet e veta nga neni 46 paragrafi 2 të Konventës në pjesën e masave individuale dhe ta mbyllë shqyrtimin e lëndës *Milladinov dhe të tjerët*, edhe pse masat e përgjithshme të tjera të cilat kanë qenë të nevojshme si përgjigje ndaj mangësive të konstatuara nga ana e Gjykatës, kanë mbetur të shqyrtohen në kuadër të lëndës, përkatësisht grupit të lëndëve *Vasillkoski dhe të tjerët*.<sup>89</sup>

## Përmbledhje

Rrjedhimisht me mbylljen e lëndës *Milladinov dhe të tjerët*, lëndës kryesore të grupit *Vasillkoski dhe të tjerët* do t'i bashkëngjiten aktgjykimet sapo të miratuara të lëndëve *Ramkovski dhe Sejdi*. Megjithatë, me këtë nuk përfundon numri i lëndëve para GJEDNJ-së në të cilat trajtohen çështje të ngjashme që kanë të bëjnë me të drejtën e lirisë dhe sigurisë. Në të vërtetë, pas miratimit të aktgjykimit *Sejdi* më 7 janar të vitit 2018, si aktgjykim i fundit i këtij grupi, shtetit i janë dërguar (komunikuar) për përgjigje edhe disa lëndë në të cilat janë prezantuar pretendime ankimore të nenit 5, me ç'rast në disa prej tyre bëhet fjalë për shkelje të mundshme të nenit 5 paragrafi 3 të Konventës, pikërisht nga aspekti i justifikimit të shkaqeve për vazhdimin e paraburgimit të aplikantit.<sup>90</sup>

Në periudhën e njëjtë, u miratua edhe një vendim në të cilin Gjykata konstatoi se pas përpjekjes së pasuksesshme që të arrihet ujdë miqësore me aplikantin, Qeveria bëri një deklaratë unilaterale, si njohje e njëanshme se në rrethanat e lëndës nuk janë përmbushur kërkesat për mbrojtjen e të drejtave të aplikantit nga neni 5 paragrafi 3 të KEDNJ-së.<sup>91</sup> Njëkohësisht, shteti e ka ndërmarrë detyrimin që aplikantit t'i paguajë kompensim të drejtë për dëmin e pësuar material dhe jomaterial të krijuar për shkak të mospasjes së shkaqeve/motiveve relevante dhe të mjaftueshme për paraburgimin e vazhduar të aplikantit.<sup>92</sup> Në vendim, GJEDNJ-ja në mënyrë eksplicite i është referuar praktikës së saj tanimë të vendosur sa u përket lëndëve të grupit *Vasillkoski dhe të tjerët*<sup>93</sup>. Kjo e mundësoi

<sup>87</sup> *Mitreski*, nr. 11621/09, aktgjykim nga 25 qershori i vitit 2010

<sup>88</sup> Paragrafi 28 i Raportit të veprimit nga viti 2018

<sup>89</sup> Resolution CM/ResDH(2018)312, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights *Milladinov and Others against "the former Yugoslav Republic of Macedonia"* (Adopted by the Committee of Ministers on 5 September 2018 at the 1322nd meeting of the Ministers' Deputies)

<sup>90</sup> *Kiro Todorovski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Aplikacioni nr. 26233/18 dhe 2 aplikacione të tjera, të paraqitura më 30 maj, 13 dhe 20 dhjetor të vitit 2020, të dërguara në Qeveri më 18 shtator 2020; si dhe *Kërsto Mukoski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Aplikacioni nr. 16376/18, i paraqitur më 3 prill të vitit 2018, i dërguar në Qeveri më 10 shkurt të vitit 2021.

<sup>91</sup> *Kuzmanoviq kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 72408/14, vendim nga 18 dhjetori i vitit 2018

<sup>92</sup> Paragrafi 5 i vendimit

<sup>93</sup> Paragrafi 10 i vendimit

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

shlyerjen e lëndës nga lista e lëndëve, në përputhje me nenin 37 paragrafi 1 pika v) të KEDNJ-së, me ç'rast është shmangur rreziku i miratimit të aktgjykimit të ri me të cilin do të konstatoheshin shkeljet e njëjta, i cili pastaj do të ishte në mbikëqyrje të vazhdueshme sa i përket ekzekutimit të tij.

Dukuria e aplikacioneve të reja përsëritëse që kanë të bëjnë me problematikën e njëjtë në lidhje me paraburgimet dhe justifikimin e aktvendimeve për paraburgim, e vë në dukje mangësinë strukturore e cila edhe më tutje është e pranishme në sistemin maqedonas të jurisprudencës, i cili pa mëdyshje ka nevojë për ndërhyrje sistematike që duhet të manifestohet përmes ndryshimeve të pa vonesë të praktikës së veprimit, e që në mënyrë të drejtpërdrejtë varet nga ndërgjegjësimi dhe edukimi i avancuar i gjyqtarëve të cilët vendosin për kërkesat e vazhdimin të masës së paraburgimit. Nga ana tjetër, ndërhyrja e këtillë është pritur një kohë të gjatë duke e pasur parasysh faktin se kaluan më shumë se 10 (dhjetë) vjet pasi që ky grup i lëndëve u formua për herë të parë dhe ka qenë në rend dite për shqyrtim para KM-së.

### II.3. Lëndë në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 6 të Konventës (e drejta e gjykimin të drejtë)

#### GRUPI I LËNDËVE NASTESKA<sup>94</sup>

##### Gjetjet e GJEDNJ-së

Lëndët *Nasteska* dhe *Atanasov* kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtës së aplikantëve për gjykim të drejtë nga neni 6 paragrafi 1 të Konventës, meqë gjykatat më të larta vendase nuk e kanë respektuar parimin e barazisë së armëve me atë që e kanë thirrur vetëm prokurorin publik, por jo edhe aplikantët, të marrin pjesë në seancat e procedurave penale të ngritura kundër tyre.

Në lëndën *Nasteska*, edhe pse aplikantja e ka praktikuar të drejtën e saj të nenit 362 paragrafi 1 nga LPP-ja e vitit 1997 që ka qenë në fuqi, duke kërkuar të njoftohet për datën e mbajtjes së seancës së Gjykatës së Apelit në Manastir, megjithatë, ajo nuk ka pasur thirrje që të marrë pjesë në seancën e fundit të mbajtur në fazën finale të procedurës, kur Gjykata e Apelit e ka konfirmuar aktgjykimin dënues/e fajësisë. Për dallim nga ajo, prokurori publik, në atë situatë i është referuar shkresës së tij dhe ka mbajtur fjalimin përmblyës duke kërkuar që të refuzohet ankesa e aplikantes, ndërsa ajo nuk ka pasur mundësi të përgjigjet meqë nuk ka qenë e informuar për mbajtjen e seancës (paragrafi 28).

<sup>94</sup> Ky grup përbëhet nga tri lëndë: *Nasteska*, nr. 23152/05, aktgjykim nga 27 maji i vitit 2010; *Atanasov*, nr. 22745/06, aktgjykim nga 17 shkurti i vitit 2011 dhe *Eftimov*, nr. 59974/08, aktgjykim nga 2 korriku i vitit 2015.



Në lëndën *Atanasov*, Gjykata e Apelit në Shkup ka vendosur për ankesën e paraqitur nga aplikanti kundër aktgjykimit dënues/të fajësisë të shkallës së parë në seancë jopublike, për datën për të cilën ka qenë i njoftuar vetëm prokurori publik në përputhje me nenin 361 paragrafi 1 nga LPP-ja e vitit 1997. Shkelja buron nga fakti që prokurori publik ka qenë i pranishëm në seancë dhe ka dhënë pretendencën përfundimtare duke kërkuar që ankesa e aplikantit të refuzohet, ndërsa aplikanti nuk ka qenë i pranishëm meqë ai nuk është njoftuar për mbajtjen e seancës, kështu që ai nuk ka pasur mundësi t'i përgjigjet pretendencës së prokurorit. Sipas Gjykatës, fakti që aplikanti nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e tij, sipas nenit 361 paragrafi 1 (a contrario i *Nasteskës*, me ç'rast aplikantja një gjë të këtillë e ka bërë), nuk duhet të kuptohet në dëm të saj (paragrafi 32).

Në të dy këto aktgjykime, Gjykata është e mendimit se prezenca e prokurorit publik në seancën jopublike të Gjykatës së Apelit atij ia ka mundësuar, qoftë edhe në shikim të parë, mundësinë plotësuese ta fuqizojë konfirmimin e tij, pa frikë nga kundërshtimi i palës tjetër (paragrafi 28 nga lënda *Nasteska* dhe paragrafi 33 nga lënda *Atanasov*).

Në këto lëndë, GJEDNJ-ja konstatoi pabarazi e cila rezulton nga vet ligji, meqë dispozitat relevante të LPP-së, vetëm prokurorit publik ia kanë siguruar të drejtën automatikisht të njoftohet për seancën e Gjykatës së Apelit, ndërsa këtë të drejtë të pandehurit ia kanë kufizuar vetëm për rastin kur ai do të kërkojë një gjë të këtillë. Gjykata nuk ka gjetur motive/shkaqe përse prokurori publik ka trajtim të privilegjuar, i cili është palë në procedurë dhe është kundërshtari i të pandehurit (paragrafi 32 në lëndën *Atanasov* dhe paragrafi 40 në lëndën *Eftimov*).

Aktgjykimi *Eftimov* ka të bëjë me faktin se Gjykata Supreme ka vendosur për ankesat e palëve në seancën e mbajtur vetëm me prezencën e prokurorit publik (paragrafi 15), në të cilën nuk e ka thirrur aplikantin, i cili është akuzuar në procedurën penale vendore. Në këtë seancë, ankesa e prokurorit publik është marrë në konsideratë, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit me të cilin aplikanti (mjek që është akuzuar në lidhje me gabim mjekësor) u lirua nga përgjegjësia penale është modifikuar dhe ai është shpallur si fajtor për vepra të rënda kundër shëndetit të njerëzve, me ç'rast i është shqiptuar dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej një viti. Meqë aplikanti nuk është informuar për mbajtjen e seancës së Gjykatës Supreme, ai nuk e ka realizuar të drejtën e vet sipas nenit 362 paragrafi 1 nga LPP-ja në fuqi. Gjykata edhe këtu nuk ka gjetur shkaqe/motive përse prokurori publik ka trajtim të privilegjuar dhe është e mendimit meqë çështja faktike që është dashur të zgjidhet në Gjykatën Supreme ka të bëjë me ekzistimin e motivit të aplikantit për kryerjen e veprës, ka pasur nevojë akoma më të madhe që aplikanti të thirret dhe atij t'i ofrohet mundësia të jetë i pranishëm në seancën e Gjykatës Supreme në nivel të njëjtë si edhe prokurori publik (paragrafi 40). Megjithatë, prezenca e prokurorit publik në atë seancë atij ia ka dhënë mundësinë plotësuese ta deklarojë pretendencën e tij, pa frikë nga kundërshtimi nga ana e aplikantit (paragrafi 41).

Në mënyrë plotësuese, sa i përket shkeljes kryesore të nenit 6 nga Konventa e përshtetur më lartë, në lëndët *Eftimov* dhe *Nasteska*, po ashtu, është konstatuar edhe shkelja e të drejtës së gjykimin të drejtë në afat të arsyeshëm nga neni 6 paragrafi 1, duke pasur parasysh zvarritjen

tejt mase të procedurës penale (*Eftimov*, paragrafi 34; ngjashëm me këtë, edhe në lëndën *Nasteska*, paragrafi 37).<sup>95</sup>

### Ekzekutimi i aktgjykimeve

Gjatë gjithë periudhës së kaluar, nga ana e shtetit janë adresuar dy plane të veprimit, në vitin 2015 dhe 2020, përmes të cilëve njoftohet për masat e ndërmarra dhe të planifikuara për ekzekutimin e aktgjykimeve në fjalë.<sup>96</sup> Distanca kohore prej thuaja se pesë vjet midis adresimit të dy planeve të veprimit, e vë në dukje mungesën e masave mjaftueshëm esenciale të ndërmarra nga organet/autoritetet kompetente shtetërore, veçanërisht sa u përket ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe për këtë shkak nuk ka pasur informacione të mjaftueshme të reja, të cilat në mënyrë përkatëse do të pasqyroheshin në Planin e veprimit të ri ose në Raportin e veprimit të ri, i cili do t'i dërgohet Komitetit të Ministrave.

Shkeljet esenciale në lëndët *Nasteska* dhe *Atanasov* kanë qenë rezultat i pabarazisë që buron nga LPP-ja (shih më lartë, paragrafi 32 në lëndën *Atanasov* dhe paragrafi 40 në lëndën *Eftimov*), kështu që ka qenë më se e nevojshme të bëhen ndërhyrje përkatëse ligjore, të cilat, për fat të keq, shumë vjet pas miratimit të këtyre aktgjykimeve, akoma nuk janë realizuar deri në fund.

Për më tepër, me miratimin e LPP-së në vitin 2010, në nenin 421 paragrafi 3, është përcaktuar dispozitë sipas së cilës për seancën e Kolegjit të Gjykatës së shkallës së dytë do të njoftohet prokurori publik, dhe i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, ose paditësi privat, i cili në afatin e paraparë për ankesë ose për përgjigje ndaj ankesës ka kërkuar të njoftohet për seancën ose ka propozuar të mbahet seancë para gjykatës së shkallës së dytë. Megjithatë, ashtu siç e ka konfirmuar edhe vet shteti, kjo dispozitë me asgjë nuk ndryshon nga neni 362 paragrafi 1 i LPP-së nga viti 1997, i cili ka qenë në fuqi në momentin e ndodhjes së shkeljeve.<sup>97</sup>

Së këtejmi, si e domosdoshme imponohet nevoja për ndryshime më esenciale ligjore, të cilat në mënyrë të drejtë do t'i adresojnë shkeljet e konstatuara të standardeve të Konventës që kanë të bëjnë me barazinë e armëve në procedurat penale dhe njëherësh

<sup>95</sup> Zbatimi i masave të përgjithshme për tejkalimin e problemeve sistematike që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen tejt mase të procedurave gjyqësore të cilat kanë ekzistuar në kohën e zhvillimit të procedurave të analizuara në këtë lëndë, nuk janë përfshirë në këtë Analizë. Për më tepër, ato nuk janë as objekt i mbikëqyrjes së Komitetit të Ministrave, meqë shteti në mënyrë të drejtë ka përcaktuar se masat e përgjithshme, të cilat synojnë rritjen e efikasitetit të procedurave penale, tanimë janë shqyrtuar në kuadër të grupit të lëndëve *Atanasoviq*, nëngrupit të lëndëve *Nankov*, të cilat janë mbyllur me Rezolutën përfundimtare CM/ResDH(2016)35 (paragrafi 48 i Planit të veprimit nga viti 2020).

<sup>96</sup> Për *Nasteska* dhe *Atanasov*, 1243 meeting (8-10 December 2015) (DH), Action plan (11/09/2015), Communication from "the former Yugoslav Republic of Macedonia" concerning the cases of *Nasteska* and *Atanasov* against "the former Yugoslav Republic of Macedonia" (Applications No. 23152/05, 22745/06), DH-DD(2015)976, ndërsa për të tri lëndët bashkërisht, duke përfshirë këtu edhe lëndën *Eftimov*, 1383rd meeting (29 September - 1 October 2020) (DH), Action Plan (04/06/2020), Communication from North Macedonia concerning the group of cases of *NASTESKA v. North Macedonia* (Application No. 23152/05), DH-DD(2020)497

<sup>97</sup> Sipas Planit të veprimit nga viti 2015 dhe paragrafit 24 të Planit të veprimit nga viti 2020

do ta parandalojnë dukurinë e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen. Më konkretisht, ndryshimet duhet të sigurojnë garanci të procesit për të pandehurit në procedurat penale përmes garantimit të mundësisë për prezencën e tyre në gjykatat e shkallës së dytë, njëlloj si edhe prokurori publik, kështu që të dyja palët e procedurës, përkatësisht edhe prokurori publik edhe mbrojtja, detyrimisht duhet të njoftohen për seancën para gjykatës më të lartë. Me këto ndryshime, duhet të eliminohet pabarazia ndërmjet palëve dhe pozita e privilegjuar e prokurorit publik.

Nga planet e veprimeve të paraqitura, rezulton se qysh më herët janë ndërmarrë përpjekje të caktuara në këtë drejtim. Në të vërtetë, që nga 28 tetori 2012, është formuar grupi i punës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, detyra kryesore e të cilit ka qenë hartimi i tekstit të ri të LPP-së, i cili mes tjerash, është fokusuar edhe në inkuorporimin e garancive të nevojshme të procesit për të pandehurit në procedurat penale.<sup>98</sup> Megjithatë, edhe krahas pritshmërisë që këto ndryshime të miratohen nga Kuvendi në gjysmën e parë të vitit 2016,<sup>99</sup> kjo gjë asnjëherë nuk u realizua për shkaqe të ndryshme.<sup>100</sup> Me sa duket, LPP-ja e re realisht nuk do të mund të miratohet deri në fund të vitit 2021.<sup>101</sup>

Për dallim nga ngecja në pjesën e legjisllacionit, shteti para Komitetit të Ministrave ka prezantuar një varg të shembujve pozitiv nga praktika e Gjykatës Supreme në periudhën kohore nga viti 2014 deri në vitin 2019, të cilat nënkuptojnë lëvizje përpara dhe ndryshime në drejtim të mundësisë që edhe i pandehuri dhe përfaqësuesi i tij, si edhe prokurori publik, të marrin pjesë në seancën e Gjykatës Supreme, madje edhe atëherë kur ato nuk kanë kërkuar të njoftohen dhe të thirren, që ka qenë në përputhje me gjetjet në lëndën *Eftimov*.<sup>102</sup> Përveç kësaj, Gjykata Supreme ka miratuar edhe shumë aktgjykime me të cilat i ka anuluar aktgjykimet e gjykatave të apelit për shkak të shkeljes së parimit të barazisë së armëve, në drejtim të identifikimit të praktikës gjyqësore vendase dhe zbatimit konsekuent të këtij parimi.<sup>103</sup>

## Përmbledhje

Edhe përkundër asaj se ndryshimet e theksuara në praktikën e gjykatës më të lartë në shtet mund të kenë rëndësi jashtëzakonisht të madhe për implementimin konsekuent të standardeve të Konventës në nivel kombëtar, në mënyrë plotësuese mund të rekomandohet që një orë e më

<sup>98</sup> Sipas Planit të veprimit nga viti 2015 dhe paragrafit 25 të Planit të veprimit nga viti 2020

<sup>99</sup> Siç është potencuar në Planin e veprimit nga viti 2015.

<sup>100</sup> Shteti e arsyeton mosmiratimin e tyre me krizën politike e cila zgjati deri në fund të gjysmë vjetorit të parë të vitit 2017 dhe me mosfunksionimin e Dhomës Ligjvënëse, me ç'rast edhe pse ka pasur një "relaksim" të bllokimit të procesit ligjvënës, përmes formimit të grupit të ri të punës në Ministrinë e Drejtësisë, i cili punon në hartimin e LPP-së së re, megjithatë ky proces përsëri u ndërpre duke e pasur parasysh pandeminë e Covid-19 dhe gjendjen e shpallur të jashtëzakonshme më 18 mars të vitit 2020 (paragrafët 26 – 28 të Planit të veprimit nga viti 2020).

<sup>101</sup> Paragrafi 28 i Planit të veprimit nga viti 2020

<sup>102</sup> Paragrafët 30 – 34 të Planit të veprimit nga viti 2020

<sup>103</sup> Paragrafi 35 i Planit të veprimit nga viti 2020

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

parë të fillojë miratimi i ndryshimeve kaq shumë të pritura ligjore dhe inkuorporimi i standardeve të Strasburgut në tekstin e LPP-së së re.

Së këtejmi, grupi i punës pranë Ministrisë së Drejtësisë, duhet seriozisht t'i merr parasysh këto standarde gjatë hartimit të Ligjit të ri për Procedurën Penale, si dhe ta intensifikojë punën e vet në periudhën e ardhshme kohore, në mënyrë që ta kompensojë atë që është humbur në periudhën e kaluar. Për më tepër, pritjet menjëherë pas finalizimit të hartimit të tekstit të propozim-ligjit të ri nga ana e grupit punues, i njëjti të miratohet në Qeveri, dhe pastaj Kuvendi duhet të tregojë mirëkuptim për nevojën dhe emergjencën e LPP-së së re dhe i njëjti të miratohet në afat sa më të shkurtër pas paraqitjes së propozim-ligjit në dhomën ligjvënëse.

Duke i pasur parasysh zvarritjet evidente gjatë zbatimit të masave ligjore, të cilat kanë kontribuar që ekzekutimi i këtyre aktgjykimeve të zgjasë më shumë se 6 vjet (sa i përket lëndës *Eftimov*), dhe deri në më shumë se 15 vjet (sa i përket lëndës *Nasteska*), si e dobishme do të konsiderohet edhe ndërmarrja e instrumenteve të tjera, të cilat, në ndërkohë, në pritje të LPP-së së re, do ta ndihmonin këtë proces.

Për shembull, duke e pasur parasysh praktikën e deritanishme pozitive të Gjykatës Supreme, të fokusuar mbi sigurimin dhe zbatimin e parimit të barazisë së armëve, por edhe në nivel të gjykatave të apelit, mund të shqyrtohet mundësia për miratimin e një qëndrimi parimor ose opinionit të drejtë parimor nga ana e Gjykatës Supreme, përkatësisht një konkluzioni të katër gjykatave të apelit përmes të cilave do të ketë një qëndrim përkatës në drejtim të harmonizimit të ndarjes së drejtësisë të gjykatave vendase me praktikën e GJEDNJ-së, kështu që në të ardhmen në kohë të duhur do të parandalohen shkeljet e ngjashme të Konventës të karakterit përsëritës.<sup>104</sup>

<sup>104</sup> Rekomandim të ngjashëm në drejtim të miratimit të qëndrimit/opinionit të Gjykatës Supreme në lidhje me detyrimin e gjykatave më të larta gjatë mbajtjes së mbledhjes në të cilën vendoset për ankesën ose mjetin e jashtëzakonshëm juridik në rastin kur thirret prokurorit, të thirret edhe i pandehuri, me qëllim të respektimit të parimit të barazisë së armëve, që është përfshirë edhe në konkluzionet e miratuara në mbledhjen e tetë, të katërmëdhjetë dhe të pesëmbëdhjetë të Komisionit Ndërinstitucional, të mbajtura në vitin 2015 dhe 2018. Për fat të keq, këto konkluzione nuk u implementuan. Për më shumë detaje shih konkluzionet përkatëse që janë në dispozicion në <https://biroescp.gov.mk/%D1%81%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D1%86%D0%B8-%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%BF%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%BA%D0%B8/>. Nga ana tjetër, Komisioni Ndërinstitucional e vuri në dukje nevojën e dialogut midis Gjykatës Supreme dhe gjykatave të apelit në lidhje me mënyrën e veprimit të gjykatave më të ulëta konform kërkesave të KEDNJ-së në lëndët *Nasteska* dhe *Atanasov*. Shih: Konkluzionet e miratuara në mbledhjen e tretë të Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, mbajtur më datë 17.6.2013 (<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/3.pdf>).

## GRUPI I LËNDËVE ATANASOV (Nr. 2)<sup>105</sup>

### Gjetjet e GJEDNJ-së

Këto lëndë kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtës së aplikantëve për gjykim të drejtë të nenit 6 paragrafi 1 dhe/ose paragrafit 3 pika g) të KEDNJ-së, meqë atyre nuk u është lejuar të mbajnë seancë dëgjimore me dëshmitarët të cilët kanë dhënë deklarime kundër tyre në procedurën penale madje as me dëshmitarët në mbrojtje të tyre.

Konkretisht, në lëndën *Atanasov* (nr. 2), ndëshkimi penal i aplikantit për shpifje të bërë përmes një artikulli të publikuar në revistën javore, kryesisht bazohet mbi letrën që i është dërguar drejtorit të gazetës, e cila është lexuar në seancë para trupit gjykues, pasi që ai nuk pati sukses ta sigurojë prezencën e gazetarit dhe të kryeredaktorit të gazetës, si dëshmitarë të propozuar nga aplikanti. Gjykata e Apelit, nuk i është përgjigjur pretendimeve ankimore të aplikantit se atij i është pamundësuar e drejta e pyetjeve të kryqëzuara ndaj drejtorit të gazetës, si dëshmitar i vetëm kundër tij. Në mungesë të ndonjë sqarimi nga gjykatat vendase, GJEDNJ-ja nuk është e mendimit se kanë ekzistuar rrethana të veçanta të cilat e kanë justifikuar lëshimin e gjykatave vendase që ta sigurojnë prezencën e tij në seancë (paragrafi 36). Si rezultat i kësaj, aplikanti është dënuar në bazë të provave, ndërkaq sa u përket të njëjtave të drejtat e tij të mbrojtjes në masë të konsiderueshme kanë qenë të kufizuara (paragrafi 37).

Në lëndën *Trampevski*, dëshmitë e emigrantëve të dhëna para gjyqtarit hetues është evidente se kanë pasur rëndësi të caktuar dhe pa të njëjtat në masë të konsiderueshme do të zvogëloheshin mundësitë për dënimin e aplikantit për kontrabandë me emigrantë, ndërsa gjykatat vendase në masë të madhe janë mbështetur mbi këto prova me qëllim që ta konstatojnë fajin e tij (paragrafi 47). Ajo që aplikanti ka qenë në pozitë t'i përgënjeshtrojë ose t'i hedhë poshtë dëshmitë e emigrantëve, me atë që edhe vet do të jepte dëshmi ose do t'u shtronte pyetje dëshmitarëve të tjerë, nuk mund të konsiderohet si faktor i mjaftueshëm kundër balancues me të cilin do të kompensohet handikapi i mbrojtjes së tij. Në mënyrë konsekuente me këtë, aplikanti nuk ka pasur mundësi ta testojë vërtetësinë dhe sigurinë e provave të prodhuara nga emigrantët përmes pyetjeve të kryqëzuara, edhe krahas faktit se ato kanë qenë prova e vetme e drejtpërdrejtë kundër tij (paragrafi 49).

Në lëndën *Iljazi*, gjykatat vendase e kanë dënuar aplikantin për kontrabandë me drogë, pasi që e kanë refuzuar kërkesën për mbajtjen e seancës dëgjimore me dëshmitarët, të cilët kanë qenë relevantë për materien e lëndës së akuzës, dhe të cilët në mënyrë të qëndrueshme kanë pasur mundësi ta përforcojnë pozitën e mbrojtjes (paragrafi 44). Refuzimi i këtillë që të mbahet seancë dëgjimore me dëshmitarët e mbrojtjes, në mungesë

<sup>105</sup> Ky grup përbëhet nga dhjetë lëndë: *Atanasov* (nr. 2), nr. 41188/06, aktgjykim nga 19 prilli i vitit 2011; *Trampevski*, nr. 4570/07, aktgjykim nga 10 korriku i vitit 2012; *Ilazi*, nr. 56539/08, aktgjykim nga 3 tetori i vitit 2013; *Papadakis*, nr. 50254/07, aktgjykim nga 26 shkurti i vitit 2013; *Dushko Ivanovski*, nr. 10718/05, aktgjykim nga 24 prilli i vitit 2014; *Sminçkovski*, nr. 15477/14, aktgjykim nga 5 korriku i vitit 2018; *Asani*, nr. 27962/10, aktgjykim nga 1 shkurti i vitit 2018; *Ziberi*, nr. 2166/15, aktgjykim nga 6 qershori i vitit 2019; *Boshkoski*, nr. 71034/13, aktgjykim nga 4 qershori i vitit 2020; *Janevski*, nr. 30259/15, aktgjykim nga 19 nëntori i vitit 2020.

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

të provave tjera të drejtpërdrejta, të cilat kanë qenë të rëndësishme për përcaktimin e fakteve, ka çuar në kufizimin e të drejtave të tij për mbrojtje, në mënyrë e cila ka qenë inkompatibile me garancitë për gjykim të drejtë të përcaktuara në nenin 6 (paragrafi 47).

Në lëndën *Papadakis*, prova kundër aplikantit përbëhet nga dëshmia e dëshmitarit, i cili është përfshirë si agjent i kamufluar në operacionin e kontrabandës me drogë, edhe pse nuk ka qenë i vetmi, megjithatë, ajo ka qenë provë vendimtare për dënimin e aplikantit (paragrafi 88). Aplikantit dhe përfaqësuesve të tij ligjorë nuk u është lejuar në asnjë moment gjatë procedurës ta konfrontojnë dëshmitarin dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i parashtrojnë pyetje (paragrafi 92). Aq më tepër, afati i përcaktuar prej një ore nga ana e trupit gjykues për t'i parashtruar pyetje dëshmitarit, nga GJEDNJ-ja konsiderohet si joadekuat. Një gjë e këtillë aplikantin e ka vënë në pozitë në të cilën ai në mënyrë efektive ka qenë i privuar nga mundësia reale që ta kontestojë sigurinë e provës vendimtare kundër tij (paragrafi 94). Së këtejmi, nuk ka pasur as faktorë adekuatë kundër-balancues, as garanci të fuqishme të procesit, të cilat do të mundësonin një vlerësim të drejtë dhe ligjor të sigurisë së provave të prezantuara nga dëshmitari i mbrojtur, ndërsa kufizimet të cilat në rrethanat në fjalë kanë ndikuar mbi realizimin e të drejtave të mbrojtjes kanë qenë në kundërshtim me garancitë për gjykim të drejtë (paragrafi 95).

Në lëndën *Dushko Ivanovski*, shkelja e të drejtës së gjykimit të ndershëm ka të bëjë me refuzimin e gjykatave vendase të mbajnë seancë dëgjimore me dëshmitarët e mbrojtjes dhe të pranojnë, si provë, ekspertizën alternative (paragrafi 61). Aplikanti është dënuar për kontrabandë me drogë në bazë të raporteve të ekspertëve të Byrosë për Hetime Kriminallistike pranë MPB-së, për të cilat është vlerësuar se kanë qenë të paanshme, ndërkaq ai nuk ka pasur mundësi t'i përgënjeshtrojë të njëjtat si prova të prezantuara nga prokurori publik, madje nuk ka pasur kurrfarë mundësie për mbrojtje aktive përmes thirrjes së dëshmitarëve në mbrojtje të tij ose për nxjerrje të provave të tjera (paragrafi 59). Me këtë është krijuar çekuilibër midis mbrojtjes dhe prokurorisë dhe është shkelur parimi i barazisë së armëve midis palëve (paragrafi 60).

Në lëndën *Smiçkovski*, gjykatat vendase e dënuan aplikantin për shkakimin e lëndimit të rëndë trupor, pasi që ata i refuzuan të gjitha kërkesat e mbrojtjes, dhe veçanërisht kërkesën që t'i parashtrohen disa pyetje dëshmitarit, në ndërkohë pa dhënë arsyetime relevante për një gjë të këtillë, ndërkaq nga ana tjetër, janë pranuar të gjitha argumentet dhe provat e prokurorisë. Me këtë, sipas GJEDNJ-së, trupi gjykues ka krijuar përparësi të padrejtë në favor të prokurorisë, ndërsa aplikantin e ka privuar nga mundësia praktike në mënyrë efektive t'i kontestojë akuzat kundër tij (paragrafi 38).

Në lëndën *Asani*, aplikantët janë dënuar për vrasje në bazë të dëshmisë inkriminuese të dhënë gjatë hetimit nga dëshmitari kryesor, të cilin ata dhe avokatët e tyre nuk kanë pasur mundësi ta konfrontojnë, përkatësisht t'i parashtrojnë pyetje. Nga ana tjetër, dy dëshmitarë të cilëve u është dhënë statusi i dëshmitarëve anonimë (të mbrojtur) për shkak të frikës për sigurinë e tyre, aplikantët i kanë identifikuar si kryerës, por ekipit të mbrojtjes i është lejuar që atyre t'u parashtrojnë vetëm pyetje me shkrim gjatë procesit të gjykimit.

Në lëndën *Ziberi*, edhe pse aplikanti është dënuar për vrasje në bazë të dëshmisë së dëshmitarit që e ka dhënë para gjyqtarit hetues, të cilit aplikanti nuk ka pasur mundësi t'i parashtrijë pyetje të kryqëzuara, nuk ka pasur indikatorë se gjykatat vendase i kanë shqyrtuar provat e atilla të pa testuara (të pakontrolluara) me ndonjë kujdes të veçantë (paragrafi 39).

Në lëndën *Boshkoski*, aktgjykimi dënues/i fajësisë për ish-Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe autorizimit, si dhe për keqpërdorimin e mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore në cilësinë e liderit të partisë politike, është bazuar mbi dëshminë e dëshmitarit të rrezikuar, të cilit ky status i është dhënë për shkak të pretendimit të ekzistimit të vazhdueshëm të rrezikut mbi jetën, shëndetin dhe integritetin e tij fizik. Së këtejmi, nuk është shqyrtuar nëse i pandehuri ose ata që kanë vepruar në emër të tij, janë kërcënuar ose kanë ndërmarrë veprime të tjera ndaj dëshmitarit, madje nuk është nxjerrë as provë me të cilën do të mbështetej ekzistimi i çfarëdo lloji kërcënimeve të adresuara tek dëshmitari ose familja e tij (paragrafi 42 – 43). Aq më tepër, ka munguar motivi i mirë për fshehjen/kamuflimin e identitetit të dëshmitarit të rrezikuar nga mbrojtja, meqë ai dhe aplikanti janë njohur midis tyre, madje edhe janë konsideruar si miq.

Edhe pse dëshmia e dëshmitarit nuk ka qenë prova “e vetme” ose “vendimtare”, asaj i është kushtuar rëndësi e veçantë për epilogun e procedurës, përkatësisht seanca dëgjimore e tij në hapësirë të veçantë, përmes video-lidhjes duke përdorur aparate të veçanta teknike të cilat e ndryshojnë pamjen dhe zërin e tij, nga njëra anë, e ka pamundësuar mbrojtjen në mënyrë efikase ta vëzhgojë sjelljen e dëshmitarit gjatë seancës dëgjimore, me ç'rast në situatë kur gjykatat vendase nuk i janë qasur me kujdes të veçantë dëshmisë së dëshmitarit të rrezikuar, kjo ka rezultuar me shkelje të nenit 6 paragrafi 1 pika g) (paragrafët 44 – 48 të aktgjykimit).

Në mënyrë plotësuese, ajo që është specifike për këtë aktgjykim është shkelja e konstatuar e të drejtave të mbrojtjes së aplikantit për shkak të përjashtimit të publikut nga tri seanca, pa pasur për një gjë të këtillë shkaqe/motive të arsyeshme për kamuflimin e identitetit të dëshmitarit, të cilin e ka njohur mirë aplikanti, si dhe në audio dhe video regjistrimet nga takimet e tij me aplikantin, të cilat janë prezantuar si provë gjatë procesit gjyqësor dhe gjatë dëshmisë së tij, fytyra dhe zëri i janë ndryshuar, kështu që krahas këtyre masave nuk ka pasur nevojë që seancat të jenë të mbyllura për publikun (paragrafët 49 – 53).

Në lëndën *Janevski*, që është aktgjykimi i fundit i këtij grupi, thelbi i shkeljes ka të bëjë me faktin se aplikanti është dënuar për mashtrim në bazë të dëshmimeve të dhëna nga katër dëshmitarë para gjyqtarit hetues, pa prezencën e aplikantit dhe as të prokurorit publik, ndërsa këto dëshmi më vonë vetëm janë lexuar gjatë gjyqimit, pa u mbajtur seancë dëgjimore me dëshmitarët, ndërsa gjatë gjyqimit nuk ka marrë pjesë aplikanti me arsyetimin se ai nuk ka qenë i disponueshëm për organet e ndjekjes, edhe pse ka qenë në vuajtje të dënimit me burgim në institucion ndëshkues-korrektues. Elementi kryesor për konstatimin e shkeljes konsiston me atë që, edhe pse dëshmitë e katër dëshmitarëve, të prezantuara si prova, kanë pasur rëndësi të konsiderueshme në përcaktimin e fajit të

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

tij, ndërsa pranimi i tyre si prova ka pasur mundësi ta ngarkojë mbrojtjen e aplikantit (paragrafi 33), ai nuk ka pasur mundësi që t'i testojë ose vlerësojë të njëjtat. Një mundësi të këtillë nuk kanë pasur as shumica e anëtarëve të përbërjes së fundit të Kolegjit gjyqësor në situatë kur vetëm kryetari i Kolegjit gjyqësor, i cili e ka miratuar aktgjykimin, ka qenë edhe anëtar i Kolegjit, i cili në të vërtetë, i ka dëgjuar dëshmitë e dëshmitarëve, dhe së këtejmi, vetëm ai ka mundur mirëfilli t'i vlerësojë këto prova, si dhe sjelljen e dëshmitarëve (paragrafi 35).

### Ekzekutimi i aktgjykimeve

Në dy planet e veprimit në lidhje me këto lëndë të prezantuara nga ana e shtetit<sup>106</sup>, në mënyrë të qartë theksohet se shkeljet në këto lëndë janë rezultat i legjislacionit i cili nuk ka korresponduar me Konventën, meqë i njëjti nuk ka pasur dispozita të ngjashme me spektrin e parimeve të “rregullit për provë të vetme dhe vendimtare” dhe prandaj, kjo mangësi u ka mundësuar gjykatave vendase të aplikojnë kritere më pak të rrepta për lejueshmërinë e provave.<sup>107</sup>

Nga informacionet e paraqitura deri te Komiteti i Ministrave, rezulton se deri më tani janë ndërmarrë vetëm hapa të pjesshëm në drejtim të ndryshimit të legjislacionit relevant në linjë me gjetjet e GJEDNJ-së në këto lëndë të cilat korrespondojnë me inkorporimin e vetëm aspektit të parë të “rregullit për provë të vetme dhe vendimtare” në kontekst të LPP-së nga viti 2010. Me fjalë të tjera, atëherë në këtë ligj u inkorporuan dispozita përkatëse në nenin 231 paragrafi 2, si dhe në nenin 400 paragrafi 1, me të cilat në mënyrë eksplicite parashikohet se “aktgjykimi nuk mund të bazohet vetëm në bazë të dëshmisë së dëshmitarit të rrezikuar të siguruar përmes zbatimit të dispozitave për kamuflimin e identitetit ose pamjes së tij për shkak të mbrojtjes së tij dhe mbrojtjes së personave të afërt të tij”.<sup>108</sup>

Megjithatë, në të dy planet e veprimit theksohet se planifikohet të ndërmerret edhe një hap në drejtim të ndryshimeve të mëtutjeshme të legjislacionit, përmes të cilave do të përfshihet edhe pjesa e dytë e rregullit që ka të bëjë me “provën vendimtare”, kështu që do të përcaktohet se dënimi nuk mund të bazohet në masë vendimtare ose vetëm mbi dëshminë e dhënë nga ana e dëshmitarit të rrezikuar.<sup>109</sup>

Siç u theksua paraprakisht gjatë analizës së ekzekutimit të aktgjykimit në lëndën *Nasteska*, grupi i punës pranë Ministrisë së Drejtësisë tanimë një periudhë të gjatë kohore punon në

<sup>106</sup> 1250 meeting (8-10 March 2016) (DH), Updated action plan (19/02/2016), Communication from "The former Yugoslav Republic of Macedonia" concerning the case of *Atanasov No. 2* against "The former Yugoslav Republic of Macedonia" (Application No. 41188/06), DH-DD(2016)207 dhe 1383rd meeting (29 September - 1 October 2020) (DH), Action Plan (04/06/2020), Communication from North Macedonia concerning the group of cases *ATANASOV (No. 2) v. North Macedonia* (Application No. 41188/06), DH-DD(2020)498

<sup>107</sup> Shih Planin e veprimit nga viti 2016 dhe paragrafin 32 të Planit të veprimit nga viti 2020.

<sup>108</sup> Shih Planin e veprimit nga viti 2016 dhe paragrafin 33 të Planit të veprimit nga viti 2020.

<sup>109</sup> Sipas Planit të veprimit nga viti 2016 dhe paragrafit 35 të Planit të veprimit nga viti 2020



ndryshimin e Ligjit për Procedurën Penale, kështu që me të drejtë pritet që ndryshimet e këtilla të parashikohen dhe të miratohen nga Kuvendi deri në fund të vitit 2021.<sup>110</sup>

## Përmbledhje

Duke e pasur parasysh ngecjen shumëvjeçare në ekzekutimin e këtyre aktgjykimeve nga njëra anë, si dhe gjetjet e GJEDNJ-së të cilat e vënë në dukje shkeljen flagrante të standardeve të Konventës nga ana tjetër, edhe për sa i përket këtij grupi të lëndëve do të vlenin udhëzimet e njëjta si edhe për lëndët e grupit të *Nasteska*. Me fjalë të tjera, rekomandohet përsheptimi i aktiviteteve të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe të Kuvendit në drejtim të miratimit sa më të shpejtë të LPP-së së re.

Njëkohësisht, krahas masave të përgjithshme kryesore për implementimin e këtyre aktgjykimeve të cilat kryesisht janë të karakterit legjislativ, mund të mendohet edhe për ndryshimin eventuale praktikës gjyqësore dhe komunikimin e saj me Komitetin e Ministrave përmes theksimit të shembujve përkatës të mirë, me ç'rast në raste të ngjashme është vepruar në mënyrë e cila është në përputhje me standardet e jurisprudencës së GJEDNJ-së.

Në mënyrë plotësuese, në lidhje me ndryshimet e praktikës gjyqësore, shteti mund të mendojë edhe në drejtim të mbështetjes së instrumenteve të cilat mund të kenë funksion parandalues, siç është për shembull, shqyrtimi i mundësisë për miratimin e qëndrimit/qëndrimeve përkatëse të Gjykatës Supreme, përmes të cilave do të prononcohet në lidhje me çështjen e seancës dëgjimore të dëshmitarëve dhe përjashtimin e publikut në rast të seancës dëgjimore të dëshmitarit të rrezikuar, me ç'rast do të prezantohen pikëpamjet relevante të GJEDNJ-së. Për më tepër, Komisioni Ndërinstitucional në këtë drejtim tanimë i ka dërguar rekomandim Gjykatës Supreme.<sup>111</sup>

Përndryshe, shkelja e konstatuar e parimit të transparencës në procedurat penale në lëndën Boshkoski mund të perceptohet edhe si rast i izoluar, meqë, me sa duket, bëhet fjalë për lëndën e vetme para GJEDNJ-së kundër Maqedonisë së Veriut, në të cilën është problematizuar kjo çështje. Duke pasur parasysh faktin se nga aktgjykimi i GJEDNJ-së nuk rezulton se shkelja e këtillë e Konventës ka ndodhur për shkak të normave joadekuate ligjore të kësaj materie, por nga veprimi i Gjykatës në lëndën konkrete, nuk do të duhej të pritët që e njëjta të aktualizohet në ndonjë aplikacion të radhës në Strasburg. Sipas kësaj, shteti konform vlerësimeve të tij në përputhje me parimin e subsidiaritetit, mund të konkludojë se nuk ka nevojë të ndërmerren masa plotësuese të përgjithshme për ekzekutimin e këtij aktgjykimi, përveç aktiviteteve të nevojshme edukative për standardet e GJEDNJ-së, që duhet të pranohet nga Komiteti i Ministrave dhe në këtë mënyrë të mbyllet mbikëqyrja e saj.

<sup>110</sup> Më shumë për shkaqet e zvarritjes së procesit të miratimit të LPP-së së re, shih paragrafët 35 – 38 të Planit të veprimit nga viti 2020.

<sup>111</sup> Shih: Procesverbal i mbledhjes së 20-të të Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, mbajtur më datë 20.5.2021 (<https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/07/20-ta-mk.pdf>)

Përfundimisht, duhet të shënohet edhe fakti se, kohëve të fundit, shtetit i janë dërguar për prononcim një numër i papërfillshëm i aplikacioneve në të cilat është prekur e drejta e mbrojtjes për shkak të miratimit të aktgjykimit dënues/të fajësisë në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve, të cilat i pandehuri nuk ka pasur mundësi t'i dëgjojë gjatë procesit gjyqësor.<sup>112</sup>

### II.4. Lëndët në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 8 të Konventës (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare)

#### GRUPI I LËNDËVE MITOVI<sup>113</sup>

##### Gjetjet e GJEDNJ-së

Të dy lëndët e grupit të udhëhequr nga *Mitovi* kanë të bëjnë me detyrimin pozitiv të shtetit ta sigurojë gëzimin pa pengesa të të drejtës së prindërve, gjysheve dhe gjyshërve për respektimin e jetës së tyre familjare në përputhje me nenin 8 të KEDNJ-së, përmes realizimit të relacioneve të drejtpërdrejta me fëmijët e tyre, përkatësisht me nipërit e tyre. Ato kanë të bëjnë me gjendje të shkaktuara nga divorci, përkatësisht bashkësia jashtëmartesore.

Në këto lëndë janë konstatuar shkelje të Konventës si rezultat i lëshimeve të autoriteteve që të ndërmerren angazhime adekuate dhe efektive që ta zbatojnë të drejtën e aplikantëve nga neni 8 (paragrafi 65 i aktgjykimit *Mitovi* dhe paragrafi 43 i aktgjykimit *Olluri*), përkatësisht që t'i realizojnë aktvendimet konkrete të Qendrës për Punë Sociale për kontakt me fëmijët e tyre, përkatësisht me nipërit e tyre (në tekstin në vijim: “QPS”, “Qendra”).

Njëkohësisht këto lëndë kanë të bëjnë edhe me mungesën e mjetit efektiv juridik për aplikantët, përmes të cilit do të mundësohet ekzekutimi i aktvendimeve të lartpërmendura administrative (shkelje të nenit 13 në kombinim me nenin 8).

Më për së afërmi, në lëndën *Mitovi* bëhet fjalë për pamundësimin e kontaktit të babait, i cili ka jetuar në Australi, gjyshes dhe gjyshit, me bijën e tyre, përkatësisht me mbesën e tyre, meqë është evident prolongimi sa i përket veprimit dhe vendimmarrjes ndaj kërkesave të tyre që të realizojnë takim me fëmijën nga ana e QPS-së me kompetencë territoriale, të cilës, për shembull, i janë nevojitur prej dy deri në pesë muaj që të vendosë lidhur me kërkesat e babait. Mes tjerash, nuk janë ndërmarrë masa që të krijohen kushtet e nevojshme

<sup>112</sup> Për shembull, njëra nga lëndët e paraqitura përfundoi si e palejueshme sipas vendimit të Komitetit të përbërë nga tre gjyqtarë me të cilin vendim konstatohet se pretendimet ankimore të specifikuar në lidhje me nenin 6 paragrafin 1 dhe nenin 6 paragrafin 3 pika g të KEDNJ-së janë të pabaza. Për më shumë detaje, shih *Nikollov dhe Xhixhev kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 13545/16 dhe 13572/16, vendimi nga 3 marsi i vitit 2020.

<sup>113</sup> Në këtë grup, krahas lëndës kryesore *Mitovi*, nr. 53565/13, aktgjykim nga 16 prilli i vitit 2015, bën pjesë edhe lënda *Olluri*, nr. 3368/18, aktgjykim nga 16 janari i vitit 2020. Për dallim nga aktgjykimi *Mitovi* të cilin e miratoi Dhoma me shtatë gjyqtarë, lëndën *Olluri* e ka shqyrtuar Komiteti me tre gjyqtarë, meqë në këtë lëndë janë trajtuar çështje për të cilat tanimë nuk ekziston praktikë gjyqësore e cila është vendosur në lëndën *Mitovi*.



për ekzekutimin e këtyre aktvendimeve, të cilat për këtë shkak kanë mbetur të parealizuara në periudhën kohore nga viti 2012 deri në vitin 2014, pavarësisht asaj se QPS-ja ishte: i) e vetëdijshme për sjelljen jo bashkëpunuese të nënës, të cilës pas divorcit ia kanë ndarë fëmijën në ruajtje dhe edukim dhe ii) kompetente të veprorë sipas iniciativës së vet. Gjykata konkludoi se autoritetet kanë bërë shkarje që të bëjnë çdo gjë që ka qenë në kompetencë të tyre, dhe që në mënyrë racionale mund të pritet nga ato për të siguruar interesin legjitim të aplikantëve në zhvillimin dhe ruajtjen e lidhjes me fëmijën (paragrafi 64 i aktgjykimit).<sup>114</sup>

Në lëndën *Olluri* bëhet fjalë për mosekzekutimin në afat të gjatë kohor prej më shumë se tre vjet e tre muaj (midis vitit 2015 dhe vitit 2018) të aktvendimit përfundimtar dhe të formës së prerë nga QPS-ja me të cilin fëmija, vajzë jashtëmartesore, i është ndarë për ta ruajtur dhe edukuar nëna e saj, e cila paraqitet si aplikante para Gjykatës, përkundër tentativave të saj të pasuksesshme për ekzekutimin administrativ të atij aktvendimi dhe dënimit penal të babait për “marrjen e fëmijës”, si dhe dënimit të shqiptuar me burgim prej gjashtë muajsh, i cili ka mbetur i pa ekzekutuar. Përveç paraqitjes së kallëzimit penal kundër babait dhe sigurimit të asistencës policore gjatë tentativës për ekzekutimin e aktvendimit për ruajtjen dhe edukimin që u dëshmuar si e padobishme, QPS-ja ishte pasive në një periudhë të konsiderueshme kohore dhe nuk ndërmori aktivitete të rëndësishme, duke përfshirë këtu edhe masa detyrimi, për zbatimin e aktvendimit. Në të vërtetë, kjo situatë në fund rezultoi me modifikimin e aktvendimit për ruajtje dhe edukim në favor të babait (paragrafi 23). Në këtë aktgjykim vihen në dukje edhe vështirësitë gjatë bashkëpunimit midis qendrave të ndryshme për punë sociale, si dhe atë se një QPS duhet të bashkëpunojë me qendra të tjera komunale për punë sociale me qëllim të ekzekutimit të aktvendimit nuk ka pasur mundësi t'i justifikojë prolongimet e ekzekutimit (paragrafi 38).

Shkelja e nenit 13 në kombinim me nenin 8 në lëndën *Mitovi*, është konstatuar pasi që Gjykata gjeti se ka ekzistuar paqartësi dhe deri në fund çështja ka mbetur e hapur, cili organ/autoritet ka qenë kompetent për ekzekutimin e aktvendimeve për takim, meqë kërkesat e babait (aplikanti i parë) adresuar QPS-së dhe Ministrisë së Drejtësisë për ekzekutimin administrativ të aktvendimeve për kontakt (takim) nuk kanë dhënë rezultat, meqë edhe QPS-ja edhe Ministria janë shpallur për jokompetente për veprim (paragrafi 74). Një paqartësi e ngjashme në lidhje me kompetencën e ekzekutimit të aktvendimeve për ndarjen e fëmijës ka ekzistuar edhe në lëndën *Olluri*. Duke pasur parasysh faktin se aktgjykimet e miratuara dënuesë/të fajësisë dhe dënimet e shqiptuara në procedurat penale kundër babait asnjëherë nuk janë zbatuar për shkaqë të ndryshme, Gjykata konkludoi se në rrethanat e rastit konkret, aplikantja nuk ka pasur në dispozicion mjet efektiv juridik për pretendimin e saj ankimor sipas nenit 8 (paragrafët 51 – 52).

Në të dy aktgjykimet, Gjykata ka nënvizuar se mekanizmi juridik-penal i cili është ngritur kundër nënës së fëmijës në aspektin e refuzimit të saj që t'i respektojë aktvendimet për takim (*Mitovi*), përkatësisht kundër babait, tek i cili ka qenë fëmija (*Olluri*), nuk mund të

<sup>114</sup> Në të vërtetë, si pasojë e pasivitetit të organeve kompetente, babai nuk ka pasur mundësi ta takojë bijën e tij gjatë kohës së qëndrimit të tij të kufizuar në vend, midis muajit nëntor të vitit 2011 dhe tetor të vitit 2012, si dhe midis muajit prill dhe shtator të vitit 2013, ndërsa gjyshja dhe gjyshi e kanë parë madje më 13 shkurt të vitit 2014 – një vit e katër muaj pasi kanë kërkuar nga QPS-ja që t'i përcaktojë të drejtat e tyre në lidhje me takimet (paragrafi 63).

konsiderohet si mjet adekuat dhe efektiv për ekzekutimin e aktvendimit në fjalë, për t'u takuar në rastin e parë, përkatësisht për kujdestari në rastin e dytë.

### Ekzekutimi i aktgjykimeve

Këto aktgjykime zbulojnë mangësi serioze dhe sistematike në funksionimin e qendrave për punë sociale, të cilat veçanërisht manifestohen, gjatë vendimmarrjes, por edhe gjatë (mos) ekzekutimit të vendimeve të tyre. Dështimi i institucioneve kompetente në këto lëndë, tregon se ka nevojë për ndërhyrje përkatëse, si në drejtim të rregullimit më të saktë të legjislacionit, siç është për shembull, çështja e kompetencës së ekzekutimit të aktvendimeve të miratuara në procedurë administrative, ashtu edhe për sa i përket fuqizimit të institucioneve me qëllim të luftimit të tyre më efikas me rastet e këtilla dhe zbatimin në kohë të duhur të aktvendimeve në fjalë.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së planeve të veprimit të dorëzuara në KM<sup>115</sup>, rezultoi se përveç angazhimeve të ndërmarra për sigurimin e takimeve të vazhdueshme midis aplikantëve dhe fëmijëve të tyre, përkatësisht nipërve të tyre, si mjet i veçantë për shmangien e shkeljeve në këto lëndë konkrete, nuk kanë munguar as aktivitetet për krijimin dhe zbatimin e masave të përgjithshme për implementimin e aktgjykimeve në fjalë. Së këtejmi, shteti i ka pasur parasysh ndryshimet ligjore të cilat do të ishin po aq të rëndësishme, si për parandalimin e shkeljeve të ardhshme të nenit 8, ashtu edhe për tejkalimin e problemit të mungesës së mjetit efektiv juridik sipas nenit 13.<sup>116</sup>

Në këtë kuptim, janë më se të nevojshme ndryshimet e legjislacionit relevant vendor, përmes ndryshimeve të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) dhe Ligjit për Familjen, në mënyrë që të sigurohet ekzekutim efikas i aktvendimeve të QPS-ve për të drejtat e kontaktit të prindërve me fëmijët. Këto ndryshime janë në korrelacion me konstatimin e Gjykatës se sistemi i ekzekutimit administrativ të vendimeve të organeve/autoriteteve të administratës i parashikuar në LPPA as që është iniciuar, dhe as që ka pasur dispozita të veçanta ligjore apo praktikë vendore në lidhje me atë se cili organ është kompetent për ekzekutimin e aktvendimeve të Qendrës, ndërsa mekanizmi i ekzekutimit i parashikuar me Ligjin për Ekzekutim, kryesisht ka të bëjë me ekzekutimin e aktgjykimeve gjyqësore ose me vendimet e organeve administrative që kanë të bëjnë me detyrimin material, e që nuk është rasti me vendimet e Qendrës për takime të cilat kanë të bëjnë me kërkesa jomonetare.<sup>117</sup>

<sup>115</sup> Shteti deri më tani ka paraqitur dy Plane të veprimit, në vitin 2017 dhe 2021. Njëri prej tyre ka të bëjë vetëm me lëndën *Mitovi* (1288th meeting (June 2017) (DH), Action plan (29/05/2017), Communication from “the former Yugoslav Republic of Macedonia” concerning the case of MITOVI v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Application No. 53565/13), DH-DD(2017)592), ndërsa Plan i dytë i veprimit ka të bëjë me të dyja lëndët (1398th meeting (March 2021) (DH), Action Plan (29/01/2021), Communication from North Macedonia concerning the case of MITOVI v. North Macedonia (Application No. 53565/13), DH-DD(2021)116).

<sup>116</sup> Paragrafi 45 i Planit të veprimit nga viti 2021

<sup>117</sup> Paragrafi 72 në *Mitovi* dhe paragrafi 35 i Planit të veprimit nga viti 2021

Me Ligjin e ri për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), i cili hyri në fuqi më 13 korrik të vitit 2016,<sup>118</sup> duhet plotësisht të pastrohet dilema rreth asaj se e kujt është kompetenca për ekzekutimin administrativ të aktvendimeve të qendrave për punë sociale për kontakt dhe takime. Së këtejmi, me nenin 130 në paragrafin 1 të LPPA-së së re, në mënyrë të qartë është përcaktuar se kompetencën për zbatimin e ekzekutimit të detyrimeve jomonetare e zbaton organi publik i cili e ka miratuar aktin administrativ në shkallë të parë, madje edhe kur akti është ndryshuar nga organi publik i shkallës së dytë ose nga Gjykata Administrative. Paragrafi 2, e përcakton detyrimin e organit të administratës shtetërore kompetent për punë të brendshme, t'i ofrojë ndihmë organit publik kompetent për zbatimin e ekzekutimit, me kërkesë të tij.<sup>119</sup>

Njëherësh, me LPPA-në e re parashikohen edhe dënime monetare në lartësi prej gjysmës së bruto-pagës mujore deri në dy bruto paga mesatare mujore vjetore të realizuara në shtet gjatë vitit paraprak, në rast të mosekzekutimit të detyrimit jomonetar, i cili buron nga akti administrativ, siç është edhe aktvendimi për takime i QPS-së.<sup>120</sup>

Megjithatë, është e paqartë nëse ndryshimet e këtilla do t'i arrijnë efektet e dëshiruara në kuptim të zbatimit më efikas të aktvendimeve për takime. Së këtejmi, do të ishte mirë që Ministria për Punë dhe Politikë Sociale (MPPS) dhe qendrat kompetente për punë sociale të prezantojnë të dhëna konkrete statistikore për zbatimin praktik të këtyre dispozitave.

Nga ana tjetër, edhe pse shteti paralajmëroi se pas miratimit të aktgjykimit *Mitovi* janë ndërmarrë veprime drejt miratimit të ndryshimeve të **Ligjit për Familjen** në lidhje me ekzekutimin e aktvendimeve të Qendrës, megjithatë, këto ndryshime deri më sot nuk janë miratuar. Megjithatë, një hap pozitiv është ndërmarrë me atë që me kërkesë të Ministres së atëhershme të Drejtësisë dhe Ministres së atëhershme për Punë dhe Politikë Sociale, në gjysmën e dytë të vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020, u realizua bashkëpunim i suksesshëm me Këshillin e Evropës në formë të ndihmës së ekspertëve dhe mbështetjes gjatë përpilimit të analizës së detajuar, qëllimi i së cilës është vlerësimi i gjendjeve dhe formulimi i rekomandimeve përkatëse për avancimin e legjislacionit dhe praktikës kombëtare në drejtim të ekzekutimit më të suksesshëm të aktgjykimeve në fjalë.<sup>121</sup>

## Përmbledhje

Meqë procesi i përgjithshëm i ekzekutimit të lëndëve nga ky grup, i cili tani për tani është pezulluar, në masë të madhe do të varet nga ndryshimet e nevojshme në legjislacionin e

<sup>118</sup> Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2015 nga data 23.7.2015)

<sup>119</sup> Paragrafi 36 i Planit të veprimit nga viti 2021

<sup>120</sup> Paragrafi 37 i Planit të veprimit nga viti 2021. Për më shumë detaje, shih nenin 133 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit të ri për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

<sup>121</sup> Paragrafi 39 i Planit të veprimit nga viti 2021

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJË TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

familjes, aktivitetet e ardhshme duhet plotësisht të fokusohen mbi miratimin e tyre, ndërsa për këtë nevojitet përfshirje më e madhe e MPPS-së kompetente.<sup>122</sup>

Ajo që është akoma më e rëndësishme konsiston me nevojën e angazhimit më të madh drejt fuqizimit të kapaciteteve institucionale të qendrave për punë sociale dhe të gjyqësorit që, mes tjerash, nënkupton edhe realizimin e aktiviteteve edukative, me qëllim të kuptimit të drejtë të standardeve të Konventës në lidhje me këtë problematikë.<sup>123</sup> Së këtejmi, theks i veçantë duhet të vendoset mbi konceptin e interesit më të mirë të fëmijës, si parametër kryesor nga i cili do të udhëhiqen organet/autoritetet kompetente administrative dhe gjyqësore gjatë veprimit të tyre në lëndë të ngjashme.

Ndërhyrjet në praktikë bëhen akoma më relevante, nëse e marrim parasysh faktin se vetëm ndryshimi i modelit thellë të rrënjësor të veprimit mund t'i vë fund ciklit përsëritës të shkeljeve të Konventës të natyrës së njëjtë. Në të vërtetë, konfirmim për rrezikun nga miratimi i aktgjykimeve të reja në të cilat mund të konstatohen shkelje identike të së drejtës së jetës familjare, nëse nuk ndërpritet praktika e deritanishme, është edhe një lëndë që është dërguar për prononcim deri te Qeveria, në të cilën janë ngritur çështje të ngjashme si ato në lëndët *Mitovi* dhe *Olluri*.<sup>124</sup>

Marrë në përgjithësi, shteti në afat sa më të shkurtër duhet t'i qaset zbatimit të rekomandimeve kryesore të Këshillit të Evropës, duke përfshirë këtu edhe ato me të cilat ofrohen udhëzime për ndryshime të mundshme ligjore. Me fjalë të tjera, ai duhet veprimin e tij të ardhshëm sa i përket implementimit të këtij grupi të aktgjykimeve ta harmonizojë me gjetjet e misionit të ekspertëve të Këshillit të Evropës dhe në mënyrë kthyesë ta njoftojë Komitetin e Ministrave se cilat rekomandime të tyre realisht dhe praktikisht janë të realizueshme, në cilën masë dhe në cilën kornizë kohore mund të pritët zbatimi i tyre. Në të vërtetë, nga dinamika e ndryshimeve të bëra që do të pasonin nga masat e ndërmarrura në këtë kuptim, do të varet edhe mbyllja përfundimtare e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e tyre. Përfundimisht, duhet të merret parasysh se ekzekutimi shënon vonesa të mëdha, veçanërisht meqë nga miratimi i

<sup>122</sup> Që në vitin 2015, Komisioni Ndërinstitucional e detektoi nevojën që MPPS-ja ta shqyrtojë mundësinë për ndryshimin e legjislacionit në drejtim të vendosjes së mekanizmit efikas juridik për ekzekutimin e drejtpërdrejtë të detyrueshëm të aktvendimeve të QPS-së, si dhe për përmirësimin e efikasitetit të mjetit juridik kundër aktvendimeve në fjalë, ndërsa kjo çështje sërish u aktualizua në vitin 2017. Shih: Konkluzionet e miratuara në mbledhjen e nëntë të Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, mbajtur më datë 29.6.2015 (<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/9.pdf>) dhe Procesverbali nga mbledhja e 13-të të Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, mbajtur më datë 25.10.2017 (<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/Зapisник-од-13та-седница-на-МК.pdf>).

<sup>123</sup> Për shembull, shteti duhet të bëjë përpjekje plotësuese për sigurimin e bashkëpunimit dhe mbështetjen nga Këshilli i Evropës, jo vetëm sa i përket hartimit të Ligjit të ri për Familjen, por edhe për zbatimin e aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe ngritjen e vetëdijes, për çka tanimë është dërguar një letër interesi më datë 20 shkurt të vitit 2020 (paragrafi 40 i Planit të veprimit nga viti 2021).

<sup>124</sup> Aplikacioni në lëndën *Nenad Filij kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 45174/20, i paraqitur më 6 tetor të vitit 2020, Qeverisë i është dërguar më datë 22 prill të vitit 2021, ka të bëjë me procedurën administrative në të cilën aplikanti, shtetas kroat me vendbanim në Kroaci, ka kërkuar nga autoritetet maqedonase t'ia rregullojnë të drejtat e tij që të takohet/shihet me vajzën e tij të mitur, e cila jeton me nënën e saj, e cila i ka pamundësuar kontaktet e tij me të bijën. Procedura ka filluar në vitin 2017, me çka janë paraqitur probleme serioze me ekzekutimin e aktvendimeve për takime të miratuara nga QPS-ja. Aplikanti ka pretendime ankimore konform neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës, përmes të cilëve e problematizon dështimin e organeve kompetente që t'i mundësojnë kontakte të rregullta me të bijën.

aktgjykimit të parë në këtë grup në rastin *Mitovi* ka kaluar një periudhë kohore më e gjatë se 5 (pesë) vjet.<sup>125</sup>

## LËNDA X.<sup>126</sup>

### Gjetjet e GJEDNJ-së

Lënda ka të bëjë me shkeljen e të drejtës së aplikantit, person transgjinnor, për respektimin e jetës së tij private sipas nenit 8, për shkak të mungesës së procedurave të shpejta, transparente dhe të qasshme në legjislacionin kombëtar, të cilat do ta lejonin ndryshimin e seksit të shënuar të njerëzve transgjinnorë në certifikatën e librit amë të të lindurve (paragrafi 70 i aktgjykimit).

GJEDNJ-ja theksoi se korniza rregullatore kombëtare për njohjen juridike të gjinisë, ka lënë shumë çështje të rëndësishme të pazgjidhura, siç është për shembull, ekzistimi dhe natyra e çfarëdo lloj kërkesë të cilën aplikanti duhet ta plotësojë me qëllim që shënjimi i tij i seksit/gjinisë të ndryshohet në evidencën zyrtare (paragrafi 69). Si rezultat i kësaj, aplikanti është lënë në situatë të pasigurisë shqetësuese për sa i përket jetës së tij private dhe njohjes së identitetit të tij (paragrafi 70) qysh në vitin 2011, kur ka paraqitur kërkesë në Drejtorinë për Udhëheqjen e Librave Amë (DALA) për ndryshimin e shënjimit të tij të seksit/gjinisë në certifikatën e librit amë të të lindurve.

Aktgjykimi u miratua derisa procedura vendore për fitimin e shënjimit të ri të seksit/gjinisë, e cila ka filluar para më shumë se shtatë vjet, ka qenë akoma në rrjedhë e sipër para Gjykatës Administrative, pasi që Komisioni shtetëror si autoritet administrativ i shkallës së dytë, e konfirmoi aktvendimin e DALA-s që ta hedhë poshtë kërkesën e aplikantit për shkak të pretendimit për jokompetencë të Drejtorisë për të vepruar (paragrafi 21).

Për më tepër, paraprakisht kërkesa e aplikantit për korigjimin e seksit/gjinisë dhe numrit amë në certifikatën e Librit amë të të lindurve dy herë është refuzuar nga ana e DALA-s meqë “nuk i është lëshuar vërtetim nga organi kompetent me të cilin do të konfirmohet fakti se seksi i aplikantit është ndryshuar” (sipas aktvendimit të parë nga 5 korriku i vitit 2011, paragrafi 10 i aktgjykimit të GJEDNJ-së), përkatësisht nuk ka pasur “provë me të cilën do të konstatohet gjendja faktike e cila e vë në dukje ndryshimin e gjinisë” (sipas aktvendimit të dytë nga 29 dhjetori i vitit 2014, paragrafi 17 i aktgjykimit të GJEDNJ-së), ndërsa kërkesa e këtillë njëherë është hedhur poshtë për shkak të pretendimit për jokompetencë të Drejtorisë (më 28 shkurt të vitit 2018, shih paragrafin 21 të aktgjykimit).

<sup>125</sup> Përndryshe, në mesin e shkaqeve për vonesë, theksohet kriza politike në periudhën kohore nga viti 2015 deri në vitin 2017, si dhe gjendja e jashtëzakonshme e shkaktuar nga pandemia e Covid-19.

<sup>126</sup> *X kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 29683/16, aktgjykim nga 17 janari i vitit 2019.

### Ekzekutimi i aktgjykimit

Duke pasur parasysh se kjo lëndë ishte nën mbikëqyrje të fuqizuar, është e kuptueshme që shteti brenda një periudhe relativisht të shkurtër paraqiti madje pesë Plane të veprimit me të cilat e njofton Komitetin e Ministrave për masat e ndërmarra ose të planifikuara në drejtim të ekzekutimit të aktgjykimit në këtë lëndë.<sup>127</sup> Së këtejmi, mund të vlerësohet se ai ishte mjaft aktiv për sa i përket ekzekutimit të këtij aktgjykimi dhe ka ndërmarrë mjaft përpjekje që të informojë në mënyrë të avancuar dhe në kohë të duhur për të gjitha risitë relevante që janë të rëndësishme për ekzekutimin. Ky aktivitet i tij në masë të madhe ka të bëjë edhe me stimulimin e autoriteteve, i cili është rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm me Këshillin e Evropës në mënyrë që të përshpejtohet ekzekutimi i këtij aktgjykimi.

Është evidente se shkelja është rezultat i pasojës së drejtpërdrejtë të vakumit në rregullimin ligjor të materies në fjalë, por duke pasur parasysh edhe praktikën e keqe administrative që është aplikuar nga organet/autoritetet administrative, dhe para së gjithash nga Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë.

Një gjë e këtillë konfirmohet edhe me faktin që edhe pas miratimit të aktgjykimit, aplikanti është ballafaquar me një sërë vështirësish administrative. Me fjalë të tjera, Gjykata Administrative miratoi aktgjykim me të cilin aktvendimin e DALA nga data 28 shkurt të vitit 2018 e ka shpallur si të pavlefshëm, ndërsa Drejtorisë i ka dhënë udhëzime që ta ndërmarrë përgjegjësinë e kësaj lënde, t'i marrë parasysh gjetjet e Gjykatës dhe t'i nxjerrë të gjitha provat e prezantuara nga aplikanti, ndërsa me iniciativë të Agjentit të Qeverisë, Qeveria mori vendim me udhëzime për DALA-n që të miratojë vendim meritore me të cilin do ta marr në konsideratë kërkesën e aplikantit edhe atë sa më shpejtë që është e mundur. Edhe krahas kësaj, DALA vazhdoi ta hedhë poshtë kërkesën e aplikantit për shkak të pretendimit për jokompetencë, veçanërisht për shkak të vakumit të legjislacionit që e rregullon njohjen juridike të seksit. Njëherësh, ajo i ka injoruar udhëzimet për veprimet e mëtutjeshme, të dhëna nga Komisioni kompetent shtetëror i shkallës së dytë, i cili në fund në mënyrë meritore e ka trajtuar lëndën. Megjithatë, pasi që ky vendim u bë përfundimtar, DALA më 26 tetor të vitit 2020 aplikantit i lëshoi certifikatë të re nga Libri Amë i të Lindurve ku ka qenë i shënuar shënjimi i ndryshuar i seksit/gjinisë dhe NUAQ-ja e re, ndërsa MPB-ja i ka lëshuar letërnjoftim të ri.<sup>128</sup>

Së këtejmi, përveç plotësimit të vakumit juridik në legjislacionin ekzistues, rëndësi

<sup>127</sup> 1362nd meeting (December 2019) (DH), Action plan (21/10/2019), Communication from North Macedonia concerning the case of X. v. North Macedonia (Application No. 29683/16), DH-DD(2019)1391; 1369th meeting (March 2020) (DH), Action plan (17/01/2020), Communication from North Macedonia concerning the case of X. v. North Macedonia (Application No. 29683/16), DH-DD(2020)47; 1369th meeting (March 2020) (DH), Action Plan (18/02/2020), Communication from North Macedonia concerning the case of X v. North Macedonia (Application No. 29683/16), DH-DD(2020)153; 1390th meeting (December 2020) (DH), Action Plan (27/10/2020), Communication from North Macedonia concerning the case of X v. North Macedonia (Application No. 29683/16), DH-DD(2020)959; 1419th meeting (December 2021) (DH), Action Plan (29/09/2021), Communication from North Macedonia concerning the case of X v. North Macedonia (Application No. 29683/16), DH-DD(2021)968

<sup>128</sup> Shih paragrafët 5 – 12 të Planit të veprimit nga 27 tetori 2020

jashtëzakonisht të madhe për ekzekutimin e këtij aktgjykimi kanë edhe ndryshimet e praktikës administrative edhe pse tani për tani planet e veprimit të shtetit kryesisht fokusohen mbi ndërhyrjet e legjislacionit ndaj të cilave ka një qasje serioze.

Nga ana e grupit të punës, i formuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, është hartuar **Propozim-Ligji për ndryshimin edhe plotësimin e Ligjit për Evidencën Amë**. Në momentin e mbylljes së kësaj Analize, ai ishte në procedurë parlamentare dhe i njëjti u paraqit në Kuvend më datë 6 maj të vitit 2021.<sup>129</sup>

Propozuesi i autorizuar i ndryshimeve nënvizon se gjatë përpilimit të tyre është marrë në konsideratë nevoja për tejkalimin e vakumit juridik dhe pasigurisë juridike për personat transgjnorë, e që mund të shihet në miratimin e vendimeve të njëanshme, madje edhe plotësisht në kundërshtim nga ana e institucioneve kompetente në situata të njëjta apo të ngjashme. Njëherësh, me to plotësohet edhe detyrimi i shtetit që t'i implementojë detyrimet e marra ndërkombëtare, të vendosura përmes standardeve të organeve dhe mekanizmave për të drejtat e njeriut pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, si dhe "Parimet e Yogyakarta të plus 10".

Me qëllim që të ndryshohet fakti se sistemi juridik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është njëri nga dhjetë sistemet në Këshillin e Evropës ku nuk është në dispozicion njohja juridike e seksit<sup>130</sup>, me ndryshimet inkorporohen përkufizime për seksin, gjininë dhe identitetin gjinor,<sup>131</sup> ndërsa materia për njohjen juridike të seksit rregullohet në kapitullin e ri IV-A "Njohja juridike e seksit", i cili është shtuar në ligj.

Mes tjerash, në ndryshimet e propozuara ligjore përcaktohet si vijon:

- çdo qytetar i cili ka mbushur moshën 18 vjeçare, i cili ka zotësi për të vepruar dhe i cili nuk është i martuar, ka të drejtë për njohjen juridike të seksit në procedurë të rregulluar me këtë ligj, në të cilën mund ta ndryshojë shenjën e seksit në evidencën amë dhe në këtë mënyrë njihet identiteti gjinor, me ç'rast seksi do të njihet në të gjitha fushat e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve të qytetarëve, në procedurë të përcaktuara me ligj (neni 19-a)
- organi kompetent për veprim është Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë, të cilës i paraqitet kërkesa për njohjen juridike të seksit (neni 19-b paragrafi 1)
- "Në procedurën e njohjes juridike të seksit **nuk** do të kërkohet paraqitja e provave për ndërhyrje kirurgjike për rivendosjen e plotë ose të pjesshme të gjentitaleve, terapisë hormonale ose trajtimit tjetër psikiatrik, psikologjik ose mjekësor të parashtruesit të kërkesës" (neni 19-b paragrafi 2)

<sup>129</sup> Paragrafi 21 i Planit të veprimit të fundit nga 29 shtatori i vitit 2021

<sup>130</sup> Për më shumë detaje, shih: Ministria e Drejtësisë, Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Evidencën Amë, prill 2021, faqe 3, në dispozicion në: [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=51477](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=51477)

<sup>131</sup> Përkufizimet e këtyre nocioneve, si dhe i njohjes juridike të gjinisë, janë përfshirë në katër pika të reja 6, 7, 8 dhe 9 të nenit 1 të Ligjit.

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

- Theksohet përcaktimi i saktë i listës së dokumenteve të cilat duhet t'i bashkëngjiten kërkesës, duke përfshirë këtu edhe deklaratën e aplikantit për njohjen juridike të seksit (neni 19-v paragrafi 2)
- Janë parashikuar afate të sakta për veprim dhe vendimmarrje, brenda të cilave duhet të miratohet aktvendimi për hedhjen poshtë, pranimin ose refuzimin e kërkesës për njohjen juridike të seksit, përkatësisht në rast të miratimit të aktvendimit për njohje juridike të seksit – afati brenda të cilit DALA duhet t'i bëjë ndryshimet e të dhënave të seksit në Librin e Amë të të Lindurve dhe të njëjtat t'ia dërgojë MPB-së për anulimin e numrit amë (neni 19-g, 19-d dhe 19-gj).

Është me rëndësi edhe ajo që me propozim ndryshimet ligjore nuk lejohet këqyrje në regjistrimin e librave amë të të lindurve të personave të cilët e kanë ndryshuar seksin (neni 19-e), ndërkaq parashikohet detyrimi për hartimin e raportit vjetor nga ana e Drejtorisë dhe të njëjtin duhet ta paraqesë për miratim në Qeveri, me ç'rast ai përmban të dhëna për zbatimin e dispozitave për njohjen juridike të seksit me pasqyrën e numrit të përgjithshëm të personave të cilët kanë paraqitur kërkesë për njohje juridike të seksit, të cilëve u është hedhur poshtë ose refuzuar kërkesa dhe për të cilët është miratuar aktvendim për njohjen juridike të seksit, si dhe rekomandime për tejkalimin e vështirësive të konstatuara gjatë zbatimit të këtyre dispozitave (neni 19-zh). Mund të konsiderohet se kjo zgjidhje ligjore duhet të sigurojë zbatim konsekuent dhe efikas të kornizës së re ligjore dhe t'i parandalojë shkeljet e ardhshme të nenit 8 të Konventës, të ngjashme me shkeljet e konstatuara në aktgjykimin X.

### Përmbledhje

Sa u përket masave të përgjithshme të ekzekutimit, në Vendimin e fundit të Komitetit të Ministrave, të miratuar pas shqyrtimit të kësaj lënde në kuadër të takimit të tij DH të mbajtur në mars të vitit 2020, theksohet nevoja e miratimit të kornizës së qartë juridike, e cila do t'i rregullojë kushtet dhe procedurat e njohjes juridike të gjinisë si përgjigje ndaj gjetjeve të Gjykatës.<sup>132</sup> KM-ja i stimulon autoritetet ta hartojnë dhe miratojnë legjislacionin e nevojshëm në linjë me standardet e Këshillit të Evropës, veçanërisht me Rekomandimin e Komitetit të Ministrave CM/Rec(2010) 5 për masat, me qëllim që të luftohet diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Njëherësh, ai e përshëndet planin e aktiviteteve (roadmap) të hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës në drejtim të miratimit të ligjit me të cilin rregullohet njohja e seksit, së këtejmi duke e përcaktuar edhe afatin deri në fund të vitit 2020, në të cilin autoritetet duhet ta sigurojnë miratimin e legjislacionit të ri.<sup>133</sup>

Ekzekutimi i aktgjykimit X vë në dukje se mbështetja nga Këshilli i Evropës përmes ekspertizës së tij dhe ndarjes së përvojave krahasuese evropiane dhe praktikave të mira,

<sup>132</sup> 1369th meeting, 3-5 March 2020 (DH), H46-18 X. v. North Macedonia (Application No. 29683/16), Supervision of the execution of the European Court's judgments, CM/Del/Dec(2020)1369/H46-18, 5 March 2020, pika 4

<sup>133</sup> Pika 5 dhe 6



mund të kontribuojnë në arritjen e kompatibilitetit të zgjidhjeve vendore ligjore dhe praktikës administrative me standardet e Këshillit të Evropës, si dhe në mënyrë efektive të zbatohen aktgjykimet e Gjykatës. Rezultat konkret i këtij bashkëpunimi janë ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të Ligjit për Evidencën Amë.

Mesa duket, me këto ndryshime në mënyrë të saktë përcaktohet organi/autoriteti kompetent, rrjedha e procedurës sipas kërkesës së parashtruar dhe dokumentacioni i nevojshëm për paraqitjen e kërkesës për njohjen juridike të seksit, me çka plotësohet një vakum esencial juridik, procedura në fjalë bëhet plotësisht transparente dhe e qartë, ndërsa njëherësh eliminohet mundësia e arbitraritetit dhe zvarritjes së panevojshme gjatë procedimit të organeve/autoriteteve kompetente shtetërore.

Së këtejmi, miratimi i kornizës së re juridike me të cilën inkorporohen procedura të shpejta, transparente dhe të disponueshme për njohjen juridike të seksit në përputhje me nenin 8 të Konventës dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, do të jetë një hap i rëndësishëm drejt përfundimit të suksesshëm të realizimit të masave të përgjithshme për ekzekutimin e aktgjykimit.<sup>134</sup> Akoma më e rëndësishme është ajo se korniza e këtillë juridike do të ketë mundësi në të ardhmen t'i parandalojë shkeljet e ngjashme të KEDNJ-së.

Ky proces është zhvilluar me shmangie të caktuara nga korniza eparashikuar kohore, në përputhje me impenjimin e Qeverisë të shprehur para Komitetit të Ministrave që ndryshimet ligjore të finalizohen nga Qeveria dhe të dërgohen për miratim në Kuvend, më herët deri në fund të vitit 2020.<sup>135</sup> Për këtë shkak, fillimisht duhet të miratohen ndryshimet ligjore në procedurë parlamentare, dhe pastaj të miratohen akte nënligjore të parashikuara me këtë propozim ligj në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes së tij në fuqi,<sup>136</sup> si dhe të harmonizohen ligjet për realizimin e të drejtës së njohjes juridike të gjinisë në të gjitha fushat në të cilat realizohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve me dispozitat e këtij ligji në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes së tij në fuqi.<sup>137</sup>

Edhe pse mund të konsiderohet se me aktivitetet e ndërmarra, të cilat kanë rezultuar në ndryshime përfundimtare të evidencës zyrtare, me sukses janë zbatuar masat individuale për ekzekutimin e aktgjykimit, vet refuzimi i DALA-s që seriozisht t'i marrë parasysh gjetjet e GJEDNJ-së, si dhe fakti që madje edhe Agjenti i Qeverisë medoemos duhej ta mbështesë procesin e vendimmarrjes përmes adresimit të letrës deri te Komisioni Shtetëror i Shkallës së Dytë, Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative, me të cilën rekomandon që ato t'u përmbahen sugjerimeve të GJEDNJ-së në lëndë të ngjashme të cilat presin të zgjidhen para tyre, e vënë në dukje nevojën se përveç asaj që duhet të rrumbullakohet

<sup>134</sup> Në të vërtetë, rëndësia e kësaj reforme juridike për avancimin e të drejtave të pjesëtarëve të komunitetit LGBTI, u përshëndet nga deputetët e Kuvendit, nga përfaqësuesit e Qeverisë, nga organizatat joqeveritare dhe nga Këshilli i Evropës gjatë diskutimit - online në temën: "Zbatimi i aktgjykimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut X. Kundër Maqedonisë së Veriut dhe ndryshimet në Ligjin për Evidencën Amë", mbajtur më 25 maj të vitit 2021. (Shih dhe paragrafin 35 të Plan të veprimit të fundit nga 29 shtatori i vitit 2021).

<sup>135</sup> Paragrafi 21 i Planit të veprimit nga 27 tetori i vitit 2020

<sup>136</sup> Neni 7 i Propozim ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Evidencën Amë

<sup>137</sup> Neni 9 i Propozim ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Evidencën Amë

korniza legjislativë, duhet të sigurohet edhe qasje sistematike për braktisjen e praktikës së deritanishme të veprimit.

Në këtë kuptim, rëndësi jashtëzakonisht të madhe do të ketë edhe fuqizimi i kapaciteteve për t'i kuptuar në mënyrë të drejtë standardet e Konventës në këtë fushë nga të gjitha institucionet të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të përfshira në procedurën e përgjithshme të njohjes juridike të identitetit gjinor, dhe fillimisht të Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë, por edhe të Komisionit Kompetent Shtetëror të Shkallës së Dytë dhe të gjykatave administrative. Megjithatë, shteti duhet ta monitorojë punën dhe veprimet e tyre në këtë lloj të rasteve dhe në një periudhë të caktuar kohore, të prezantojë të dhëna konkrete për shkallën e zbatimit praktik të zgjidhjeve të propozuara ligjore dhe nevojën për ndryshime eventuale të legjislacionit apo të praktikës, në bazë të "leksioneve të mësuara".

## LËNDA TRAJKOVSKI DHE ÇIPOVSKI<sup>138</sup>

### Gjetjet e GJEDNJ-së

Lënda ka të bëjë me shkeljen e nenit 8 të KEDNJ-së, e cila ka të bëjë me ndërhyrjen e paarsyeshme në të drejtën e aplikantëve për respektimin e jetës së tyre private, duke pasur parasysh mbajtjen e pakufizuar të mostrave të ADN-së që u janë marrë në kuadër të procedurës penale të ngritur kundër tyre në vitin 2009 dhe 2010, me ç'rast dënimi i aplikantit të parë është bazuar në profilin e tij të ADN-së.

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka refuzuar parashtesat e tyre, në të cilat kanë pohuar se policia i ka shkelur të drejtat e tyre të privatësisë përmes marrjes dhe mbajtjes së materialit të tyre të ADN-së (paragrafi 8 dhe 14 të aktgjykimit) me arsyetimin se policia është e autorizuar t'i grumbullojë, përpunojë dhe t'i ruajë të dhënat personale të individit kur ka ekzistuar dyshimi racional se ai ka kryer veprë penale (paragrafi 11), përkatësisht se policia ka vepruar në mënyrë të ligjshme (paragrafi 16). Paditë kundër këtyre vendimeve të Drejtorisë kanë përfunduar pa sukses para gjykatave administrative.

Në procedurën para GJEDNJ-së, aplikantët kanë theksuar se vendi nuk posedon kornizë ligjore me të cilën në mënyrë të qartë rregullohet: marrja, përdorimi, përpunimi, ruajtja dhe fshirja e materialit të ADN-së (paragrafi 10 dhe 37 të aktgjykimit). Ata janë ankuar se qëllimet për shkak të të cilave mund të jenë marrë dhe ruajtur profilet e ADN-së janë formuluar shumë gjerësisht dhe se dispozitat relevante ligjore nuk kanë përcaktuar se sa gjatë mund të mbahet materiali i ADN-së sa u përket personave të dënuar.

Gjykata konsideron se marrja dhe ruajtja e informacioneve të ADN-së ka qenë në shërbim të qëllimit legjitim për zbulimin dhe parandalimin e krimit (paragrafi 49 i aktgjykimit).

<sup>138</sup> Trajkovski dhe Çipovski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 53205/13 dhe 63320/13, aktgjykim nga 13 shkurti i vitit 2020

Megjithatë, sa u përket mangësive të legjislacionit të atëhershëm, GJEDNJ-ja ka vërejtur se ai nuk e ka përcaktuar afatin kohor për ruajtjen e të dhënave të ADN-së së aplikantëve, si persona të pandehur. Fakti që sipas nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka qenë në fuqi, ato kanë pasur mundësi të ruhen jo më gjatë se sa që është e nevojshme që të plotësohen qëllimet për shkak të të cilave janë përpunuar të dhënat personale, ka pasur mundësi të jetë objekt i interpretimeve të ndryshme. Njëherësh, me nenin 54 të ndryshimeve në Ligjin për Policinë, me të cilin është ndryshuar neni 70, është parashikuar se pas marrjes së mostrave të ADN-së nga aplikantët, ato ruhen përgjithmonë. Në mungesë të korrelacionit të ruajtjes së këtyllë me ndonjë afat të caktuar kohor, Gjykata konkludoi se në shtetin e paditur lejohet periudhë e pakufizuar e ruajtjes së profileve të ADN-së (paragrafi 52 i aktgjykimit).

Ajo, njëkohësisht, ka nënvizuar se legjislacioni në fuqi i mundëson shtetit grumbullim, ruajtje dhe depozitim të pakufizuar të të dhënave të ADN-së pa u shqyrtuar serioziteti i veprës penale për të cilën është gjykuar ose dënuar personi ose kritere të tjera të përcaktuara, siç janë arrestimet paraprake ose rrethanat e veçanta, dhe pa kurrfarë mundësie reale për rishikim apo fshirje të të dhënave. Megjithëse, sipas nenit 66 paragrafi 1 të Ligjit për Policinë, policia është e autorizuar t'i fshijë të dhënat personale nga regjistrat në kushte të parashikuara me ligj, Ligji nuk i ka parashikuar këto kushte dhe procedurën që është dashur të ndiqet. Gjithashtu, edhe pse ai e ka parashikuar mundësinë e kontrollit gjyqësor, bashkë me kontrollin paraprak administrativ, nuk ka pasur dispozitë e cila do të lejonte rishikim konkret të nevojës për ruajtjen e të dhënave, madje as dispozitë sipas së cilës personi në fjalë mund të kërkojë që të dhënat që kanë të bëjnë me të të fshihen, nëse ruajtja e tyre më nuk është e nevojshme, duke e pasur parasysh: natyrën e veprës, moshën e personit dhe periudhën kohore që ka kaluar (paragrafi 53 i aktgjykimit).

Në bazë të kësaj që u tha më lartë, GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se duke e pasur parasysh natyrën e përgjithshme dhe joselektive të kompetencave për të mbajtur profilet e ADN-së së aplikantëve, si persona të dënuar për veprë penale, si dhe mungesën e garancive të mjaftueshme mbrojtëse, nuk është arritur balancë e drejtë midis interesit konkurrues publik dhe privat, shteti i paditur e ka tejkaluar margjinën e pranueshme të vlerësimit në këtë aspekt dhe bëhet fjalë për ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e respektimit të jetës private e që nuk mund të konsiderohet si e domosdoshme në një shoqëri demokratike (paragrafi 54 i aktgjykimit).

## Ekzekutimi i aktgjykimit

Në Planin e veprimit të paraqitur për shqyrtim në Komitetin e Ministrave pranë Këshillit të Evropës më 14 dhjetor të vitit 2020<sup>139</sup>, shteti ka vënë në dukje se si përgjigje ndaj aktgjykimit të Gjykatës që në dhjetor të vitit 2020, janë ndërmarrë masa me qëllim që materialet

<sup>139</sup> 1398th meeting (March 2021) (DH), Action Plan (14/12/2020), Communication from North Macedonia concerning the case of Trajkovski and Chipovski v. North Macedonia (Application No. 53205/13), [https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22EXECIdentifier%22:%5B%22DH-DD\(2020\)1164E%22%5D%7D](https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22EXECIdentifier%22:%5B%22DH-DD(2020)1164E%22%5D%7D)

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

relevante të ADN-së të cilat janë marrë nga aplikantët të asgjësohen.<sup>140</sup> Megjithatë, këto masa individuale për shmangien e shkeljeve të konstatuara vetvetiu kanë qenë të pamjaftueshme për parandalimin e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen, nëse të njëjtat nuk shoqërohen me masa të përgjithshme përkatëse të cilat do t'i referohen legjislacionit, veçanërisht duke e pasur parasysh faktin se Gjykata ka vërejtur se korniza rregullatore për ruajtjen e materialit të ADN-së nuk ka qenë shumë precize (paragrafi 48 i aktgjykimit).

Krahas neneve përkatëse të Ligjit të lartpërmendur për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit për Policinë, kornizën juridike për grumbullimin dhe ruajtjen e materialit të ADN-së të siguruar nga aplikantët, e kanë përbërë edhe neni 249 paragrafi 3 dhe paragrafi 5 dhe neni 277 të LPP-së nga viti 2010,<sup>141</sup> nenet 6 dhe 7 të Rregullores për Mënyrën e Kryerjes së Punëve Policore<sup>142</sup> dhe nenet 3, 9, 20 dhe 21 të Udhëzimit të MPB-së për mënyrën dhe metodat e regjistrimit mjeko-ligjor dhe identifikimin e personave dhe trupave të paidentifikuar (paragrafi 21 – 30 të aktgjykimit).

Siç mund të shihet në Planin e veprimit, shteti e identifikoi nevojën për ndryshimin e kornizës ligjore vendase, kështu që në këtë drejtim u miratua Ligji i ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përmbajtja e të cilit në detaje është prezantuar në Planin e veprimit, ndërsa janë paralajmëruar edhe ndryshime në Ligjin për Policinë, i cili tanimë është paraqitur në Kuvend.<sup>143</sup>

**Ligji i ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP)**,<sup>144</sup> i cili hyri në fuqi në shkurt të vitit 2020, të dhënat gjenetike (duke i përfshirë edhe të dhënat e ADN-së) i trajton si kategori e veçantë e të dhënave personale,<sup>145</sup> të cilat mund të përpunohen, mes tjerash, vetëm kur një gjë e këtyllë nevojitet për mbrojtjen e interesit publik, në përputhje me ligjet, duke e respektuar balancin proporcional midis qëllimit për të cilin ato përpunohen dhe të drejtës së respektimit të të dhënave personale, si dhe duke siguruar masa përkatëse për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të personit të prekur.<sup>146</sup> Në këtë kuptim, përcaktohet se përpunimi i të dhënave personale që kanë të bëjnë me shëndetin dhe të dhënat gjenetike (siç janë të dhënat e ADN-së) duhet të zbatohet sipas lejes paraprakisht të lëshuar nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila nuk nevojitet në rastin kur përpunimi është përcaktuar me ligj të veçantë në të cilin janë përcaktuar masat mbrojtëse dhe masa të tjera për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave personale në përputhje me dispozitat e LMDHP-së.<sup>147</sup>

Parimisht, LMDHP-ja e re parashikon se të dhënat personale ruhen jo më gjatë se sa që është e nevojshme për qëllimet për shkak të të cilave përpunohen.<sup>148</sup> Së këtejmi, neni 9 paragrafi

<sup>140</sup> Paragrafi 4 i Planit të veprimit

<sup>141</sup> Ligji për Procedurën Penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2010 dhe 100/2012)

<sup>142</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 149 nga data 10.12.2007

<sup>143</sup> Paragrafi 8 i Planit të veprimit.

<sup>144</sup> Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/2020)

<sup>145</sup> Sipas përkufizimit të përcaktuar në nenin 4 pika 14 të LMDHP-së.

<sup>146</sup> Paragrafi 9 i Planit të veprimit

<sup>147</sup> Paragrafi 14 i Planit të veprimit

<sup>148</sup> Paragrafi 10 i Planit të veprimit

1 alineja 5 e LMDHP-së së re, në thelb nuk ndryshon nga neni 5 i ligjit paraprak në lidhje me periudhën e ruajtjes së të dhënave.

Megjithatë, duhet të kemi parasysh se LMDHP-ja e re në përgjithësi mbështetet në standardet e përcaktuara me legjislacionin e përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave personale të Bashkimit Evropian.<sup>149</sup> Së këtejmi, për shembull, ai, krahas të drejtës së subjektit të të dhënave personale për qasje deri te informacionet e kontrollorit (institucioni i cili i ruan të dhënat) në lidhje me të njëjtat, në nenin 21 e inkorporon “të drejtën për t’u harruar”, përkatësisht të drejtën që të mund të kërkojë nga kontrollori i të dhënave, fshirjen e tyre brenda afatit të caktuar dhe atëherë kur ato më nuk janë të nevojshme për qëllimet për të cilat janë grumbulluar dhe përpunuar në mënyrë tjetër ose kur të dhënat e njëjta personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme.<sup>150</sup>

## Përmbledhje

Me sa duket korniza e re ligjore e vendosur me LMDHP-në nga viti 2020, do t’i plotësojë boshllëqet, paqartësitë dhe pasaktësitë në ligjin paraprak përmes përcaktimit më të saktë të procedurave dhe afateve për marrjen, përpunimin, ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave të ADN-së dhe përdorimin e tyre në procedura penale.

Në mënyrë plotësuese, duhet të bëhet **harmonizimi i legjislacionit të sektorëve** që i nënkupton të gjitha ligjet dhe aktet tjera normative me të cilat rregullohet kjo materie me dispozitat e LMDHP-së, në afat prej 12 muajsh nga dita e hyrjes së tij në fuqi, në mënyrë siç është përcaktuar në nenin 52 të këtij ligji.<sup>151</sup>

Objekt i raportimit të shtetit përmes Planit të veprimit të paraqitur nuk është **Ligji për Mbrojtjen e Personave Fizikë në Lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime Juridike-Penale**,<sup>152</sup> miratimi i të cilit pritet të bëhet deri në fund të vitit 2021. Me fjalë të tjera, ai mund të trajtohet si lex specialis në raport me LMDHP-në, meqë nga teksti i tij rezulton se nga disa aspekte ai mund të konsiderohet si relevant për problematikën që është prekur me aktgjykimin Trajkovski dhe Çipovski, dhe njëkohësisht vërehet një mbivendosje e pjesshme e

<sup>149</sup> *EU General Data Protection Regulation (GDPR): Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation)*, OJ 2016 L 119/1

<sup>150</sup> Shih paragrafët 11 dhe 13 të Planit të veprimit

<sup>151</sup> Në të vërtetë, nevoja e harmonizimit të legjislacionit tjetër me LMDHP-në e re, është theksuar edhe nga Komisioni Ndërinstitucional. Shih: Procesverbalin nga mbledhja e 19-të e Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, mbajtur më datë 8.7.2020 (<https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/06/Зaписник-од-19-тата-седница.pdf>).

<sup>152</sup> Emërtimi i plotë i këtij Ligji është “Ligji për Mbrojtjen e Personave Fizikë në Lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllimet e Parandalimit, Hetimit, Zbulimit ose Ndjekjes së Veprave Penale apo për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale”.

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

përmbajtës së dispozitave të caktuara të tij me ato të LMDHP-së së re.<sup>153</sup>

Ky ligj, duhet ta mundësojë harmonizimin e mëtutjeshëm me legjislacionin evropian në këtë fushë, dhe fillimisht me Direktivën (EU)2016/680 (e njohur si “Direktiva Policore”).<sup>154</sup> Në këtë kuptim, ai duhet të kontribuojë në drejtim të vendosjes së garancive më të larta për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përcaktuar se përpunimi i të dhënave personale do të konsiderohet si i ligjshëm vetëm nëse është i domosdoshëm dhe nëse bëhet në atë masë që është e nevojshme për: qëllimet e parandalimit, hulumtimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale apo për ekzekutimin e sanksioneve penale, me ç’rast në të vërtetë theksohet parimi i proporcionalitetit gjatë përpunimit të të dhënave personale.<sup>155</sup>

Për shembull, në mesin e parimeve që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale të cilat janë përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, theksohet edhe ajo se të dhënat personale grumbullohen për qëllime konkrete, të qarta dhe legjitime dhe nuk do të përpunohen në mënyrë e cila nuk korrespondon me këto qëllime; ato ruhen jo më gjatë se sa që është e nevojshme për qëllimet për shkak të të cilave përpunohen; etj. Neni 6 i përcakton afatet e ruajtjes dhe rishikimit të të dhënave personale, ndërsa neni 7, bën një dallim të qartë ndërmjet kategorive të ndryshme të subjekteve të të dhënave personale.<sup>156</sup>

Si një hap jo më pak i rëndësishëm drejt harmonizimit të legjislacionit me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale mund të konsiderohet edhe nënshkrimi, nga ana e shtetit më 5 dhjetor të vitit 2019, i Protokollit me të cilin ndryshohet Konventa për Mbrojtjen e Individëve sa i përket përpunimit automatik të të dhënave personale, por i cili akoma nuk është ratifikuar.

Nga ana tjetër, edhe përkrah inicimit të procedurës për ndryshimin e Ligjit për Policinë qysh para miratimit të këtij aktgjykimi<sup>157</sup>, sipas informacioneve të fundit të pranuar pas dërgimit të Planit të veprimit të KM-ja, teksti i propozuar i ndryshimeve ligjore është miratuar nga ana e Qeverisë dhe i njëjti është paraqitur në Kuvend, edhe pse shteti parimisht paralajmëroi se ndryshimet do të miratohen deri në fund të vitit 2021.<sup>158</sup> Për më tepër, është me rëndësi

<sup>153</sup> Edhe në Raportin për përcaktimin e ndikimit të legjislacionit që është në dispozicion në ENER, theksohet se norma të caktuara ligjore janë shmangur nga versioni fillestar i këtij propozim-ligji, me qëllim që të shmanget përsëritja e tekstit me atë të LMDHP-së, kështu që të njëjtat janë zëvendësuar duke iu referuar dispozitave përkatëse në LMDHP, ndërsa një pjesë e caktuar janë lënë në propozim-ligjin.

<sup>154</sup> Direktiva (BE)2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga 27 prilli i vitit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga organet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimeve, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe për lëvizjen e lirë e të dhënave të këtitilla dhe për anulimin e Vendimit Kornizë 2008/977/PVR të Këshillit.

<sup>155</sup> 1406th meeting (June 2021) (DH), Action Report (07/05/2021), Communication from North Macedonia concerning the case of J.M. and A.T. v. North Macedonia (Application No. 79783/13), DH-DD(2021)489, paragrafi 18

<sup>156</sup> Këtu bëjnë pjesë personat për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se kanë kryer ose do të kryejnë vepra penale; personat e dënuar për vepra penale; viktimat e veprave penale dhe persona të tjerë në procedurat penale (persona që mund të thirren të dëshmojnë në hetime në lidhje me veprat penale apo procedurat penale, persona të cilët mund të ofrojnë informacione për vepra penale ose kontaktet apo bashkëpunëtorët e personave të pandehur ose të dënuar).

<sup>157</sup> Paragrafi 15 i Planit të veprimit

<sup>158</sup> Paragrafi 16 i Planit të veprimit

të theksohet se edhe Ligji për Policinë në aspekte të caktuara duhet të harmonizohet me Ligjin e ri për Mbrojtjen e Personave Fizikë në Lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime Juridike-Penale.

Me **Propozim ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Policinë**<sup>159</sup> rregullohen evidencat konkrete të cilat i administron policia, që kanë të bëjnë me gjurmët e vijave papilare, profilet e ADN-së dhe me fotografitë e personave. Nga ana tjetër, ajo që është jashtëzakonisht e rëndësishme konsiston me atë se me këto propozim-ndryshime përcaktohet procedura dhe afatet e ruajtjes dhe fshirjes së këtyre të dhënave, që duhet të ketë rol preventiv në parandalimin e shkeljeve të nenit 8 të KEDNJ-së.<sup>160</sup>

Pikërisht nga përmbajtja e zgjidhjeve të reja ligjore dhe nga dinamika e miratimit të tyre, si dhe nga harmonizimi i ndërsjellë i akteve të lartpërmendura normative, do të varet rumbullakimi i plotë i procesit të implementimit të aktgjykimit Trajkovski dhe Çipovski, nga aspekti i masave të ndërmarra të përgjithshme legjislative të ekzekutimit.

## II.5. Lëndët në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 11 (liria e tubimit dhe bashkimit) në kontekst të nenit 9 të Konventës (e drejta e lirisë së mendimit, vetëdijes dhe fesë)

### GRUPI I LËNDËVE “KRYEPESHKOPATA ORTODOKSE E OHRIT (PESHKOPATA GREKE-ORTODOKSE E OHRIT PRANË PATRIARKANËS SË PEJËS)”

#### Gjetjet e GJEDNJ-së

Të gjitha këto lëndë kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtës së shoqatave – aplikante, në lidhje me të drejtën e lirisë së bashkimit sipas nenit 11 në kontekst të nenit 9 të KEDNJ-së, për shkak të refuzimit të gjykatave vendase që t'i regjistrojnë si entitete religjioze në periudhën kohore ndërmjet vitit 2004 dhe 2012.

Fillimisht, ky grup i lëndëve përbëhet nga gjithsej katër lëndë, në të cilat si aplikantë paraqiten: “Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Peshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit pranë Patriarkanës së Pejës)”, në tekstin në vijim: **Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit, KOO**<sup>161</sup> dhe **Bashkësia Bektashiane dhe të tjerët**<sup>162</sup>, të cilat edhe më tutje janë në mbikëqyrje të Komitetit të Ministrave.

<sup>159</sup> Ministria e Punëve të Brendshme, Propozim-Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Policinë, mars 2021, në dispozicion në: [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=64159](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=64159)

<sup>160</sup> Nenet 73, 75 paragrafët 3, 4 dhe 5 si dhe neni 128 paragrafi 1 alineja 13 të Propozim-Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Policinë.

<sup>161</sup> Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Peshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit pranë Patriarkanës së Pejës), nr. 3532/07, aktgjykim nga 16 nëntori i vitit 2017

<sup>162</sup> Bashkësia Bektashiane dhe të tjerët, nr. 48044/10; 75722/12 dhe 25176/13, aktgjykim nga 12 prilli i vitit 2018

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

Ekzekutimi sa u përket dy lëndëve të tjera<sup>163</sup>, u mbyll meqë aplikantët në këto lëndë nuk e shfrytëzuan mundësinë juridike për rihapjen e procedurës së regjistrimit, si rezultat i paraqitjes në kohë jo të duhur të kërkesës për përsëritjen e procedurës (*Manastiri Stavropigjial Shën Gjoni Gojëarti*), përkatësisht revokimin e saj (*Kisha e të Krishterëve të Vërtetë Ortodoksë dhe Ivanovski*).<sup>164</sup> Së këtejmi, kjo analizë kryesisht do të fokusohet mbi rrjedhën dhe stadin në të cilin gjendet ekzekutimi i dy lëndëve të para të grupit.

Fillimisht, duhet të theksohet se në këto lëndë, GJEDNJ-ja konsideron se shkaqet e prezantuara nga gjykatat kombëtare (duke përfshirë këtu edhe Gjykatën Kushtetuese), marrë në përgjithësi nuk kanë qenë “relevante dhe të mjaftueshme” në mënyrë që t'i arsyetojnë ndërhyrjet në të drejtën e bashkimit fetar të aplikantëve (*KOO, paragrafi 120; Bashkësia Bektashiane dhe të tjerët, paragrafi 66*).

Në lëndët kryesore të *Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit* shoqata-aplikante ka iniciuar dy procedura të ndryshme për regjistrim me dy emërtime të ndryshme, duke theksuar se bashkësia fetare do të veprojë si entitet autonom religjioz nën juridiksionin kanonik të Kishës Ortodokse Serbe. Megjithatë, nga njëra anë të dyja kërkesat u refuzuan nga gjykatat e rregullta, kryesisht për shkaqe formale, por nga ana tjetër edhe Gjykata Kushtetuese kërkesën e paraqitur për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave e shpalli si të “palejueshme” për shkak të mospërmbushjes së kërkesave formale.

Gjatë refuzimit të kërkesave të tyre, autoritetet kompetente u janë referuar edhe dy bazave të tjera: se shoqata-aplikante është themeluar nga një shtet ose kishë e huaj që e ka bërë të papranueshme për regjistrim (paragrafi 106), meqë emërtimet e propozuara kanë qenë problematike, veçanërisht për shkak të faktit se kanë qenë shumë të ngjashme me emërtimin e “Kishës Ortodokse Maqedonase – Kryepeshkopata e Ohrit” (paragrafi 110), e cila e ka pasur “të drejtën historike, fetare, morale dhe thelbësore” ta përdorë emërtimin “Kryepeshkopata e Ohrit” (paragrafi 112), ndërsa qëllimi i shoqatës – aplikante ka qenë “të bëhet subjekt paralel fetar me KOM-in” dhe “t’ia marrë pozitën KOM-it dhe identitetin e saj historik” (paragrafi 115).

Sipas pikëpamjes së Gjykatës, legjislacioni relevant nuk e përjashton regjistrimin e organizatës fetare të themeluar nga ndonjë shtet apo kishë e huaj (paragrafi 107), emërtimi i përzgjedhur ka qenë mjaftueshëm specifik që të diferencohet nga KOM-i – Kryepeshkopata e Ohrit (paragrafi 111) dhe asgjë nuk ka paragjykuar se përdorimi i tij do t’i cenojë të drejtat dhe liritë, veçanërisht liritë fetare, të të tjerëve (paragrafi 113). Për më tepër, në asnjë fazë të procedurës së regjistrimit dhe të procedurës para saj, nuk është pohuar se shoqata aplikante angazhohet për përdorimin e dhunës ose të mjeteve antidemokratike për arritjen e qëllimeve të veta (paragrafi 120). Së këtejmi, refuzimi që të njihet shoqata aplikante, si

<sup>163</sup> *Manastiri Stavropigjial Shën Gjoni Gojëarti*, nr. aktgjykim nga 29 nëntori i vitit 2018 dhe *Kisha e të Krishterëve të Vërtetë Ortodoksë* nr. 35700/11, aktgjykim nga 29 nëntori i vitit 2018

<sup>164</sup> Mbyllja e këtyre dy lëndëve u konstatua me Vendimin e Komitetit të Ministrave: Ministers’ Deputies, 1377th meeting, 4 June 2020 (DH), H46-23 “Orthodox Ohrid Archdiocese (Greek-Orthodox Ohrid Archdiocese of the Peć Patriarchy)” v. North Macedonia (Application No. 3532/07) Supervision of the execution of the European Court’s judgments, pika 2 dhe 3.



organizatë religjioze në mungesë të shkaqeve “relevante dhe të mjaftueshme” të cilat do ta justifikojnë atë, nuk mund të pranohet si e domosdoshme në një shoqëri demokratike (paragrafi 121).

Në lëndën e *Bashkësisë Bektashiane*, shoqata aplikante ka vepruar si organizatë fetare zyrtarisht e njohur qysh në vitin 1993, megjithatë, kërkesa e parë e saj për njohjen e statusit të vazhdueshëm juridikë të saj, u refuzua për shkaqe formale pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për pozitën juridike të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz në vitin 2007, meqë ajo nuk është regjistruar deri në vitin 1998, por vetëm është paraqitur në regjistrin e Komisionit të Bashkësive Fetare dhe të Grupeve Religjioze në vitin 2000 (paragrafi 21). Kërkesa e dytë për regjistrim u refuzua në vitin 2010, kryesisht meqë emërtimi i saj tanimë ka qenë pjesë përbërëse e subjektit fetar tanimë të regjistruar, burimet e mësimit fetar të saj ishin të njëjta si të organizatës fetare tanimë të regjistruar (paragrafi 24), kështu që regjistrimi i saj ka pasur mundësi të shkaktojë konfuzion midis besimtarëve (paragrafi 30). Sipas Gjykatës, refuzimi që aplikantit t’i njihet statusi i vazhdueshëm i subjektit religjioz në kuadër të procedurës së parë nuk mund të konsiderohet si ndërhyrje e “domosdoshme në një shoqëri demokratike” (paragrafi 66 i aktgjykimit).

Ngjashëm si edhe në rastin *KOO-së*, në arsyetimin e saj Gjykata ka theksuar se emërtimi i zgjedhur për shoqatën aplikante, ka qenë mjaftë specifik që ta diferencojë nga grupi tjetër religjioz tanimë i regjistruar bektashian (paragrafi 71). Sa i përket burimeve identike të mësimit fetar të tij me atë të Bashkësisë Fetare Islame, si bazë e dytë për refuzimin e regjistrimit të *Bashkësisë Bektashiane*, sipas opinionit të Gjykatës, vlerësimi dhe interpretimi i këtillë i doktrinës themelore të besimit është inkompatibil me rolin e shtetit si organizator neutral dhe i paanshëm sa i përket praktikimit të religjioneve, besimeve dhe bindjeve të ndryshme, e që nga ana tjetër, përveç në raste të jashtëzakonshme, e përjashton diskrecionin e shtetit që ta vlerësojë legjitimitetin e bindjeve religjioze ose mënyrën e manifestimit të tyre (paragrafi 72).

Përfundimisht, sipas GJEDNJ-së, nuk mban pikëpamja e Gjykatës Kushtetuese që ka të bëjë me nevojën e mos-regjistrimit të shoqatës aplikante, në mënyrë që “të parandalohen konflikte religjioze” meqë nuk janë prezantuar prova se emërtimi i cili ka kërkuar njohje, ka paraqitur ndonjë rrezik për shoqërinë demokratike, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se ajo ligjërisht ka ekzistuar dhe ka vepruar si bashkësi e pavarur religjioze brenda shtetit shumë vjet para hyrjes në fuqi të Ligjit në vitin 2007. Së këtejmi, Gjykata konkludoi se, si në lëndën *KOO* ashtu edhe në lëndën konkrete, nga autoritetet vendase, nuk janë prezantuar shkaqe/motive posaçërisht serioze dhe bindëse për refuzimin e regjistrimit të shoqatës aplikante (paragrafi 73).

## Ekzekutimi i aktgjykimeve

Pas miratimit të aktgjykimeve në fjalë dhe pasi që të njëjtat janë bërë përfundimtare, shteti ndërmori përpjekje të mjaftueshme për raportimin në kohë të duhur te Komiteti i Ministrave

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

për masat e planifikuara dhe të ndërmarra për ekzekutimin e tyre përmes hartimit të katër Planeve të veprimit.<sup>165</sup> Këto plane të veprimit në masë të madhe i pasqyrojnë konkluzionet e miratuara në kuadër të mbledhjes së 15-të të Komisionit Ndërinstitucional, në të cilën është shqyrtuar statusi i ekzekutimit të këtij grupi të lëndëve.<sup>166</sup>

Meqë shkeljet në këto aktgjykime kanë rezultuar nga praktika e gjykatave, dhe jo nga korniza ligjore për regjistrimin e kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze, është e arsyeshme që shteti fokusin e aktiviteteve lidhur me implementimin e aktgjykimeve e vuri pikërisht mbi ndryshimet e praktikës gjyqësore gjatë procedimit të materies për regjistrim, që të sigurohet se e njëjta do të jetë komplementare me Konventën. Për më tepër, në mbështetje të këtyre ndryshimeve prezantohet edhe shembulli kur është mundësuar regjistrimi i bashkësisë fetare në Regjistrin gjyqësor të kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze, e cila ka pasur burime identike apo të ngjashme doktrinare të mësimit fetar me një bashkësi tjetër fetare të regjistruar paraprakisht.<sup>167</sup>

Mes tjerash, theksohet edhe fakti se pas miratimit të aktgjykimeve që kanë të bëjnë me këtë grup të lëndëve, dhe përfundimisht me paraqitjen e Planit të veprimit të fundit të rishikuar më 27 mars të vitit 2020, nuk janë paraqitur kërkesa të ngjashme për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave para Gjykatës Kushtetuese, madje nuk janë evidentuar as lëndë të reja të ngjashme, të cilat janë iniciuar përmes aplikimit të paraqitur pranë GJEDNJ-së dhe për të cilat në Strasburg procedura është në rrjedhë e sipër.<sup>168</sup>

Të lidhura ngushtë dhe të nevojshme për implementimin e drejtë të standardeve të Konventës në këtë fushë nga ana e gjyqtarëve të cilët i trajtojnë çështjet e regjistrimit dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, janë edhe trajnimet dhe aktivitetet e tjera edukative të cilat duhet të kontribuojnë në adresimin e shkaqeve të shkeljeve që kanë të bëjnë me praktikën joadekuate të gjykatave dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e këtyre standardeve.<sup>169</sup> Përveç kësaj, edhe përfshirja e gjyqtarëve në procesin e konsultimeve për mënyrën e ekzekutimit të këtyre aktgjykimeve me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës, po ashtu, mund të ndihmojë në ndryshimin e praktikës gjyqësore kur bëhet fjalë për procedurat e ardhshme të regjistrimit

<sup>165</sup> 1340th meeting (March 2019) (DH), Action plan (21/12/2018), Communication from “the former Yugoslav Republic of Macedonia” concerning the Orthodox Ohrid Archdiocese group of cases v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Application No. 3532/07), DH-DD(2019)6; 1340th meeting (March 2019) (DH), Action plan (25/02/2019), Communication from North Macedonia concerning the Orthodox Ohrid Archdiocese group of cases (Application No. 3532/07), DH-DD(2019)192; 1362nd meeting (December 2019) (DH), Action plan (13/11/2019), Communication from North Macedonia concerning the Orthodox Ohrid Archdiocese group of cases v. North Macedonia (Application No. 3532/07), DH-DD(2019)1393 и 1377th meeting (June 2020) (DH), Revised action plan (27/03/2020), Communication from North Macedonia concerning the case of Orthodox Ohrid Archdiocese v. North Macedonia (Application No. 3532/07), DH-DD(2020)295

<sup>166</sup> Shih Procesverbalin nga mbledhja e 15-të e Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, mbajtur më 20 shtator të vitit 2018, në dispozicion në <http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/MK-Zapisnik.pdf>.

<sup>167</sup> Paragrafi 75 i Planit të veprimit të rishikuar të datës 27 mars i vitit 2020

<sup>168</sup> Paragrafi 76 i Planit të veprimit të rishikuar të datës 27 mars i vitit 2020

<sup>169</sup> Për më shumë detaje, shih paragrafët 30 – 33 të Planit të veprimit nga muaji nëntor i vitit 2018, paragrafët 51 – 54 të Planit të veprimit nga muaji shkurt i vitit 2019 dhe paragrafët 69 – 71 të Planit të veprimit të rishikuar nga muaji mars i vitit 2020.

të subjekteve religjioze.<sup>170</sup>

## Përmbledhje

Përderisa procedimi dhe vendimmarrja ndaj kërkesave individuale për regjistrimin e dy subjekteve të para nga ky grup është akoma në rrjedhë e sipër, fokusi është mbi masat e përgjithshme për implementim, nga zbatimi i suksesshëm i të cilave do të varet edhe zhvillimi i drejtë i procedurave të ngjashme në të ardhmen. Madje, edhe vet mbyllja e shqyrtimit të procesit të ekzekutimit sa u përket dy lëndëve të tjera të këtij grupi është bërë me atë se edhe më tutje ekziston mundësia për shoqatat aplikante të iniciojnë procedura të reja për regjistrim, të cilat pritet që të zhvillohen në përputhje me Konventën, duke e pasur parasysh influencën pozitive nga masat tanimë të ndërmarra të përgjithshme në lidhje me ndryshimet në praktikën gjyqësore vendase.<sup>171</sup>

Në vendimin me të cilin janë mbyllur dy lëndët e fundit të grupit, shteti duhet të paraqesë vlerësim të përditësuar të ndikimit të masave të ndërmarra.<sup>172</sup> Përveç kësaj, Komiteti i Ministrave potencon se epilogu i procedurave eventuale sipas ankesës kundër aktvendimeve të miratuara me të cilat është refuzuar regjistrimi i subjekteve nga dy lëndët e para të këtij grupi do të ishte një tregues për efikasitetin e masave të miratuara të përgjithshme.<sup>173</sup>

Pikërisht për këtë shkak nevojitet që shteti në mënyrë të vazhdueshme dhe në afat të gjatë t'i monitorojë ndryshimet faktike, të cilat mund të ndodhin në praktikën gjyqësore që ka të bëjë me këtë problematikë, ndërsa në këtë drejtim duhet të kontribuojnë edhe aktivitetet për fuqizimin e kapaciteteve dhe ngritjen e vetëdijes së gjyqtarëve në drejtim të zbatimit të standardeve të GJEDNJ-së në këtë fushë, duke përfshirë këtu edhe organizimin e aktiviteteve edukative nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë. Kjo duhet të jetë në funksion të mirëkuptimit dhe garantimit të plotë të koncepteve të pluralizimit fetar dhe tolerancës midis subjekteve të ndryshme dhe konkurrencte fetare në situatë konflikti ndërmjet ose brenda grupeve religjioze, si një kërkesë thelbësore e cila rezulton nga jurisprudenca e GJEDNJ-së (paragrafi 119 i aktgjykimit të KOO).

<sup>170</sup> Paragrafi 55 i Planit të veprimit nga muaji shkurt i vitit 2019 dhe paragrafi 73 i Planit të veprimit të rishikuar nga muaji mars i vitit 2020.

<sup>171</sup> Ministers' Deputies, 1377th meeting, 4 June 2020 (DH), H46-23 "Orthodox Ohrid Archdiocese (Greek-Orthodox Ohrid Archdiocese of the Peç Patriarchy)" v. North Macedonia (Application No. 3532/07), Supervision of the execution of the European Court's judgments, pika 2 dhe 3

<sup>172</sup> Ministers' Deputies, 1377th meeting, 4 June 2020 (DH), H46-23 "Orthodox Ohrid Archdiocese (Greek-Orthodox Ohrid Archdiocese of the Peç Patriarchy)" v. North Macedonia (Application No. 3532/07), Supervision of the execution of the European Court's judgments, pika 7

<sup>173</sup> 1377th meeting, 4 June 2020 (DH) (written procedure) Human rights, H46-23 "Orthodox Ohrid Archdiocese (Greek-Orthodox Ohrid Archdiocese of the Peç Patriarchy)" v. North Macedonia (Application No. 3532/07), Notes on the Agenda, CM/Notes/1377/H46-23, fq. 4

### II.6. Lëndët në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 1 të Protokollit nr. 1 ndaj Konventës (mbrojtja e pronësisë)

#### LËNDA STREZOVSKI DHE TË TJERËT<sup>174</sup>

##### Gjetjet e GJEDNJ-së

Në këtë lëndë, aktgjykimi i GJEDNJ-së ka të bëjë me shkeljen e të drejtës së aplikantëve për gëzimin e pronësisë së tyre të mbrojtur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 ndaj Konventës, duke e pasur parasysh detyrimin e imponuar të paguajnë kompensim për fuqinë e angazhuar si pjesë fikse e kompensimit të energjisë termike, edhe pse banesat e tyre paraprakisht janë shkyçur nga rrjeti i ngrohjes qendrore. Ky detyrim filloi në tetor të vitit 2012, kur ky kompensim u inkorporua me miratimin e rregullave për furnizim me energji termike (në tekstin në vijim: "Rregullat") nga Komisioni Rregullator i Energjetikës.<sup>175</sup> Duhet të theksohet se më 1 prill të vitit 2019, kanë hyrë në fuqi Rregullat e reja të miratuara më 28 mars të vitit 2019,<sup>176</sup> në bazë të Ligjit të ri për Energjetikë nga viti 2018.<sup>177</sup>

Në aktgjykimin, GJEDNJ-ja konstatoi se gjykatat vendase, duke vepruar ndaj kundërshtimeve të paraqitura nga aplikantët kundër aktvendimeve për ekzekutimin e pagesës së kompensimit të imponuar, pa bërë këqyrje në vendin e ngjarjes ose pa ekspertizë, kanë ardhur në përfundim se aplikantët janë të ashtuquajtur "përdorues pasivë" të energjisë termike, e cila transmetohet në ndërtesë përmes rrjetit të ngrohjes qendrore dhe sipas kësaj "të gjitha banesat (e shkyçura) në ndërtesë të lidhura me sistemin e ngrohjes qendrore e kanë pasur për detyrë të paguajnë kompensim për fuqinë e angazhuar, pavarësisht pozitës së banesës, llojit apo realizimit të instalimit të brendshëm" (paragrafi 9 i aktgjykimit).

Nga ana tjetër, Gjykata e Strasburgut, konstatoi se nuk ka garanci mbrojtëse të mjaftueshme procedurale gjatë aplikimit nga ana e gjykatave vendase të kornizës ligjore në lidhje me pagesën e kompensimit të fuqisë së angazhuar termike, e që përcaktohet në bazë të Sistemit tarifor për shitjen e energjisë termike. Ajo konsideron se në procedurat në fjalë ka qenë e nevojshme në mënyrë precize të specifikohen faktet të cilët janë kontestuar nga aplikantët, përmes verifikimit të argumenteve të tyre në lidhje me nivelin e energjisë termike të siguruar përmes sistemit të ngrohjes qendrore në ndërtesa, të cilin pretendohet se e kanë përdorur njësitë e banimit të këtyre ndërtesave. Vetëm pas verifikimit të të gjithë faktorëve relevantë, do të ishte e mundshme që autoritetet vendase të bëjnë vlerësim objektiv të përdorimit "indirekt" të energjisë termike në çdo rast të veç e veç (paragrafi 87 i aktgjykimit). Megjithatë, përveç faktit se shteti ka marrë parasysh të gjerë për vlerësim të lirë, Gjykata gjeti se ai nuk ka bërë

<sup>174</sup> Strezovski dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 14460/16 dhe 7 aplikacione të tjera, aktgjykim nga 27 shkurti i vitit 2020

<sup>175</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 97/12

<sup>176</sup> Rregulla për furnizimin me energji termike, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 65/2019, 162/19 dhe 233/20

<sup>177</sup> Ligji për Energjetikë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19

balancim të drejtë të interesave të ndryshëm dhe nuk ka pasur sukses që të sigurojë mbrojtje përkatëse të të drejtave pronësore të aplikantëve.

## Ekzekutimi i aktgjykimit

Masat tanimë të ndërmarra dhe të parashikuara për ekzekutimin e këtij aktgjykimi, mund të shqyrtohen përmes prizmit të Planit të veprimit të paraqitur që është hartuar nga shteti,<sup>178</sup> si dhe përmes dy parashtresave (komunikimeve) të organizatës joqeveritare “No pasaran”<sup>179</sup> adresuar deri te Komiteti i Ministrave në bazë të Rregullit 9.2 për mbikëqyrje mbi ekzekutimin e aktgjykimeve dhe kushteve për ujdj miqësore.

Krahas masave individuale të ekzekutimit, duke e përfshirë edhe mundësinë për rihapjen e procedurave kontestuese civile të cilat aplikantët i kanë zhvilluar si mjet për *restitutio in integrum*,<sup>180</sup> implementimi i suksesshëm i këtij aktgjykimi, nënkupton edhe masa të përgjithshme përkatëse, pa të cilat mbikëqyrja mbi ekzekutimin nuk do të mund të mbyllet.

Me fjalë të tjera, nevoja e parandalimit të shkeljeve të ngjashme rezulton nga fakti se ky aktgjykim hap çështje të natyrës së përgjithshme të cilat prekin më shumë persona të tjerë, të cilët janë në gjendje të ngjashme si aplikantët (paragrafi 49 i aktgjykimit). Së këtejmi, sipas Qeverisë, janë prekur 12.000 nga 60.000 banesa në ndërtesa banimi, të cilat janë shkyçur nga rrjeti i ngrohjes qendrore (paragrafi 10 dhe paragrafi 49 të aktgjykimit), pronarët e të cilave, me sa duket, kanë qenë të detyruar ta paguajnë kompensimin në fjalë për fuqinë e angazhuar. Këto numra flasin vetvetiu për madhësinë e problemit dhe për nevojën e mirëkuptimit përkatës dhe ekzekutimin e aktgjykimit.

Edhe pse burimi i shkeljeve të së drejtës së pronësisë së aplikantëve në këtë aktgjykim, fillimisht duhet të kërkohet në qasjen e pamjaftueshme të individualizuar të gjyqësorit vendor në lidhje me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të Rregullave nga viti 2012, do të ishte e pëlqyeshme vazhdimisht të monitorohet zbatimi i Rregullave ekzistuese nga viti 2019<sup>181</sup> dhe eventualisht, nëse paraqitet nevoja, të njëjtat të rishikohen, me qëllim që interpretimi dhe zbatimi i tyre në të ardhmen nga ana e gjykatave të mos jetë shkas për shkelje të reja të ngjashme, si ato që u konstatuan nga GJEDNJ-ja në këtë aktgjykim.

<sup>178</sup> 1398th meeting (March 2021) (DH), Action Plan (22/12/2020), Communication from North Macedonia concerning the case of Strezovski and Others v. North Macedonia (Application No. 14460/16), DH-DD(2021)4

<sup>179</sup> 1383rd meeting (29 September – 1 October 2020) (DH), Communication from an NGO (No Pasaran, Skopje) (18/08/2020) concerning the case of Strezovski and Others v. North Macedonia (Application No. 14460/16), Information made available under Rule 9.2 of the Rules of the Committee of Ministers for the supervision of the execution of judgments and of the terms of friendly settlements, DH-DD(2020)766 dhe 1398th meeting (March 2021) (DH), Communication from an NGO (No Pasaran, Skopje) (03/02/2021) in the case of Strezovski and Others v. North Macedonia (Application No. 14460/16), Information made available under Rule 9.2 of the Rules of the Committee of Ministers for the supervision of the execution of judgments and of the terms of friendly settlements

<sup>180</sup> Paragrafi 95 i aktgjykimit dhe paragrafi 4 i Planit të veprimit

<sup>181</sup> Rregullat për furnizimin me energji termike, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 65/19, 162/19 dhe 233/20.

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

Në përputhje me Rregullat nga viti 2019, ofrohet mundësia për shkyçje nga sistemi me kërkesë të pronarit, përmes plotësimit të kushteve të caktuara dhe realizimit të procedurës së përgjithshme administrative. Në parim, pronari duhet të dëshmojë se sistemi alternativ i ngrohjes që do të përdoret pas shkyçjes është energjetikisht më efikas dhe ekologjikisht më i pranueshëm në krahasim me sistemin e ngrohjes qendrore, por nga ana tjetër, janë parashikuar edhe një sërë rrethanash të tjera, ekzistimi i të cilave përcaktohet gjatë procedurës së parashikuar: pëlqim nga pronarët e tjerë, a përdoret hapësira, a ka qenë paraprakisht i lidhur në sistem etj. Së këtejmi, mund të shihet tendenca e ndryshimit të Rregullave pikërisht në pjesën e shkyçjes së përdoruesve të sistemit të ngrohjes qendrore, me ç’rast njëkohësisht nevojiten saktësime plotësuese, gjegjësisht masa më të rrepta për shkyçje. Po ashtu, duhet të nënvizohet se një pjesë e ndryshimeve të fundit të Rregullave u bënë në përputhje me Ligjin për Efikasitet Energjetik nga viti 2020, me të cilin bëhet harmonizimi i legjislacionit vendor me të drejtën e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

## Përmbledhje

Nga ajo që u tha më lartë, mund të shihet se shteti ka qenë i vetëdijshëm për problemin e identifikuar në aktgjykimin *Strezovski dhe të tjerët* dhe ka bërë përpjekje që ta adresojë atë qysh para miratimit të këtij aktgjykimi, kështu që disa herë i ka ndryshuar Rregullat, të cilat kanë parashikuar individualizim më të madh të rrethanave për çdo banesë të shkyçur nga rrjeti i ngrohjes qendrore dhe konform kësaj, të përcaktohet se a duhet dhe në çfarë shume duhet të bëhet pagesa e kompensimit.

Shteti ka theksuar se me hyrjen në fuqi të Rregullave të reja nga 28 marsi i vitit 2019, nga konsumatorët të cilët i kanë përmbushur kushtet e lirit të pagesës së kompensimit më nuk u është kërkuar të paguajnë kompensim fiks për fuqinë e angazhuar (paragrafi 31 i aktgjykimit dhe paragrafi 12 i Planit të veprimit). Pastaj, si rezultat i ndryshimeve të Rregullave nga 24 shtatori i vitit 2020, mbi 6.700 njësi banesore janë shkyçur nga rrjeti i qytetit për ngrohje qendrore dhe nuk paguajnë kompensim fiks për fuqinë e angazhuar.<sup>182</sup> Krahas përpjekjeve nga ana e shtetit, me sa duket një pjesë e dispozitave të Rregullave parashikojnë kushte dhe procedura të caktuara për shkyçje nga sistemi i ngrohjes qendrore, të cilat shkaktojnë pakënaqësi tek organizata joqeveritare “No pasaran”, siç është theksuar në adresimet e saj deri te Komiteti i Ministrave.<sup>183</sup>

<sup>182</sup> Paragrafi 18 i Planit të veprimit

<sup>183</sup> 1383rd meeting (29 September – 1 October 2020) (DH), Communication from an NGO (No Pasaran, Skopje) (18/08/2020) concerning the case of Strezovski and Others v. North Macedonia (Application No. 14460/16), Information made available under Rule 9.2 of the Rules of the Committee of Ministers for the supervision of the execution of judgments and of the terms of friendly settlements. DH-DD(2020)766 dhe 1398th meeting (March 2021) (DH), Communication from an NGO (No Pasaran, Skopje) (03/02/2021) in the case of Strezovski and Others v. North Macedonia (Application No. 14460/16), Information made available under Rule 9.2 of the Rules of the Committee of Ministers for the supervision of the execution of judgments and of the terms of friendly settlements. DH-DD(2021)188

Kështu që, pavarësisht asaj se me ndryshimet dhe plotësimet e fundit të Rregullave në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk janë të prekur aplikantët e aktgjykimit *Strezovski dhe të tjerët*, është e rëndësishme që të analizohen në mënyrë të thuktë të gjitha ndryshimet e deritanishme në kornizën ligjore dhe vazhdimisht të monitorohet se me zbatimin e tyre nga ana e gjykatave a bëhet individualizimi i nevojshëm i rasteve, me ç'rast do të parandalohen shkelje të ngjashme të të drejtave pronësore, si ato të konstatuara në aktgjykimin *Strezovski dhe të tjerët*.

Edhe pse në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk ka të bëjë me ekzekutimin e aktgjykimit, megjithatë, duhet të theksohet se me një qasje të këtyllë sistematike, shteti duhet ta rishikojë nevojën e mbetjes në fuqi të disa nga rregullat ekzistuese ose t'i qaset ndryshimit të të njëjtave, përmes qasjes inkluzive dhe interdisiplinore nga ana e institucioneve relevante dhe politikëbërësve në fushën konkrete.

Nënkuptohet, aspekti më i rëndësishëm i ndryshimeve që duhet të ndodhin në sistemin juridik kombëtar lidhur me këtë aktgjykim, duhet t'i referohet ndryshimit, përkatësisht zhvillimit të jurisprudencës së praktikës relevante gjyqësore, veçanërisht kur bëhet fjalë për veprimin e gjykatave në lëndë të ngjashme, me ç'rast do të parandaloheshin shkeljet potenciale të ardhshme të së drejtës së pronësisë sa u përket personave të tjerë të cilët janë ballafaquar ose gjenden në situatë të njëjtë apo të ngjashme si aplikantët.

Në këtë kuptim, duhet të përhëndeten përpjekjet e ndërmarra nga ana e Agjentit të Qeverisë, i cili në korrik të vitit 2020, rekomandimet e tij lidhur me masat që duhet të ndërmerren me qëllim të ekzekutimit të këtij aktgjykimi dhe parandalimit të shkeljeve të ngjashme ua dërgoi: Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore Civile në Shkup, duke e nënvizuar detyrimin e tyre që t'i implementojnë gjetjet e GJEDNJ-së të specifikuar në këtë aktgjykim kur do të trajtojnë lëndë të ngjashme.<sup>184</sup>

Për më tepër, është jashtëzakonisht e rëndësishme, nëse një gjë e këtyllë është e mundshme, që Plani i veprimit i rishikuar t'i përfshijë ndryshimet në praktikën gjyqësore, përmes komunikimit të modeleve të vendimeve të miratuara nga gjykatat vendase sipas aktgjykimit të lëndës *Strezovski dhe të tjerët*, në të cilat në mënyrë përkatëse do të implementohen standardet e Strasburgut në këtë fushë.

Në këtë kontekst, mund të mendohet për avancimin e mëtutjeshëm të praktikës gjyqësore përmes miratimit të qëndrimit përkatës parimor ose opinionit juridik parimor në nivel të departamentit civil të Gjykatës Supreme, dhe në këtë mënyrë do të manifestohet pozita autoritare dhe drejtimi për gjykatat më të ulëta në lidhje me mënyrën e nevojshme të procedimit dhe vendimmarrjes në raste të këtylla, me qëllim që të përmbushen standardet e Konventës dhe të shmangët jokonsekuenca në praktikën gjyqësore vendase. Kompetencën për miratimin e opinionëve juridike sa i përket këtij lloji të lëndëve, Gjykata Supreme tanimë

<sup>184</sup> Paragrafi 19 i Planit të veprimit

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

një herë e ka realizuar,<sup>185</sup> megjithatë, gjetjet e GJEDNJ-së në aktgjykimin në fjalë, mund t'i vinë në ndihmë Gjykatës Supreme gjatë përcaktimit të mëtutjeshëm të pozitave të saj, me çka ajo në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndihmojë në implementimin efektiv kombëtar të këtij aktgjykimi.

Përfundimisht, në drejtim të nevojës për veprim prioritar të të gjithë faktorëve relevantë që kanë të bëjnë me ekzekutimin e këtij aktgjykimi, është edhe fakti që ai ka të bëjë me të ashtuquajturat “raste kryesore”, duke pasur parasysh numrin e madh të aplikacioneve të paraqitura pranë Regjistrat të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me problematikën e njëjtë. Në të vërtetë, konfirmim për këtë është edhe fakti se për shqyrtim dhe deklarim deri te Agjenti i Qeverisë janë paraqitur madje 117 aplikacione, të cilat përmbajnë thujta se pretendime identike ankimore. Së këtejmi, duke e pasur parasysh praktikën tanimë të vendosur në lëndën *Strezovski dhe të tjerët*, përfundimisht në fund të muajit shtator të vitit 2021, në lidhje me 66 aplikacione është arritur ujdj miqësore midis shtetit dhe aplikantëve, që është përcaktuar me shtatë vendime të veçanta të Gjykatës dhe për pasojë këto lëndë janë shlyer nga lista e Gjykatës.<sup>186</sup> Procedura sa u përket lëndëve të tjera të komunikuar është në rrjedhë e sipër.

### LËNDA JAKIMOVSKI DHE TRANSPORTI KARI<sup>187</sup>

#### GJETJET e GJEDNJ-së

Lënda *Jakimovski dhe Transporti Kari* ka të bëjë me shkeljen e të drejtave pronësore të aplikantëve nga neni 1 i Protokollit nr. 1 ndaj Konventës, si rezultat i sekuestrimit të kamionit të tyre në vitin 2009 gjatë procedurës së kundërvajtjes doganore.

Përkatësisht, Komisioni për Vendimmarrje Sipas Kundërvajtjes Doganore, konstatoi se aplikanti i parë ka bërë kundërvajtje sipas nenit 263 (1) (5) të Kodit Doganor, me ç'rast shqiptoi gjobë në shumë prej 1.500 eurosh, sekuestrimit të mallit si masë e parashikuar e detyrueshme dhe e veçantë kundërvajtëse në përputhje me nenin 267 (1) dhe (2) të Ligjit,

<sup>185</sup> Për më shumë detaje, shih paragrafin 20 të aktgjykimit i cili ka të bëjë me opinionin tanimë të theksuar juridik të Departamentit civil pranë Gjykatës Supreme, i cili thotë: „... konsumatorët të cilët asnjëherë nuk kanë qenë të lidhur me sistemin e ngrohjes qendrore, asnjëherë nuk kanë lidhur kontratë për furnizim me energji termike dhe në banesën e të cilëve nuk ka instalim të vendosur nga furnizuesi, nuk kanë status të konsumatorëve të shqyrcur pasivë dhe së këtejmi nuk duhet të paguajnë kompensim për fuqi të angazhuar”.

<sup>186</sup> *Stojanovski dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 14961/16 dhe 13 aplikacione të tjera, vendim nga 21 marsi i vitit 2021, *Trajkovski dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 34016/17 dhe 10 aplikacione të tjera, vendim nga 21 marsi i vitit 2021, *Nakevska dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 53739/16 dhe 7 aplikacione të tjera, vendim nga 20 maji 2021, *Karaxhovski dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut* nr. 27840/16 dhe 13 aplikacione të tjera, vendim nga 20 maji i vitit 2021, *Mitrovska dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 55480/16 dhe 6 aplikacione të tjera, vendim nga 3 qershori 3 i vitit 2021, *Trajkovski dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 54551/16 dhe 7 aplikacione të tjera, vendim nga 17 qershori i vitit 2021 dhe *Mitkovski dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 70176/17 dhe 3 aplikacione të tjera, vendim nga 26 gushti i vitit 2021.

<sup>187</sup> *Jakimovski dhe Transporti Kari kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut* nr. 51599/11, aktgjykim nga 14 nëntori i vitit 2019



ndërsa është shqiptuar edhe masa mbrojtëse sekuestrim i kamionit nga pronari, i cili në rastin konkret është kryerës i kundërvajtjes.

Gjykata vuri në dukje se neni 269 (1) i Ligjit, në bazë të të cilit është mbështetur aktvendimi për sekuestrim, e lejon sekuestrimin e mjetit transportues si masë mbrojtëse kur në mënyrë përmbledhëse përmbushen dy kushte: (i) kriteri i vlerës dhe (ii) kushti subjektiv. Sipas kësaj, sekuestrimi nuk është bërë në mënyrë automatike ndërsa autoritetet vendore është dashur ta vlerësojnë vetëdijen dhe sjelljen e pronarit të mjetit transportues. Në këtë kontekst, gjykatat vendase nuk e kanë marrë parasysh lidhjen midis sjelljes së aplikantëve dhe kundërvajtjes dhe nuk u kanë kushtuar vëmendje argumenteve të aplikantit të parë se kamioni i sekuestruar ka qenë burim i vetëm i të ardhurave për familjen e tij dhe se masa e kontestuar i ka vënë barrë joproporcionale, duke i pasur parasysh rrethanat e lëndës (paragrafi 48 i aktgjykimit).

Gjykata konstatoi se konfiskimi i kamionit është bërë me qëllim që të arrihet efekti i zbrapsjes, e jo për shkak të fitimit të kompensimit material për dëmin e shkaktuar me kundërvajtjen. Së këtejmi, dëshmia nuk ka qenë bindëse se në rrethanat konkrete të rastit, efekti i zbrapsjes nuk do të arrihej me gjobën dhe sekuestrimin e mallit si masë e veçantë kundërvajtëse. Kështu që, sekuestrimi i kamionit, si sanksion plotësues, ka qenë barrë joproporcionale dhe ka paraqitur barrë të tepruar mbi aplikantët (paragrafi 50 i aktgjykimit).

Në analizën e saj sa i përket proporcionalitetit në lëndën *Jakimovski dhe Transporti Kari* (paragrafi 42 i aktgjykimit), Gjykata mbështetet mbi parimet e përgjithshme tanimë të vendosura në lëndën *Vasilevski*.<sup>188</sup> Në këtë kuptim, nënvizohet se “sa i përket balancës (baraspeshës) ndërmjet qëllimit për arritjen e të cilit ekziston synimi dhe të drejtave të aplikantit,... kur sekuestrohen sende të cilat janë përdorur në mënyrë të kundërligjshme, atëherë kjo balancë varet nga më shumë faktorë, të cilët e përfshijnë edhe sjelljen e pronarit. Kështu që, duhet të konstatohet se autoritetet vendore a e kanë marrë parasysh: shkallën e fajit të aplikantit, kujdesin, ose më së paku, raportin midis sjelljes së tij dhe veprës së kryer penale. ...Balanca e nevojshme nuk do të arrihet nëse personi në fjalë ka pasur barrë individuale dhe të tepruar...” (paragrafi 49 në lëndën *Vasilevski*).

## Ekzekutimi i aktgjykimit

Shkelja në rastin konkret është rezultat i disproporcionalitetit të sekuestrimit të mjetit transportues si sanksion plotësues (përveç gjobës që i është shqiptuar aplikantit) me të cilin i është shkaktuar barrë e tepruar. Ajo ka të bëjë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit praktik të ligjit në rastin konkret, por nuk mund të konsiderohet se është shkaktuar nga vet legjislacioni.

Në paragrafin 11 të Planit të veprimit të vetëm deri më tani, që i është dërguar Komitetit

<sup>188</sup> *Vasilevski*, nr. 22653/08, aktgjykim nga 28 prilli i vitit 2016

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

të Ministrave<sup>189</sup>, cthekohet se në përgjigjen e gjetjeve të Gjykatës, më 27 korrik të vitit 2020, Gjykata e Lartë Administrative miratoi konkluzion që ka të bëjë me çështjen e proporcionalitetit gjatë procedimit dhe vendimmarrjes së autoriteteve administrative dhe gjykatave administrative që rezulton nga aktgjykimi *Jakimovski dhe Transporti Kari*.<sup>190</sup> Në të merret qëndrimi se “në rastet kur krahas shqiptimit të gjobës si dënim monetar për kundërvajtjen e kryer është parashikuar masë e veçantë kundërvajtëse – sekuestrim i sendeve të dedikuara për kryerjen e kundërvajtjes, kjo masë e veçantë kundërvajtëse nuk do të zbatohet nëse vlerësohet se qëllimi i dënimit do të arrihej vetëm përmes shqiptimit të dënimit monetar duke i pasur parasysh: peshën e kundërvajtjes, kushtet në të cilat është kryer kundërvajtja, sjelljen e kryerësit të kundërvajtjes dhe raportin e tij ndaj kundërvajtjes së kryer, faktin se kryerësi edhe paraprakisht ka kryer kundërvajtje të ngjashme, si dhe rrethanat e tjera të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me kryerësin dhe të cilat janë të rëndësishme për vlerësimin e asaj nëse masat e veçanta kundërvajtëse do t'i shkaktojnë barrë të tepruar dhe joproporcionale.”<sup>191</sup>

Së këtejmi, është e qartë se kur vendoset për sanksionin e kundërvajtjes, autoritetet administrative duhet t'i marrin parasysh të gjitha rrethanat e specifikuar në konkluzionin e miratuar, i cili në mënyrë të drejtë e adreson thelbin e shkeljes së konstatuar në këtë aktgjykim dhe pa dyshim se nga njëra anë do të kontribuojë për avancimin e praktikës së gjyqësisë administrative në lidhje me shqiptimin e sanksioneve për kundërvajtjet e kryera doganore, dhe nga ana tjetër për respektimin e plotë të parimit të proporcionalitetit të këtyre sanksioneve.

## Përmbledhje

Duhet të theksohet se sa i përket aktgjykimit të lëndës *Jakimovski dhe Transporti Kari*, deri te Agjenti i Qeverisë, është dërguar edhe një aplikacion në lëndën *Transporte Radika SHPK Lubjana*,<sup>192</sup> me ç'rast disa çështje janë vendosur për deklaram, të cilat, mes tjerash, kanë të bëjnë edhe me proporcionalitetin e sekuestrimit të mjetit transportues të kompanisë aplikante, kështu që Gjykata u referohet gjetjeve të saj në lëndën *Jakimovski dhe Transporti Kari*. Kjo lëndë e komunikuar, është tregues për rrezikun nga paraqitja e numrit më të madh të aplikacioneve të ngjashme, nëse nuk reagohej në kohë të duhur në drejtim të parandalimit

<sup>189</sup> 1383rd meeting (29 September – 1 October 2020) (DH), Action Plan (03/09/2020), Communication from North Macedonia concerning the case of *Jakimovski and Kari Prevoz v. North Macedonia* (Application No. 51599/11), DH-DD(2020)778

<sup>190</sup> Në të vërtetë, ky konkluzion është tregues i ndikimit të punës së Komisionit Ndërinstitucional, i cili e ka rekomanduar miratimin e tij (shih: Procesverbalin nga mbledhja e 19-të e Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, të mbajtur më datë 8.7.2020, në dispozicion në: <https://buroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/06/Записник-од-19-тата-седница.pdf>) dhe njëkohësisht është shembull i mirë për qasjen konstruktive të gjyqësorit vendas në procesin e ekzekutimit të aktgjykimeve.

<sup>191</sup> Konkluzioni në lidhje me çështjen juridike sa i përket aktgjykimit të GJEDNJ-së në lëndën *Jakimovski dhe Transporti Kari* është në dispozicion këtu: [http://www.vsrn.mk/wps/portal/vusskopje/sud/vesti/da36041e-1c59-42b7-a557-29ea7eddddbbe/ut/p/z0/jYyxDoIwFEW\\_xYGxeQ8ECmM1xERIUQfsQgpUrGALUID\\_XwB49luc u4BDhlwLSZVC6uMFu28zzMw43vY7TDFXQ8rJAISKNTzBATClvgv4W5oG59zxmw0mgrXxaybixaVeb3xsFhrBzsTCmtFg5OcrDKwUosQ\\_Rd5dwylwvFZSIKDEi6Wgspop5DfsPdJ1WgPvhL0SpS8Gsr-uXcOL95MtPg64dpo/](http://www.vsrn.mk/wps/portal/vusskopje/sud/vesti/da36041e-1c59-42b7-a557-29ea7eddddbbe/ut/p/z0/jYyxDoIwFEW_xYGxeQ8ECmM1xERIUQfsQgpUrGALUID_XwB49luc u4BDhlwLSZVC6uMFu28zzMw43vY7TDFXQ8rJAISKNTzBATClvgv4W5oG59zxmw0mgrXxaybixaVeb3xsFhrBzsTCmtFg5OcrDKwUosQ_Rd5dwylwvFZSIKDEi6Wgspop5DfsPdJ1WgPvhL0SpS8Gsr-uXcOL95MtPg64dpo/).

<sup>192</sup> *TRANSPORTE RADIKA SHPK kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 52003/18, aplikacion i paraqitur më 26 tetor të vitit 2018, ndërsa Qeverisë i është dërguar më 17 nëntor të vitit 2020.

të dukurisë së shkeljeve të ngjashme në nivel kombëtar.

Duhet të monitorohet praktika administrative dhe gjyqësore në përputhje me konkluzionin e miratuar nga Gjykata e Lartë Administrative dhe të detektohen shembujt e procedimit ndryshe në përputhje me konkluzionin, që të vlerësohet efikasiteti i masës për qëllimet e parandalimit të shkeljeve të ngjashme të Konventës në të ardhmen.<sup>193</sup>

## GRUPI I LËNDËVE ANASTASOV<sup>194</sup>

### Gjetjet e GJEDNJ-së

Lënda Anastasov ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së aplikantit për gëzimin paqësor të pronësisë nga neni 1 i Protokollit nr. 1 për shkak të sekuestrimit të automjetit në kontekst të procedurës kundërvajtëse e cila është parashkruar në vitin 2012.

Me fjalë të tjera, duke e zbatuar nenin 267 të Kodit Doganor, autoritetet doganore e sekuestruan automjetin e aplikantit, të cilin ai e ka blerë në Bullgari, dhe njëkohësisht, i kanë shqiptuar dënim monetar (gjobë) në shumë prej 800 euro meqë ka vepruar në kundërshtim me aktet normative doganore, meqë ka pranuar automobil në ruajtje dhe përdorim duke e ditur se nuk janë plotësuar procedurat dhe detyrimet për importin e tij.

Së këtejmi, Gjykata Administrative e miratoi kërkesëpadinë e aplikantit dhe mori vendim për pezullimin e procedurës për shkak të parashkrimit të krijuar për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes, megjithatë, ajo, duke iu referuar dispozitës së nenit 100-a të Kodit Penal i cili parashikon sekuestrim të detyrueshëm automatik të çdo sendi që përdoret gjatë kryerjes së veprës penale ose i cili rezulton nga e njëjta, e ka refuzuar kërkesën e aplikantit që t'i kthehet automobili, duke konstatuar se sekuestrimi i tij është i detyrueshëm, përkatësisht automatik (paragrafët 6 – 8 të aktgjykimit).

<sup>193</sup> Mes tjerash, duhet të theksohet se shteti ka paraqitur kërkesë për rishikimin e aktgjykimit të miratuar nga GJEDNJ-ja pas informacionit të pranuar se aplikanti i dytë nuk ekziston më dhe është shlyer nga Regjistri Qendror (paragrafi 18 i Planit të veprimit).

<sup>194</sup> Në këtë grup bëjnë pjesë dy lëndë, që kanë të bëjnë me tri aplikacione para GJEDNJ-së: *Atanasov*, nr. 46082/14, aktgjykim nga 26 shtatori i vitit 2019 dhe *Anev dhe Najdovski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. dhe aktgjykim nga 3 shtatori i vitit 2020.

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

Në kuadër të analizës së saj, GJEDNJ-ja ka vënë në dukje se pavarësisht faktit që procedura e kundërvajtjes kundër aplikantit është pezulluar, është shqiptuar masa e sekuestrimit të automjetit e cila ka qenë e detyrueshme sipas të drejtës vendore, ndërsa sekuestrimi i këtillë automatik aplikantit e ka privuar nga çdo lloj mundësie që ta argumentojë pozitën e tij dhe të ketë madje edhe gjasa minimale për sukses në procedurën e sekuestrimit, pavarësisht sjelljes së tij ose shkallës së përgjegjësisë (paragrafi 21 i aktgjykimit).

Gjykata konstatoi se sekuestrimi i detyrueshëm automatik i automjetit të aplikantit bashkë me mungesën e mundësisë reale që të marrë kompensim për humbjen e tij (nga personi që e ka sjellë automjetin në shtetin e paditur), aplikantit i shkaktoi barrë të tepruar e cila nuk mund të justifikohet me qëllimin legjitim të cilin e ka ndjekur shteti (paragrafi 23 i aktgjykimit).

Lëndës *Atanasov*, më vonë në grupin e njëjtë, i është bashkëngjitur edhe aktgjykimi i lëndës *Anev dhe Najdovski*, me të cilin zgjidhen dy lëndë të bashkuara në të cilat të dy aplikantët janë shpallur për fajtorë në dy procedura krejtësisht të ndryshme për “transport të drurëve pa vulë dylli përkatëse ose pa fletëdërgesë”, kundërvajtje e parashkruar në nenin 104 paragrafi 1 pika 11 të Ligjit për Pyjet, me ç’rast të dy aplikantëve u është shqiptuar gjobë në shumë prej 3.000 euro (për aplikantit e parë), përkatësisht 2.400 euro (për aplikantit e dytë). Njëkohësisht, me aktgjykimin e njëjtë atyre u është konfiskuar kamioni dhe drurët në përputhje me nenin 104 paragrafi 3 të Ligjit për Pyjet dhe nenin 105 të Ligjit për Kundërvajtje (paragrafi 4 dhe paragrafi 9 të aktgjykimit).

Në këtë aktgjykim, GJEDNJ-ja vuri në dukje se ndonëse sekuestrimi i këtillë i detyrueshëm automatik i kamionëve të aplikantëve ka qenë i ligjshëm dhe i bazuar mbi dispozitat e lartpërmendura ligjore (nga Ligji për Pyjet, Ligji për Kundërvajtje, përkatësisht KP-ja) me ç’rast është justifikuar me qëllimin legjitim të parandalimit të krimit (paragrafi 23), megjithatë, kjo gjë aplikantët i ka privuar nga mundësia t’i argumentojnë pozicionet e tyre dhe të kenë madje edhe gjasa minimale për sukses në procedurat të cilat kanë rezultuar me sekuestrim, pavarësisht sjelljes së tyre ose shkallës së përgjegjësisë (paragrafi 25). Gjykata është e mendimit se në mënyrë bindëse nuk është dëshmuar se në rrethanat e rastit, sanksionet e këtilla nuk janë të mjaftueshme që ta arrijnë efektin e dëshiruar të zbrapsjes dhe parandalimit të kryerjes së kundërvajtjeve të ngjashme në të ardhmen, ndërsa si edhe në aktgjykimin *Jakimovski dhe Transporti Kari*, masa e shqiptuar për sekuestrimin e kamionëve, si sanksion plotësues, ka qenë joproporcionale, ndërsa aplikantëve u ka shkaktuar barrë të tepruar individuale (paragrafi 27 i aktgjykimit).

## Ekzekutimi i aktgjykimeve<sup>195</sup>

Padyshim se shkelja në këto lëndë rezulton nga dispozita e nenit 100-a të KP-së, e cila parashikon sekuestrim të detyrueshëm dhe automatik të çdo sendi që përdoret gjatë kryerjes së veprës penale, pavarësisht sjelljes ose shkallës së përgjegjësisë së pronarit të tij.

Pikërisht për këtë shkak, në Planin e veprimit të paraqitur theksohet se si përgjigje ndaj aktgjykimit të Gjykatës, në gjysmën e dytë të vitit 2019 në Ministrinë e Drejtësisë u formua grupi i punës i cili duhet ta përgatisë Kodin e ri Penal, i cili e ka shqyrtuar edhe mundësinë e ndryshimit të nenit 100-a të KP-së.<sup>196</sup> Ndryshimi i kësaj dispozite është në drejtim të sigurimit se kur vendosin për sekuestrimin e sendeve, gjykatat vendase duhet të mbajnë llogari për parimin e proporcionalitetit, së këtejmi, duke e pasur parasysh natyrën dhe rëndësinë e veprës penale, dënimin e shqiptuar dhe karakteristikat personale të personit i cili e ka kryer veprën penale apo të personit të tretë.<sup>197</sup>

Edhe pse miratimi i këtyre ndryshimeve është i pasigurt, siç u theksua paraprakisht, mund të pritet që ndryshimet e Kodit Penal të cilat do t'i inkuorpojnë dispozitat e lartpërmendura, mund të miratohen deri në fund të vitit 2021.<sup>198</sup> Me sa duket, në ndërkohë, ka paralajmërime të caktuara të cilat flasin për mundësinë që këto ndryshime të miratohen në kornizën e planifikuar kohore, veçanërisht duke pasur parasysh se propozim-ndryshimet janë publikuar dhe janë në dispozicion për publikun profesional dhe për opinionin e gjerë që në mars të vitit 2021,<sup>199</sup> Qeveria të njëjtat i miratoi më datë 27 korrik 2021, ndërsa më 18 gusht të vitit 2021, i paraqiti për lexim të parë në procedurë parlamentare.

Thënë shkurtimisht, ndryshimet e propozuara të KP-së justifikohen me nevojën e harmonizimit të dispozitave të tij me instrumentet ndërkombëtare (duke e përfshirë edhe fushën e konfiskimit), si dhe për shkak të ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së me të cilat konstatohet shkelja e Konventës gjatë sekuestrimit të sendeve, përkatësisht moszbatimit të parimit të proporcionalitetit gjatë zbatimit të këtij instituti nga ana e gjykatave. Në këtë kuptim, ndërhyrjet bëhen në dispozitat përkatëse të ligjit, me të cilat përcaktohet zbatimi i detyrueshëm i parimit të proporcionalitetit gjatë sekuestrimit të lëndëve, kështu që vetëm në raste të jashtëzakonshme limitohet përcaktimi i dispozitave për sekuestrimin e detyrueshëm të sendeve në procedurën penale.<sup>200</sup>

<sup>195</sup> Informacionet të cilat i trajton kjo Analizë bazohen në Planin e veprimit të cilin shteti ia ka dërguar Komitetit të Ministrave, i cili kryesisht ka të bëjë me ekzekutimin e aktgjykimit të lëndës kryesore nga grupi i lëndëve *Atanasov*, me ç'rast Plani, në aspektin kohor i ka paraprirë aktgjykimit *Anev dhe Najdovski*, Shih: 1377th meeting (June 2020) (DH), Action Plan (27/05/2020), Communication from North Macedonia concerning the case of *Anastasov v. North Macedonia* (Application No. 46082/14), DH-DD(2020)467

<sup>196</sup> Paragrafi 9 i Planit të veprimit

<sup>197</sup> Paragrafi 10 i Planit të veprimit

<sup>198</sup> Paragrafi 11 i Planit të veprimit

<sup>199</sup> Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal nga 27 korriku i vitit 2021, në dispozicion në: [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=61439](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=61439)

<sup>200</sup> Shih: Draft-Raportin për vlerësimin e ndikimit të legjislacionit – Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal nga 2 marsi i vitit 2021, në dispozicion në: [https://ener.gov.mk/files/propisi\\_files/plan/1\\_129921631302032021%201.pdf](https://ener.gov.mk/files/propisi_files/plan/1_129921631302032021%201.pdf)

## II. ANALIZA E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE NË MBIKËQYRJE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE

Nga ana tjetër, vihet në dukje se ndërhyrja kryesore në lidhje me nenin 100-a ka të bëjë me inkuorporimin e parimit të proporcionalitetit përmes dispozitës në paragrafin 4 të këtij neni si vijon: “Gjatë miratimit të vendimit për sekuestrimin e sendeve që janë përdorur ose janë dedikuar për kryerjen e veprës penale, Gjykata në mënyrë të veçantë do të mbajë llogari për parimin e proporcionalitetit duke e pasur në konsideratë: llojin dhe peshën e veprës penale, dënimin e shqiptuar, mundësitë personale të kryerësit ose të personit të tretë, si dhe rrethanat e tjera në lidhje me mënyrën e kryerjes së veprës dhe pasojat e saj.”

### Përmbledhje

Përveç aktgjykimit për lëndën *Atanasov*, Komiteti i Ministrave, me miratimin e rezolutave përfundimtare, e mbyllim brikëqyrjen mbi ekzekutimin e lëndëve *Vasilevski*<sup>201</sup> dhe *Andonoski*<sup>202</sup>, të cilat kanë prekur çështje të ngjashme juridike.<sup>203</sup> Në të gjitha këto raste, problematik ka qenë respektimi i proporcionalitetit gjatë zbatimit automatik të dispozitave ligjore për sekuestrimin e sendeve, me ç'rast është bërë një veprim i caktuar i kundërligjshëm, kështu që baza ligjore në lëndën *Vasilevski* dhe *Andonoski* ka qenë tek KP-ja, ndërsa në lëndën *Anev* dhe *Najdovski* tek Ligji për Kundërvajtje.

Së këtejmi, nënkuptohet se si masë e përgjithshme e karakterit legjislativ, të cilën shteti e ka theksuar në raportet e veprimit të tij në lëndët *Vasilevski* dhe *Andonoski* paraqiten ndryshimet në dispozitat përkatëse të KP-së, të cilat janë fokusuar drejt shmangies së qasjes automatike gjatë zbatimit të masës së konfiskimit, përkatësisht masës së proporcionalitetit,

<sup>201</sup> Resolution CM/ResDH(2017)145, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights *Vasilevski* against “the former Yugoslav Republic of Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 10 May 2017 at the 1286th meeting of the Ministers’ Deputies)

<sup>202</sup> Resolution CM/ResDH(2019)301, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights *Andonoski* against North Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 13 November 2019 at the 1360th meeting of the Ministers’ Deputies)

<sup>203</sup> Edhe në lëndën *Vasilevski* dhe *Andonoski* bëhet fjalë për sekuestrimin e automjeteve në pronësi të aplikantëve të cilat kanë shërbyer si mjete për kryerjen e veprës penale. Më konkretisht, në lëndën *Vasilevski*, aplikantit i është sekuestruar kamioni me të cilin është bërë kontrabandë me sheqer nga ana e një personi tjetër, përgjegjësia penale e të cilit u konstatua në procedurën përkatëse penale. Shkelja ka të bëjë me atë se sekuestrimi është bërë tre vjet pas urdhrit gjyqësor të formës së prerë për sekuestrim dhe tetë vjet pas kryerjes së veprës penale, ndërsa aplikanti nuk e ka ditur dhe as që ka pasur mundësi ta dijë se për çfarë dedikimi është përdorur kamioni, nuk kanë ekzistuar motive për të pasur frikë se kamioni përsëri mund të përdoret për kryerjen e veprës penale, ndërsa gjykatat vendase nuk e kanë vlerësuar në nivel të mjaftueshëm rrethanën se aplikanti, si transportues i mallrave, ka fituar para për jetesë pikërisht nga përdorimi i automjetit të sekuestruar. Nga ana tjetër, Gjykata në aktgjykim, është përqendruar edhe mbi barrën e tepruar që do t'i vihej aplikantit përmes pritshmërisë që të kërkojë dëmshpërbllim nga shitësi i kamionit, i cili është kryerësi i veprës, veçanërisht duke e pasur parasysh atë se ai në ndërkohë ndërroi jetë. Në lëndën *Andonoski*, shkelja është bërë meqë sekuestrimi i automobilit me të cilin është kryer vepra penale – kontrabandë me emigrantë, bazohet në KP, i cili parashikon sekuestrim automatik të çdo automjeti me të cilin është kryer vepër e këtyllë penale, pavarësisht nëse kryerësi është pronari apo ndonjë person tjetër, kështu që sekuestrimi ka shërbyer si qëllim legjitim – parandalim të migracionit ilegal dhe trafikimit me qenie njerëzore, por një gjë e këtyllë nuk ka qenë proporcionale dhe i ka shkakuar aplikantit barrë të tepruar sepse automjeti i sekuestruar ka qenë mjete kryesor për kryerjen e veprimtarisë së taksisë dhe për realizimin e të ardhurave të aplikantit, kështu që nga sjellja e tij nuk kanë mundur të konkludojnë se ky automjet, në të ardhmen, mund të shërbejë për kryerjen e veprës penale.

varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret.<sup>204</sup>

Për shkak të sigurimit të aspektit integral të masave të ndërmarra legislative për ekzekutimin e aktgjykimeve nga grupi i lëndëve *Atanasov*, do të ishte e pëlqyeshme që sa më shpejt të miratohen ndryshimet e propozuara ligjore në nenin 100-a të KP-së, të cilat mund të kenë rëndësi thelbësore në drejtim të parandalimit të shkeljeve të ngjashme në të ardhmen, si ato të cilat tanimë janë konstatuar në dy aktgjykime të cilat janë pjesë të këtij grupi të lëndëve. Duke pasur parasysh se ato, tani për tani, janë në nivel të mocionit dhe nuk janë përfshirë në Planin e veprimit inicial të dorëzuar nga shteti, rekomandohet që pas miratimit të tyre nga ana e ligjvënësit, në mënyrë adekuate të sanksionohen edhe në Planin e veprimit të radhës ose në Raportin e veprimit të radhës.

Këto ndryshime janë po aq relevante edhe për grupin e lëndëve *Atanasov*, meqë edhe Ligji për Kundërvajtje<sup>205</sup>, i cili është zbatuar për një pjesë të lëndëve, ekzekutimi i të cilave tani është objekt i mbikëqyrjes, në masë të caktuar i referohet zbatimit të dispozitave përkatëse të KP-së. Për shembull, në nenin 41, paragrafi 1 përcaktohet se “për pronë të konfiskuar dhe dobi pronësore të fituar me kundërvajtje të personit fizik, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore dhe sekuestrimin e sendeve nga neni 97 deri në nenin 100-a të Kodit Penal”, ndërsa në paragrafin 3 përcaktohet se “për sekuestrimin e sendeve në mënyrë përkatëse zbatohet dispozita e kushteve për sekuestrimin e sendeve nga neni 100-a i Kodit Penal”.

Përveç kësaj, në raportimin e radhës para Komitetit të Ministrave në lidhje me të gjitha këto lëndë në të cilat është gjetur shkelja e të drejtës së pronësisë nga neni 1 i Protokollit nr. 1 ndaj KEDNJ-së, dhe ku një gjë e këtu është e aplikueshme, shteti do të duhej të fokusohet edhe në zgjidhjet që i ofron Ligji i ri për Kundërvajtje nga viti 2019.<sup>206</sup> Veçanërisht janë të rëndësishme normat referuese të nenit 40 të këtij ligji, të cilat mes tjerash, parashikojnë se për pronën e konfiskuar dhe dobinë pronësore, të fituara përmes kundërvajtjes së personit fizik, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore dhe sekuestrimin e sendeve nga KP-ja; për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore, të fituar me kundërvajtje të personit juridik, në mënyrë përkatëse zbatohet dispozita për llojet e dënimeve të personit fizik nga KP-ja, si dhe gjatë sekuestrimit të sendeve, Gjykata, përkatësisht autoriteti për kundërvajtje, në mënyrë përkatëse i zbatojnë dispozitat e kushteve për sekuestrimin e sendeve nga KP-ja.

<sup>204</sup> Për më shumë detaje, shih paragrafët 24 dhe 57 të aktgjykimit, si dhe paragrafin 10 të Raportit të veprimit për lëndën *Vasilevski*: 1288th meeting (June 2017) (DH), Action report (27/02/2017), Communication from “the former Yugoslav Republic of Macedonia” concerning the case of *VASILEVSKI v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia”* (Application No. 22653/08), DH-DD(2017)292; paragrafët 12 – 15 të Raportit të veprimit për lëndën *Andonoski*: 1362nd meeting (December 2019) (DH), Action report (10/10/2019), Communication from North Macedonia concerning the case of *ANDONOSKI v. North Macedonia* (Application No. 16225/08), DH-DD(2019)1146

<sup>205</sup> “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/06, 51/11

<sup>206</sup> Ligji për Kundërvajtje (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96 nga 17 maji i vitit 2019)

### III. PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE

Përmes kësaj Analize jepet një pasqyrë e statusit të ekzekutimit të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, të miratuara në lëndët kundër RMV-së, të cilat akoma janë në mbikëqyrje të Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës, perceptuar përmes prizmit të ndërmarrjes së masave të përgjithshme për ekzekutim.

Pavarësisht ngecjeve evidente gjatë ekzekutimit të lëndëve të veçanta (dhe të grupeve të lëndëve), duhet të theksohet se shteti ia doli ta zë hapin me afatet dhe rregullat procedurale të Komitetit të Ministrave dhe në masë të madhe me efikasitet t’u përgjigjet nevojave të raportimit në kohë të duhur, të përditësuar dhe përkatës, në lidhje me rrjedhën e proceseve në nivel kombëtar dhe me sfidat e ardhshme.

Për dallim nga e kaluara, kur ka pasur prolongime të caktuara sa i përket raportimit inicial, viteve të fundit, shteti përmes Byrosë së Përfaqësimit, ka tendencë të bëjë grumbullimin e të gjitha informacioneve dhe të dhënave të nevojshme dhe atyre që janë në dispozicion dhe përfshirjen e tyre në Planin e parë iniciues të veprimit për ekzekutim brenda afatit të caktuar prej 6 (gjashtë) muaj nga dita kur një aktgjykim i caktuar është bërë përfundimtar. Njëkohësisht, në intervale të caktuara kohore ai e përmbush detyrimin e “begatimit” ose “rifreskimit” të informacioneve lidhur me progresin eventual të cilat iu dërguan KM-së, që flet për një qasje serioze dhe të përgjegjshme, për një përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm, të tij në këtë drejtim.

Marrë në përgjithësi, shteti shënon progres në procesin e ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së, edhe pse ai ka dinamikë dhe intensitet të ndryshëm kur bëhet fjalë për aktgjykimet e ndryshme, varësisht nga lloji dhe përfshirja e masave të cilat i iniciojnë në mënyrë që të sigurohet përgjigje përkatëse ndaj shkeljeve të konstatuara të lirive dhe të drejtave nga Konventa. Kështu që, periodikisht, krahas kalimit të periudhës së konsiderueshme kohore (veçanërisht tek lëndët më të vjetra, të cilat një kohë të gjatë presin në arkivat e Komitetit të Ministrave), ato akoma janë të pa ekzekutuara. Kjo kryesisht ka të bëjë me faktin se bëhet fjalë për lëndë, ekzekutimi i të cilave qysh më herët ndërlidhet me ndërhyrje të caktuara sistematike të ndjeshme ose komplekse në kuadrin ligjor, praktikën gjyqësore dhe institucionale, të cilat shteti në tërësi akoma nuk ia ka dalë t’i zbatojë. Së këtejmi, nënkuptohet pse ndonjëherë Byroja e Përfaqësimit para GJEDNJ-së nuk ka në dispozicion, jo me fajin e saj, informacione të mjaftueshme të reja, të cilat do t’ia komunikojë KM-së, përmes adresimit të versionit të përditësuar të Planit të veprimit apo Raportit të veprimit. Këtu, përsëri vjen në shprehje nevoja e sjelljes proaktive të të gjithë faktorëve të interesuar, madje edhe pa ndërhyrjen e Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së.

Për këto shkaqe, kjo Analizë e vë në dukje nevojën e ndryshimeve emergjente ose të shpejta ligjore në lidhje me disa lëndë dhe grupe të lëndëve në të cilat mungon reagimi esencial, kryesisht nga ligjvënësi, por edhe nga institucionet e tjera të përfshira sa i përket periudhës kohore. Njëherësh, kah fundi i shqyrtimit të secilës lëndë ose secilit grup të lëndëve në të cilat janë ndërmarrë një sërë masash, megjithatë mungojnë disa hapa të vegjël, por të



rëndësishëm drejt rrumbullakimit të aktiviteteve të shtetit, në drejtim të implementimit të tyre, dhe autoriteteve kompetente u jepet mesazh inkurajues që sa më shpejtë t'i qasen finalizimit të këtij procesi.

Nënkuptohej se me mbylljen e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e lëndëve të caktuara nuk duhet të përfundojnë impenjimet e shtetit për implementimin efektiv kombëtar të Konventës dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së në rendin juridik vendas meqë me mbylljen e ekzekutimit, përfundimisht nuk u vihet fund shkeljeve. Me fjalë të tjera, shpeshherë mbetet e hapur çështja nëse dhe kur do të paraqiten shkelje të njëjta të Konventës, si ato që janë konstatuar në lëndët e mbyllura para Komitetit të Ministrave.

Së këtejmi, do të ishte e pëlqyeshme **shteti të hartojë një strategji për monitorimin periodik të ndikimit dhe efektit afatgjatë të masave të përgjithshme të ndërmarra në kontekstin e lëndëve tanimë të mbyllura lidhur me parandalimin e shkeljeve të ardhshme të Konventës pas mbylljes së lëndëve konkrete**, me qëllim që në kohë të duhur të shmangen “njëanshmëritë” e mundshme sa i përket mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të zgjidhjeve ligjore, ose sa i përket metodologjisë së veprimit dhe praktikës së gjyqësorit dhe autoriteteve administrative për të cilat do të konstatohet se nuk korrespondojnë me Konventën dhe praktikën e Strasburgut.

Për më tepër, shteti mund të shkojë një hap para sa i përket zbatimit të standardeve evropiane për të drejtat e njeriut dhe **përmes monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimit të praktikës së GJEDNJ-së, si dhe përmes shmangies përkatëse dhe në kohë të duhur të mangësive në legjislacionin dhe praktikën vendore, t'i parashohë dhe t'i parandalojë shkeljet e mundshme të ardhshme të Konventës**, para se të njëjtat të paraqiten dhe të bëhen shkas për paraqitjen e aplikacionit individual kundër shtetit para GJEDNJ-së.

Një element tjetër primar konsiston me atë që **shteti përmes edukimit të fuqizuar (në kuadër të arsimit të lartë juridik formal, si dhe në nivel të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë) dhe përmes fuqizimit të vazhdueshëm të ndërgjegjësimit të të gjitha subjekteve relevante që te ato të zhvillohet ndjenja e përgjegjësisë, rolit dhe kontributit të tyre sa i përket zbatimit të vazhdueshëm përkatës dhe të drejtë të Konventës** lidhur me hartimin dhe miratimin e projekteve ligjore, në procesin e ndarjes dhe miratimit të drejtë të vendimeve gjyqësore, si sa i përket zhvillimit të procedurave administrative para autoriteteve administrative ashtu edhe gjatë miratimit të akteve të veçanta administrative me të cilat preken disa liri dhe të drejta të caktuara. Për më tepër, duhet të fuqizohet edhe angazhimi i AGJPP-së, e cila në mënyrë akoma më efikase duhet ta kryejë funksionin e saj edukativ përmes organizimit të trajnimeve dhe punëtorive të specializuara në tema konkrete në lidhje me standardet dhe praktikën e GJEDNJ-së, dhe veçanërisht si shoqëruese e të gjitha veprimeve të planifikuara ose rrjedhave të ndërmarra si pjesë e implementimit të masave të përgjithshme për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së të miratuara kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut. Edhe pse një gjë e këtillë në mënyrë eksplicite nuk është potencuar në tabelën në vijim, megjithatë aktivitetet e AGJPP-së në kontekst të avancimit të njohjes dhe zbatimit të standardeve të GJEDNJ-së, duhet të konsiderohen si masë e përgjithshme permanente për ekzekutimin e aktgjykimeve të Gjykatës, efekti i së cilës mund të matet vetëm pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore.

Në fund, duhet përsëri ta theksojmë nevojën, veçanërisht gjatë implementimit të masave të përgjithshme të aktgjykimeve të GJEDNJ-së, për veprim të bashkërenditur, sensibilizim të çështjes dhe mirëkuptim nga të gjithë faktorët relevantë në RMV, përkatësisht nga profesionistët juridikë në përgjithësi, me qëllim të arritjes së efekteve të dëshiruara, si rezultat i përpjekjeve dhe përkushtimit të përbashkët mbi sundimin e të drejtës në shtet.

**ANEKS: PASQYRA TABELORE E STATUSIT TË EKZEKUTIMIT TË LËNDËVE TË VEÇANTA DHE GRUPEVE TË LËNDËVE PËRA KOMITETIT TË MINISTRAVE ME UDHËZIME PËR NDËRMARRJEN E MASAVE TË ARDHSHEME TË NEVOJSHME DHE TË PËRGJITHSHME NGA SUBJEKTET RELEVANTE**

Lënda/ Grupi i lëndëve	Lloji i shkeljes	Masat e ndërmarra të përgjithshme për ekzekutim	Udhëzime për ndërmarrjen e masave të domosdoshme të ardhshme për ekzekutim	Subjektet / institucionet relevante të cilave u referohen udhëzimet
GRUPI I LËNDËVE KITANOVSKI DHE HAJRULLAHU	Neni 3 i KEDNJ-së (ndalimi i trajtimit mizor) aspekti material dhe i procesit	Inkorporimi i Mekanizmit parandalues kombëtar (MPK) dhe zgjerimi i kompetencave të Avokatit të Popullit  U publikuan procedura të reja standarde operative të MPB-së për trajtimin e personave të privuar nga liria  U formua seksioni i veçantë në kuadër të Prokurorisë Publike  U formua seksioni i veçantë në kuadër të Gjykatës Themelore Penale Shkup  U vendos mekanizëm i jashtëm për kontrollin e punës së policisë	Të fuqizohen kapacitetet e MPK-së në mënyrë që ai plotësisht t'i përgjigjet mandatit të tij në përputhje me kërkesat e OPKAT-it  Të monitorohet dhe të sigurohet zbatimi i tyre konsekuent  Të gjendet zgjidhje për ato lëndë të cilat përmbajnë pretendime për torturë, ndërsa nuk kanë kaluar në kompetencë të seksionit të veçantë  Të monitorohet veprimi dhe performanca e tij  Të monitorohet veprimi dhe performanca e tij  Të sigurohet funksionimi pa pengesa i mekanizmit qytetar për kontroll mbi punën e policisë, përmes zgjedhjes emergjente të anëtarëve të tij  Të vazhdohet kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të mekanizmit qytetar përmes ndryshimeve ligjore  Të monitorohet zbatimi i këtyre instruksioneve në nivel të prokurorëve publikë	MPK-ja, Avokati i Popullit  MPB-ja  Prokuroria Publike  Prokuroria Publike  Gjykata Themelore Penale Shkup Kuvendi  Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi  Prokuroria Publike
	Neni 6 i KEDNJ-së (e drejta e gjykimin të drejtë) – përdorimi i provave të siguruara përmes torturës në procedurë gjyqësore	Është propozuar rishikimi i neneve 142 dhe 143 të KP-së dhe shmangia e institutit të parashkrimit në KP në përputhje me rekomandimet e hartuara nga ekspertët e Këshillit të Evropës  Ndryshimi i praktikës nga ana e gjyqtarëve të cilët punojnë në materien penale	Të miratohen ndryshimet e propozuara në KP  Të monitorohet praktika gjyqësore	Grupi i punës pranë Ministrisë së Drejtësisë, Qeveria, Kuvendi  Gjyqtarë të cilët punojnë në materien penale

L. R.	Neni 3 i KEDNJ-së (ndalimi i trajtimit mizor) – aspekti material dhe i procesit	Deinstitucionalizimi, për të cilin baza juridike është Ligji i ri për Mbrojtje Sociale nga viti 2019 dhe Rregullorja për mënyrën dhe vëllimin e shërbimeve sociale, normativat dhe standardet për dhënien e shërbimeve sociale jetesë me mbështetje  Është propozuar rishikimi i neneve 142 dhe 143 të KP-së dhe shmangia e institutit të parashkrimit në KP në përputhje me rekomandimet e hartuara nga ekspertët e Këshillit të Evropës	Të monitorohet progresi i reformës  Të bëhen ndryshime sistematike gjatë veprimit të prokurorisë ndaj pretendimeve për trajtim joadekuat të personave në institucione të llojit të mbyllur  Të miratohen ndryshimet e propozuara në KP	MPPS-ja  Prokuroria Publike  Grupi i punës pranë Ministrisë së Drejtësisë, Qeveria, Kuvendi
GRUPI I LËNDËVE VASILKOSKI DHE TË TJERËT	Neni 5 paragrafi 3 i KEDNJ-së (e drejta e lirisë dhe sigurisë) – arsyetim i pamjaftueshëm për aktvendimet e paraburgimit  Në lëndën <i>Milladinov dhe të tjerët</i> – neni 5 paragrafi 4 i KEDNJ-së – mosrespektimi i parimit të barazisë së armëve në procedurën e vazhdimin të paraburgimit	Rishikimi i nenit 167 paragrafi 2 të LPP-së në drejtim të sigurimit të arsyetimit të mjaftueshëm për aktvendimet e paraburgimit  Harmonizimi i praktikës vendore me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në drejtim të sigurimit të arsyetimit të mjaftueshëm për aktvendimet e paraburgimit  U miratua konkluzioni në nivel të gjykatave të apelit në tetor të vitit 2015	Të monitorohet zbatimi i këtyre dispozitave ligjore  Të monitorohet zhvillimi i praktikës gjyqësore në drejtim të harmonizimit të mëtutjeshëm të praktikës vendore me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe të sigurohet grumbullimi i sistematizuar dhe publikimi i të dhënave nga praktika e gjykatave  Të iniciohen dhe të monitorohen ndryshimet në praktikën e prokurorive, si dhe të sigurohet grumbullimi i sistematizuar dhe publikimi i të dhënave nga praktika e prokurorive  Të monitorohet implementimi i këtij konkluzioni në drejtim të harmonizimit të mëtutjeshëm të praktikës vendase me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së	Ministria e Drejtësisë - Gjyqësori  Gjyqësori  Prokuroria Publike  Gjyqësori
GRUPI I LËNDËVE NASTESKA	Neni 6 i KEDNJ-së (e drejta e gjykimin të drejtë) – mosrespektimi i parimit të barazisë së armëve në procedurat penale në të cilat është siguruar vetëm prezenca e prokurorit publik, por jo edhe e të pandehurit, në seancat e Gjykatës së Apelit, përkatësisht Gjykatës Supreme	Ndryshime në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme	Të miratohet qëndrimi parimor ose opinioni parimor juridik i Gjykatës Supreme, përkatësisht konkluzioni nga katër gjykatat e apelit  Të hartohen dhe të miratohen zgjidhje përkatëse ligjore në LPP-në e re në drejtim të sigurimit të parimit të barazisë së armëve përmes shmangies së pabarazisë ligjore, përkatësisht trajtimit të privilegjuar të prokurorit publik sa i përket prezencës së tyre në seancat e gjykatave të apelit, përkatësisht në seancat e Gjykatës Supreme	Gjykata Supreme, përkatësisht gjykatat e apelit  Grupi i punës pranë Ministrisë së Drejtësisë, Qeveria, Kuvendi

<p><b>GRUPI I LËNDËVE ATANASOV (NR. 2)</b></p>	<p>Neni 6 paragrafi 1 pika g e KEDNJ-së (e drejta e gjykimit të drejtë) – mospasja mundësi e prokurorisë për seancë dëgjimore me dëshmitarët, përkatësisht refuzimi nga gjykata që të thirren dëshmitarët e propozuar në mbrojtjen e tyre</p> <p>Neni 6 i KEDNJ-së (e drejta e gjykimit të drejtë) – parimi i transparencës – vetëm në lëndën Boshkoski</p>	<p>Në nenin 231 paragrafi 2 dhe nenin 400 paragrafi 1 të LPP-së nga viti 2010, u inkorporua dispozitë sipas së cilës aktgjykimi nuk mund të mbështetet vetëm mbi deklarinim e dëshmitarit të rrezikuar ("rregulli i provës së vetme")</p>	<p>Të hartohen dhe të miratohen zgjidhje përkatëse ligjore në LPP-në e re me të cilat do të përcaktohet se aktgjykimi dënues/me fajësi nuk mund të bazohet në masë vendimtare mbi dëshminë që e ka dhënë dëshmitari i rrezikuar ("rregulli i provës vendimtare")</p> <p>Të bëhen ndryshime përkatëse në praktikën gjyqësore të cilat nënkuptojnë zbatim të plotë të "rregullit të provës së vetme dhe vendimtare"</p> <p>Aktivitetet edukative dhe shqyrtimi i kornizës ligjore</p>	<p>Grupi i punës pranë Ministrisë së Drejtësisë, Qeveria, Kuvendi</p> <p>Gjyqësori</p> <p>Ministria e Drejtësisë – (grupi i punës për LPP), AGJPP-ja</p>
<p><b>GRUPI I LËNDËVE MITOVI</b></p>	<p>Neni 8 i KEDNJ-së (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare) në kombinim me nenin 13 të KEDNJ-së (e drejta e mjetit efektiv juridik) – pamundësimi i takimeve të prindërve dhe fëmijëve të cilët nuk jetojnë bashkë, si dhe moskëzimi i mekanizmit efikas juridik për ekzekutimin e aktvendimeve për takime të miratuara nga qendrat për punë sociale</p>	<p>Janë bërë ndryshime në LPPA me të cilat përcaktohet kompetenca e ekzekutimit të aktvendimeve të qendrave për punë sociale për takim me fëmijët</p> <p>Analiza e hartuar nga ekspertë të Këshillit të Evropës, me kërkesë të shtetit, i cili e bën vlerësimin e gjendjeve dhe jep rekomandime për avancimin e legjislacionit dhe praktikës kombëtare</p>	<p>Të monitorohet zbatimi i zgjidhjeve përkatëse ligjore në LPPA</p> <p>Të hartohen dhe të miratohen ndryshimet e domosdoshme në Ligjin për Familjen në drejtim të sigurimit të realizimit më efikas të të drejtave të prindërve</p> <p>Të fuqizohen kapacitetet e qendrave për punë sociale dhe të reformohet mënyra e veprimit dhe vendimmarrjes së tyre</p>	<p>MPPS-ja, Ministria e Drejtësisë</p> <p>MPPS-ja, Qeveria, Kuvendi</p> <p>MPPS-ja, qendrat për punë sociale</p>
<p><b>X.</b></p>	<p>Neni 8 i KEDNJ-së (e drejta e respektimit të privatësisë dhe jetës familjare) – mungesa e procedurave të shpejta, transparente dhe të qasshme për njohjen e identitetit gjinor të personave transgjinorë</p>	<p>Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Evidencën Amë, i hartuar me ekspertizë të Këshillit të Evropës, i miratuar nga Qeveria dhe i paraqitur në Kuvend</p> <p>U dërgua rekomandim nga Agjenti i Qeverisë deri te Komisioni Shtetëror i Shkallës së Dytë, Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative që t'i respektojnë sugjerimet e GJEDNJ-së në lëndë të ngjashme</p>	<p>Të iniciohet miratimi i Propozim-ligjit të ri</p> <p>Të fuqizohen kapacitetet e Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë dhe të rritet vetëdija tek të punësuarit e saj për zbatimin e drejtë të zgjidhjeve të reja ligjore</p>	<p>Qeveria, Kuvendi</p> <p>Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë</p>

<p><b>TRAJKOVSKI DHE ÇIPOVSKI</b></p>	<p>Neni 8 i KEDNJ-së (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare) – ruajtja pa kufizim e mostrave të ADN-së të marra në kuadër të procedurës penale</p>	<p>U miratua Ligji i ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në fuqi nga muaji shkurt i vitit 2020)</p> <p>U hartua Ligji për Mbrojtjen e Personave Fizikë në Lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Parandalimit, Hetimit, Zbulimit ose Ndjekjes së Veprave Penale apo për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale</p> <p>Hartimi dhe miratimi i Ligjit të ri për polici nga ana e Qeverisë dhe paraqitja e tij në Kuvend</p> <p>U nënshkrua Protokollin me të cilin ndryshohet Konventa për Mbrojtjen e Individëve sa i përket përpunimit automatik të të dhënave personale</p>	<p>Të fuqizohen kapacitetet e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të organeve dhe autoriteteve të tjera kompetente për zbatimin e drejtë të LMDHP-së dhe të monitorohet zbatimi i tij praktikë</p> <p>Të iniciohet miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Personave Fizikë në Lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Parandalimit, Hetimit, Zbulimit ose Ndjekjes së Veprave Penale apo për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale</p> <p>Të iniciohet miratimi i Ligjit të ri për Policinë</p> <p>Të iniciohet miratimi i akteve të nevojshme nënligjore, si dhe të bëhet harmonizimi i ndërsjellë i ligjeve dhe i akteve nënligjore përkatëse</p> <p>Të iniciohet ratifikimi i Protokollit në Kuvend</p>	<p>Qeveria, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</p> <p>Qeveria, Kuvendi</p> <p>Qeveria, Kuvendi</p> <p>Qeveria, Kuvendi</p> <p>Kuvendi</p>
<p><b>GRUPI I LËNDËVE "KRYEPESHKOPATA ORTODOKSE E OHRIT (KOO)"</b></p>	<p>Neni 11 i KEDNJ-së (liria e tubimit dhe bashkimit) në kontekst të nenit 9 të KEDNJ-së (e drejta e lirisë së mendimit, vetëdijes dhe fesë) – refuzimi i regjistrimit të bashkësive fetare për shkaqe formale</p>		<p>Të bëhen ndryshimet e nevojshme gjatë veprimit të gjyqtarëve të gjykatave të regjistrimit dhe Gjykatës Kushtetuese</p>	<p>Gjykatat e regjistrimit dhe Gjykata Kushtetuese</p>
<p><b>GRUPI I LËNDËVE STREZOVSKI DHE TË TJERËT</b></p>	<p>Neni 1 i Protokollit nr. 1 ndaj KEDNJ-së (mbrojtja e pronësisë) – detyrimi i imponuar për pagesën e kompensimit për fuqi të angazhuar, si pjesë fikse e kompensimit të energjisë termike për banesat e shlyçura nga sistemi i ngrohjes qendrore</p>	<p>U miratuan më shumë ndryshime në Rregullat për furnizimin me energji termike</p>	<p>Rishikimi i vazhdueshëm i Rregullave për furnizimin me energji termike dhe ndryshimi eventual i tyre për qasje të individualizuar e të fuqizuar, në përputhje me pikëpamjet e GJEDNJ-së</p> <p>Të miratohet qëndrimi apo opinioni plotësues përkatës i Gjykatës Supreme në drejtim të ndryshimeve të praktikës gjyqësore, në përputhje me pikëpamjet e GJEDNJ-së të prezantuara në aktgjykimin në fjalë</p>	<p>Komisioni Rregullator i Energjetikës</p> <p>Gjyqësori, përkatësisht Gjykata Supreme</p>

<b>JAKIMOVSKI DHE TRANSPORTI KARI</b>	Neni 1 i Protokollit nr. 1 ndaj KEDNJ-së (mbrojtja e pronësisë) – sekestrimi i panevojshëm i automjetit për shkak të kundërvajtjes së kryer doganore si sanksion plotësues me të cilin është shkaktuar barrë e tepruar joproporcionale mbi aplikantin	U miratua Konkluzioni nga Gjykata e Lartë Administrative me të cilin inkorporohet parimi i proporcionalitetit gjatë procedimit dhe vendimmarrjes në raste të ngjashme në të ardhmen	Të monitorohet zbatimi praktik i Konkluzionit nga ana e gjyqtarëve administrativë dhe i ndryshimeve të krijuara në praktikën administrative gjyqësore	Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative
<b>GRUPI I LËNDËVE ANASTASOV</b>	Neni 1 i Protokollit nr. 1 ndaj KEDNJ-së (mbrojtja e pronësisë) sekestrimi i detyrueshëm i automjeteve për shkak të kundërvajtjes së kryer në bazë të nenit 100-a të KP-së, si sanksion plotësues me të cilin aplikantëve iu shkaktohet barrë e tepruar joproporcionale	Është propozuar ndryshimi i nenit 100-a të KP-së me të cilin inkorporohet parimi i proporcionalitetit	Të iniciohet miratimi i ndryshimeve të propozuara ligjore në KP	Qeveria, Kuvendi...

Legjenda:

\* masa emergjente dhe prioritare

\*\* masa me shkallë më të ulët të prioritetit dhe masa të vazhdueshme



